



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT**

## **DISERTACION**

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE  
DOKTOR**

**CILËSIA E AUDITIMIT DHE MENAXHIMI I FITIMEVE  
RASTI I SHQIPËRISË**

**Kandidati:  
TEUTA LLUKANI**

**Udhëheqës shkencor:  
Prof. Dr. VJOLLCA KARAPICI**

**Tiranë, 2015**

## ***Mirënjohje dhe falënderime***

*Për realizimin e punimit me temë : “Cilësia e Auditimit dhe Menaxhimi i Fitimeve: Rasti i Shqipërisë falënderimi më i madh dhe mirënjohja më e thellë i kushtohet Prof. Dr. Vjollca Karapici, e cila më udhëhoqi në përgatitjen e disertacionit, më dha mbështetje të vazhdueshëm profesionale dhe akademike, më orientoi me dashamirësi drejt literaturës dhe materialeve ndihmëse që studiova për të marrë sa më shumë informacion dhe lëndë të nevojshme në dobi të tezave të mia, më mbështeti pa kursim, vlerësoi me durim e vëmendje të gjitha pjesët e studimit, më dha vazhdimisht këshilla e sugjerime të vlefshme që mundësuan përmirësimin e punimit dhe sjelljen e tij në formën përfundimtare.*

*Shpreh mirënjohjen time të thellë për stafin e nderuar e të palodhur të profesorëve të Departamentit të Kontabilitetit, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, të cilët me dashamirësi më mbështetën më dhanë mendime e sugjerime të vyera që më shërbyen gjatë gjithë punës sime përgatitore deri në hartimin e plotë të temës së doktoraturës.*

*Respekt për punën tuaj dhe për ndihmën e pakursyer*

*Mirënjohje dhe falënderim i veçantë i kushtoj dhe koleges time PhD. Dorian Nano, si dhe miqes e motrës time Elona Bedallii, të cilat me shumë durim më janë përkushtuar me kohën e tyre, mbështetjen, sugjerimet, kritikën në çdo hap të realizimit të disertacionit.*

*Së fundi do të doja të falënderoja familjen time të shtrenjtë , bashkëshortin, djalin dhe prindërit e mi të cilët gjatë gjithë kohës kanë qenë burim motivimi dhe nxitjeje në këtë rrugëtim të vështirë.*

*Dedikuar dhuratave më të çmuara, me të cilat më ka  
bekuar Zoti, fëmijëve të mi të mrekullueshëm Mateo  
dhe Anastasia, si dhe bashkëshortit tim.*

## **PËRMBLEDHJE**

*Përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare janë aksionerët, drejtuesit, punonjësit, bankat, autoritetet tatimore, klientët, furnitorët, audituesit, qeveria, etj.. Një nga treguesit më të rëndësishëm në raportet vjetore janë të ardhurat neto, të cilat pasqyrojnë performancën e shoqërisë gjatë vitit financiar. Ky tregues, i cili vjen si rezultat i procesit të kontabilitetit, shpesh mund të influencohet nga rregullime të mundshme mbi shifrat kontabël, të ndërmarra nga menaxherët për arsye të ndryshme, rregullime këto të cilat mund të çënojnë cilësinë e informacionit kontabël dhe pasqyrave financiare. Këto rregullime emërtohen me termin “menaxhimi i fitimeve”.*

*Pavarësisht literaturës së gjerë që studion menaxhimin e fitimeve, ekziston një mangësi në evidentimin e këtij fenomeni në rastin e Shqipërisë. Ky studim synon të përftojë evidencë të menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar, si dhe të ekzaminojë empirikisht, lidhjen midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë, përkatësisë në sektorin publik apo privat, si dhe disa faktorëve të tjerë që kanë ndikim mbi të.*

*Nga shqyrtimi i literaturës mbi menaxhimin e fitimeve u identifikuan katër modele të përdorura gjerësisht dhe pas përzgjedhjes, Modeli i Matjes së Performancës i zhvilluar nga Kothari, Leone, dhe Wasley (2005), rezultoi statistikisht më i përshtatshëm dhe i aplikueshëm në kampionin e konsideruar në studim. Rrjedhjet jonormale të llogaritura sipas këtij modeli janë evidencë e ekzistencës së fenomenit të menaxhimit të fitimeve. Në 79% të rasteve, shoqëritë që përbëjnë kampionin e marrë në studim, kanë menaxhuar pozitivisht fitimet pra kanë përmirësuar performancën e raportuar.*

*Në vijim analizat njëvariabëlshë (Welch ANOVA), u përdorën për të identifikuar lidhjen midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë dhe përkatësisë në sektorin publik e privat në kampionin e marrë në shqyrtim. Ndërsa analiza shumë variabëlshë (regresion i shumëfishtë linear OLS) u përdor për të përcaktuar faktorë të tjerë që duhen konsideruar si indikatorë, për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe gjithashtu ndikimin e tyre mbi këtë fenomen.*

*Gjetjet nga analizat njëvariabëlshë treguan se rezultojnë ndryshime të rëndësishme statistikore midis shoqërive të mëdha dhe të vogla si dhe shoqërive në përkatësi të sektorit publik dhe privat në lidhje me iniciativat e menaxhimit të fitimeve, të cilat janë të identifikueshme në tregun shqiptar. Shoqëritë e mëdha, më të*

*vjetra në moshë dhe shoqëritë private angazhohen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve krahasimisht me shoqëritë e vogla dhe shoqëritë që i përkasin sektorit shtetëror. Ndërsa ndryshime të parëndësishme statistikore rezultuan në analizën që investigoi lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve. Rezultatet e analizës shumëvariabëlshë treguan se faktorët me ndikim të rëndësishëm mbi fenomenin e menaxhimit të fitimeve janë, madhësia e aktivitetit të shoqërisë, mosha e shoqërisë, të ardhurat nga shitjet dhe përkatësia në sektorin privat/publik.*

*Ky studim përbën kontribut të rëndësishëm për literaturën dhe kërkuesit, pasi është ndër të parët studime empirike të ndërmarrë në Shqipëri për vlerësimin dhe matjen e menaxhimit të fitimeve dhe ndikimit që kanë mbi këtë fenomen cilësia e auditimit, madhësia e aktivitetit të shoqërisë, përkatësia në sektorin publik e privat, dhe faktorë të tjerë. Gjithashtu grupet e interesave, përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të informacionit financiar, duke njohur, identifikuar, e matur këtë fenomen do të mund të rrisin efikasitetin në vendimmarrje.*

*Fjalët kyç: Menaxhimi i Fitimeve, Cilësia e Auditimit, Tregu Shqiptar*

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

### **KAPITULLI I PARË**

---

<b>1. HYRJE</b>	1
1.1 Identifikimi i problemit të kërkimit	3
1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit	4
1.3 Pyetjet Kërkimore shkencore	5
1.4 Metodatat e përfshira në analizën empirike dhe gjetjet kryesore	5
1.5 Rëndësia e punimit	7
1.6 Shtrirja dhe kufizimet e studimit	7
1.7 Përkufizimi i termave kryesor	8
1.8 Organizimi i studimit	9

### **KAPITULLI I DYTË**

---

<b>1 SHQYRTIMI I LITERATURËS</b>	11
2.1 Menaxhimi i fitimeve	11
2.2 Motivet e menaxhimit të fitimit	14
2.3 Matja e menaxhimit të fitimeve	18
2.4 Vlerësime në lidhje me tregues të ndryshëm që ndikojnë te menaxhimi i fitimeve	25
2.4.1 Cilësia e auditimit dhe lidhjet e tij me menaxhimin e fitimeve	26
2.4.2 Madhësia e shoqërisë dhe menaxhimi i fitimeve	30
2.4.3 Menaxhimi i fitimeve dhe sektori publik / privat	32
2.5 Menaxhimi i fitimeve dhe faktorë të tjerë të konsideruar në studime të ndryshme	33
2.6 Përmbledhje e literaturës së shqyrtuar	36

### **KAPITULLI I TRETË**

---

<b>3 ZHVILLIMI I HIPOTEZAVE DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT</b>	
3.1 Sigurimi i të dhënave	42
3.2 Menaxhimi i të dhënave	43
3.3 Zhvillimi i hipotezave dhe teknikat e përzgjedhura në funksion të vërtetimit të tyre	44
3.3.1 Evidentimi e fenomenit “ menaxhim i fitimeve”	44

3.3.2	Madhësia e shoqërisë audituese	50
3.3.3	Efekti i përmasave të shoqërisë në praktikat e menaxhimit të fitimeve	52
3.3.4	Menaxhimi i fitimeve – sektori publik kundrejt atij privat	54
3.3.5	Analiza shumëvariabëlshe	55
3.3.5.1	Variablat e përfshirë në regresion	56
3.4	Përmbledhje e kapitullit të tretë	63

## **KAPITULLI I KAT RT**

<b>4.</b>	<b>ANALIZA E REZULTATEVE</b>	<b>64</b>
4.1	Përshkrimi i kampionit	64
4.2	Analiza e rezultateve	68
4.2.1	Evidentimi e fenomenit “ menaxhim i fitimeve”	68
4.2.2	Madhësia e shoqërisë audituese	80
4.2.3	Efekti i përmasave të shoqërisë në praktikat e menaxhimit të fitimeve	83
4.2.4	Menaxhimi i fitimeve - sektori publik kundrejt atij privat	89
4.2.5	Analiza shumëvaiabëlshe	92
4.3	Përmbledhje e kapitullit të katërt	106

## **KAPITULLI I PESTË**

<b>5.</b>	<b>DISKUTIMI I REZULTATEVE, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.</b>	<b>108</b>
5.1	Rezultatet dhe diskutimi i tyre	108
5.1.1	Identifikimi i fenomenit “ menaxhimi i fitimeve”	109
5.1.2	Diskutimi i rezultateve sipas hipotezave të ngritura	110
5.2	Konkluzione	116
5.3	Profili i një shoqërie tipike, që angazhohet në praktikat e menaxhimit të fitimeve	118
5.4	Kontributi i studimit	118
5.4.1	Kontributi teorik për literaturën dhe kërkuesit	118
5.4.2	Kontributi praktik i studimit.	119
5.5	Rekomandime për studime të ardhme	121
<b>6.</b>	<b>REFERENCA</b>	<b>123</b>
<b>7.</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>131</b>

## LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1	Përkufizime alternative të menaxhimit të fitimeve	12
Tabela 2.2	Përmbledhje e gjetjeve të disa punimeve gjatë shqyrtimit të literaturës	40
Tabela 4.1	Përshkrimi i kampionit të vlefshëm për studim	64
Tabela 4.2	Përbërja e kampionit sipas klasifikimit industrial dhe përfshirjes së shoqërive Big4 në procesin e auditimit.	65
Tabela 4.3	Klasifikimi sipas formës së organizimit, pronësisë, prodhimit të të mirave dhe shërbimeve dhe financimin me kapital të huaj	66
Tabela 4.4	Statistika kryesore përmbledhëse e modeleve të vlerësimit të rrjedhjeve normale	70
Tabela 4.5	Statistika përshkruese të rrjedhjeve jonormale	77
Tabela 4.6	Statistika përshkruese për variabëlin Abs RJN	78
Tabela 4.7	Statistika përshkruese për variabëlin logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale pas transformimit	79
tabela 4.8	Të dhëna përshkruese për vlerat e Logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN) sipas kategorive Big4 dhe Jo Big4	81
Tabela 4.9	Testi i homogjenitetit të variancës	81
Tabela 4.10	Testet Robust Welch dhe Brown-Forsythe	82
Tabela 4.11	Welch ANOVA	82
Tabela 4.12	Kategorizimi i shoqërive sipas madhësisë	84
Tabela 4.13	Statistika përshkruese	86
Tabela 4.14	Vlerat e asimetrisë dhe koeficientit Kurtosis sipas faktorëve të madhësisë dhe ndryshimit të shitjeve të shoqërive për 200 firmë - vit vrojtme.	87
Tabela 4.15	Testi Levene's, mbi barazinë e gabimit të variancave të variabëlilit të varur	88
Tabela 4.16	Efekti ndërmjet grupeve sipas analizës Two Way Anova	89
Tabela 4.17	Të dhëna përshkruese për vlerat e logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN) sipas kategorive “pronësi private” dhe “pronësi shtetërore”	90

Tabela 4.18	Testi i homogjenitetit të variancës	91
Tabela 4.19	Testet Robust Welch dhe Brown-Forsythe	91
Tabela 4.20	Welch ANOVA	91
Tabela 4.21	Statistikat përshkruese për të gjithë variablat e konsideruar në regresion.	95
Tabela 4.22	Testi White mbi heteroskedasticitetin	96
Tabela 4.23	Statistikat VIF dh Tolerancat për kontrollin e multikolinearitetit të variabëlve të pavarur në model	97
Tabela 4.24	Matrica e korrelacionit Pearson për variablat e pavarur	98
Tabela 4.25	Të dhëna përmbledhëse të modelit	99
Tabela 4.26	Anova	100
Tabela 4.27	Koeficientët e pjesshëm të regresionit sipas metodës “enter”	101
Tabela 4.28	Përmbledhja e modelit sipas metodës Stepwise të realizuar në 6 hapa	102
Tabela 4.29	Koeficientët e pjesshëm të regresionit sipas metodës “stepwise”	102
Tabela 4.30	Variabla të përjashtuar si të parëndësishëm në nivelin 95 % të besueshmërisë sipas metodës stepwise, konsideruar në hapin 6.	103
Tabela 4.31	Koeficientët e korrelacionit pjesor	104
Tabela 4.32	Përmbledhje e rezultateve për vërtetimin e hipotezave sipas analizës shumëvariabëlshë	105

## **LISTA E FIGURAVE DHE GRAFIKËVE**

Figura 3.1	Kuadri konceptual i regresionit	61
Grafiku 4.1	Shpërndarja e kampionit sipas Qarqeve	67
Grafiku 4.2	Histograma e shpërndarjes së vlerave të logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale	96

## KAPITULLI I PARË

### HYRJE

Përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare janë aksionerët, drejtuesit, punonjësit, bankat, autoritetet tatimore, klientët, furnitorët, audituesit, qeveria etj. Secila prej këtyre palëve luan një rol të veçantë në shoqëritë ekonomike. Kështu, drejtuesit vendosin rregullat, menaxherët hartojnë pasqyrat financiare, audituesit ushtrojnë kontroll për të certifikuar dhe siguruar saktësinë e informacionit, ndërsa investitorët, të cilët nuk kanë akses në informacionin e brendshëm lexojnë raportet vjetore që në shumë raste janë bazë për vendimmarrje. Një nga treguesit më të rëndësishëm për investitorët në raportet vjetore është e ardhura neto e cila tregon performancën e shoqërisë gjatë vitit financiar. Ky tregues i cili vjen si rezultat i procesit të kontabilitetit, shpesh mund të influencohet nga rregullime të mundshme mbi shifrat në kontabilitet, të ndërmarra nga menaxherët për arsye të ndryshme. Në fakt, rregullat e kontabilitetit janë fleksibël dhe mund të lejojnë disa ndërhyrje mbi shifrat e raportuara. Termi që përdoret në lidhje me rregullimet e rezultatit kontabël, të ndërmarra nga menaxherët është “menaxhimi i fitimeve” i cili mund të përkufizohet si : *“Mundësia që menaxherët për arsye të ndryshme të raportojnë gjendje të ndryshme të performancës ekonomike, të shoqërisë apo të ndikojë mbi rezultatet kontraktuale që varen nga shifrat e raportuara”* (De Angelo 1981).

Në fakt, palët që përfshihen dhe hyjnë në marrëdhënie me shoqërinë janë të ndryshme dhe përfaqësojnë interesa krejt të ndryshme. Ato gjithashtu mund të vlerësojnë në këndvështrime të ndryshme fenomenin e “menaxhimit të fitimeve”. Për më tepër, interpretimi i rezultateve nga palë të ndryshme në kushtet kur fitimi është menaxhuar mund të përbëjë problem. Megjithatë rregullimet kontabël nuk mund të shihen si sinjale negative në të gjitha rastet. Ato mund të jenë sinjale në lidhje me pritshmërinë në të ardhmen, apo zbatimin e politikave të kontabilitetit që është e rëndësishme të kuptohen edhe pse mund të jetë dashur të rregullohet apo menaxhohet rezultati dhe shifrat e raportuara. Me gjithë faktin se mund të pranojmë që rezultatet ushtrimore menaxhohen në shumë shoqëri, është e rëndësishme që ato të mos klasifikohen si “jo morale”, apo “jo etike” dhe pa dyshim të derivojnë në fenomenin e “mashtimit”.

Për të mbrojtur interesat e palëve të interesuara, shoqëritë (që përmbushin disa kritere) duhet të kenë pasqyrat e tyre financiare të audituara. Fenomeni i “menaxhimit të fitimeve” është objekt i procesit të auditimit, cilësia e të cilit është e lidhur me mundësinë e gjetjes dhe raportimit të gabimeve të mundshme në aktivitetin financiar (De Angelo 1981). Roli i audituesve në treg varet nga shumë faktorë. Nga njëra anë ata operojnë si mbrojtës të interesit publik (çertifikojnë raportet financiare duke siguruar cilësinë e tyre) dhe nga ana tjetër ata udhëhiqen nga interesa private, si agjentë ekonomik në treg me aktivitet fitimprurës. Studime të shumta kanë investiguar lidhjen cilësi auditimi - menaxhim i fitimeve, por gjetjet kanë qenë të ndryshme.

Për sa i përket tregut të auditimit në Shqipëri ai shfaqet i strukturuar mirë institucionalisht dhe me bazë ligjore të plotë. Zhvillimi i tregut dhe profesionit është i dukshëm, referuar edhe të dhënave të raportuara nga Ministria e Financave. Kështu subjektet publike kanë krijuar strukturat e auditimit të brendshëm. Ky është një tregues pozitiv për zhvillimin e sistemit të auditimit të brendshëm, si dhe tregon për një shtrirje më të madhe të zbatimit praktik të ligjit për auditimin e brendshëm. Po ashtu edhe auditimi i jashtëm ka rritje. Sikurse dhe në shumë vende të tjera të botës, edhe në Shqipëri krahas eksperteve kontabël të regjistruar (EKR) operojnë dhe shoqëri ndërkombëtare auditimi (Big 4), të cilat ndajnë pjesën e tregut me Auditues të Jashtëm të Autorizuar dhe Auditues të Brendshëm të Çertifikuar (në sektorin publik). Në tregun shqiptar të auditimit operojnë gjithsej 204 Ekspertë Kontabël të Autorizuar, Persona Fizike dhe 48 Shoqëri Auditimi të regjistruara, nga të cilat katër shoqëritë më të mëdha të auditimit dhe konkretisht Deloitte, KPMG, PriceWaterhouse Coopers dhe Ernest & Young<sup>1</sup>. Pra, në Shqipëri, sot operojnë shoqëri ndërkombëtare të auditimit, aktiviteti i të cilave shtrihet në shumë vende të tjera.

Shumë studiues kanë trajtuar menaxhimin e fitimit dhe lidhjen e tij me cilësinë e auditimit dhe faktorë të tjerë në Amerikë, Europë e Azi, përfshirë vendet e zhvilluara por edhe ato në zhvillim. Tregohet se ka mjaft arsye pse menaxherët të përfshihen në

---

<sup>1</sup> Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar- Raporti Vjetor 2012

iniciativat e menaxhimit të fitimeve si për shembull, skemat e shpërblimit me bazë performancën. Gjithashtu është provuar se efektet e menaxhimit të fitimeve kanë ndikuar mbi vendimmarrjen e palëve të interesuara, mbi çmimin e aksioneve në tregun e kapitalit, mbi kontratat e financimit me borxh etj.

Kështu investigimi në këtë fushë dhe shtrirja e tij edhe në tregun shqiptar do të jetë një kontribut i vlefshëm, jo vetëm në literaturën shqiptare por, për më tepër do t'u shërbejë përftuesve dhe përdoruesve të informacionit financiar në përgjithësi dhe investitorëve e menaxherëve në veçanti, për njohjen e efekteve të menaxhimit të fitimit, interpretimin e raporteve financiare dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë në nxitjen apo kufizimin e tij.

### 1.1 Identifikimi i problemit të kërkimit

Shumë studiues kanë evidentuar lidhjen midis menaxhimit të fitimeve, cilësisë së auditimit dhe faktorëve të tjerë. Rezultatet e tyre në shumicën e rasteve kanë konvergjuar në faktin se cilësia e auditimit lidhet negativisht me menaxhimin e fitimeve. Kjo do të thotë se një proces cilësor auditimi kushtëzon iniciativat që mund të ndërmerren nga menaxherët për të ndryshuar rezultatet nisur nga motive të ndryshme. Këto studime janë shtrirë gjerësisht në vende të ndryshme si Europë, Azi dhe SHBA. Rasti i Shqipërisë është një fushë interesante kërkimi për shkak të karakteristikave social – kulturore, institucionale, karakteristika këto tipike të një vendi në zhvillim dhe që ndryshojnë gjerësisht nga ato të një vendi të zhvilluar.

Motivuar nga ky fakt, si dhe nga fenomene të dukshme, të ngjashme me menaxhimin e fitimeve në tregun shqiptar, mendoj se do të jetë i vlefshëm një studim i mirëfilltë me kontribut në literaturën shqiptare.

Për sa më sipër linden disa pyetje

- A ekziston fenomeni i menaxhimit të fitimit në tregun shqiptar dhe si mund ta identifikojmë atë?
- Si ndikon cilësia e auditimit mbi menaxhimin e fitimeve dhe cili është qëndrimi i audituesve në tregun shqiptar?
- Cilët janë faktorët e tjerë që duhen konsideruar me qëllim kontrollin e menaxhimit të fitimeve .

Këto dhe pyetje të tjera më kanë nxitur për të kryer këtë studim.

## 1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim ka për qëllim të përftojë evidencë të menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar si dhe të ekzaminojë empirikisht, lidhjen midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së njësive ekonomike, përkatësisë në sektorin publik apo privat, si dhe faktorë të tjerë që shprehin karakteristika të shoqërisë, performancën e saj ekonomike, formën e pronësisë etj., dhe që mund të konsiderohen si indikatorë për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve si dhe ndikimin që këta faktorë kanë mbi fenomenin.

Për të përfutur konkluzione gjithëpërfshirëse, punimi ekzaminon një pjesë të konsiderueshme të tregut shqiptar duke përfshirë në analizën empirike shoqëri me aktivitet fitim prurës që i përkasin: a) aktivitetit privat dhe publik, b) industrive të ndryshme, c) madhësive të ndryshme (për nga aktiviteti që ushtrojnë), d) formave të ndryshme të pronësisë dhe organizimit etj.

Në funksion të përmbushjes së qëllimit të studimit, objektivat kryesore të tij do të jenë:

- Së pari, të hulumtojë literaturën në lidhje me fenomenin e menaxhimit të fitimeve dhe lidhjen e tij me cilësinë e auditimit dhe faktorë të tjerë, që ndikojnë duke stimuluar apo kufizuar praktikën e menaxhimit të fitimeve.
- Së dyti, të sigurojë evidencë në lidhje me fenomenin e menaxhimit të fitimeve në tregun shqiptar.
- Së treti, të krahasojë iniciativat e menaxhimit të fitimeve në tregun shqiptar sipas kriterëve të: a) cilësisë së auditimit, b) madhësisë së aktivitetit të shoqërisë, dhe c) përkatësisë në sektorin publik dhe privat.
- Së katërti, të paraqesë një analizë shumë-variabëlshë për të identifikuar disa faktorë kryesorë dhe ndikimin e tyre mbi menaxhimin e fitimeve.
- Së fundi, të paraqesë disa konkluzione dhe rekomandimet përkatëse në lidhje me fenomenin e menaxhimit të fitimeve në funksion të përmirësimit të cilësisë së raportimit financiar dhe informacionit që rrjedh prej tij, si faktor i rëndësishëm me ndikim mbi vendimmarrjen e palëve të ndryshme të interesave.

### **1.3 Pyetjet Kërkimore shkencore:**

Për të adresuar objektivat e sipërpërmendura, ky studim do të bazohet në pyetjet e mëposhtme kërkimore.

1. A përfshihen menaxherët në shoqëritë, që operojnë në tregun shqiptar në iniciativat e menaxhimit të fitimeve?
2. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikatat e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë, ku në procesin e auditimit përfshihen auditues Big4 dhe në ato ku përfshihen auditues jo Big4, në kontekstin shqiptar?
3. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikatat e menaxhimit të fitimeve kur krahasojmë shoqëritë e mëdha dhe të vogla në tregun shqiptar?
4. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikatat e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që i përkasin sektorit publik dhe atij privat në Shqipëri?
5. Cilët janë faktorët e tjerë që duhen konsideruar si indikatorë, për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe cili është ndikimi i tyre në kontekstin shqiptar?

### **1.4 Metodatat e përfshira në analizën empirike dhe gjetjet kryesore**

Analiza empirike e zhvilluar në këtë punim ka synuar të japë përgjigje për pyetjet e mësipërme kërkimore. Për çdo pyetje kërkimore janë përzgjedhur metoda të cilat kanë përftuar rezultate të vlefshme në kontekstin shqiptar.

Për të identifikuar fenomenin e menaxhimit të fitimeve u testuan statistikisht katër modele të përdorura gjerësisht gjatë shqyrtimit të literaturës (Modeli Jones 1991, Modeli Jones i Modifikuar nga Dechow, Sloan, dhe Sweeney (1995), Modeli i Zgjeruar Jones – Cash Flow i zhvilluar nga Kasznik (1999) dhe Modeli i Matjes së Performancës i zhvilluar nga Kothari, Leone, dhe Wasley (2005)). Modeli i Matjes së Performancës rezultoi statistikisht më i përshtatshëm për t'u aplikuar në kampionin e konsideruar në studim. Rrjedhjet jonormale të llogaritura sipas këtij modeli përbënin dhe evidencën e ekzistencës së fenomenit të menaxhimit të fitimeve. Në 79% të rasteve, shoqëritë që përbëjnë kampionin e marrë në studim, kanë menaxhuar pozitivisht fitimet pra kanë përmirësuar performancën e raportuar.

Në përgjigje të pyetjeve kërkimore të dytë, të tretë dhe të katërt u përdorën analizat një variabëlshë Welch ANOVA dhe Two Way Anova, nëpërmjet të cilave u identifikua lidhja midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë dhe përkatësisë në sektorin publik e privat, në kampionin e marrë në shqyrtim. Gjetjet treguan se rezultojnë ndryshime të rëndësishme statistikore midis shoqërive të mëdha dhe të vogla si dhe shoqërive në përkatësi të sektorit publik dhe privat në lidhje me iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Shoqëritë e mëdha, dhe shoqëritë private angazhohen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve krahasimisht me shoqëritë e vogla dhe shoqëritë që i përkasin sektorit shtetëror. Ndërsa ndryshime të parëndësishme statistikore rezultuan në analizën që investigoi lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve.

Gjithashtu, në funksion të pyetjes së pestë kërkimore, analiza shumëvariabëlshë (regresion i shumëfishtë linear OLS) u përdor për të përcaktuar faktorë të tjerë që duhen konsideruar si indikatorë, për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe gjithashtu ndikimi i tyre mbi këtë fenomen. Kjo teknikë është përzgjedhur sepse është gjerësisht e përdorur në shpjegimin e fenomeneve të ndryshme në shkencat shoqërore, është më së shumti e përdorur edhe në studimet gjatë shqyrtimit të literaturës, është e thjeshtë në përdorim dhe e përshtatshme për të eksploruar lidhjen midis një variabëli të varur që merr vlera të vazhduara numerike dhe një grupi variabëlshë të pavarur të ndryshëm (fiks, kategorik apo të vazhduar). Variablat e pavarur të përfshirë në model përfaqësuan cilësinë e auditimit, madhësinë e njësisë ekonomike, moshën, përfshirjen e pronarëve në menaxhim, kompleksitetin e njësisë ekonomike, raportin e levës financiare, rezultatin ushtrimor nëse ai është pozitiv apo negativ, të ardhurat nga shitja, ROA, financimin e aktivitetit nëse ai është pjesërisht apo plotësisht i huaj, dhe përkatësinë e njësive ekonomike në sektorin publik apo privat.

Gjetjet treguan se nga 11 variabla të përfshirë në model, katër prej tyre rezultuan të rëndësishëm në nivelin 95% të besueshmërisë dhe dy të tjerë në nivelin 90 % të besueshmërisë. Më konkretisht, mbi menaxhimin e fitimeve ka ndikim të rëndësishëm madhësia e njësisë ekonomike, mosha, përkatësia në sektorin publik apo privat dhe të ardhurat nga shitja të realizuara gjatë periudhës ushtrimore (në nivelin 95% besueshmëri) si dhe përfshirja e pronarëve në menaxhim e deklarimi i rezultatit negativ (në nivelin 90% besueshmëri). Ndërsa variablat të cilët nuk janë indikatorë të

mirë dhe që nuk mund të përdoren në parashikimin e rrjedhjeve jonormale si variabël përfaqësues i menaxhimit të fitimeve janë: cilësia e auditimit, kompleksiteti, leva financiare, ROA dhe financimi me kapital të huaj.

### **1.5 Rëndësia e punimit**

Ky studim ka në fokus menaxhimin e fitimeve dhe ndikimin që ka procesi i auditimit dhe cilësia e tij mbi këtë fenomen. Në këtë mënyrë punimi ofron evidencë dhe analizë të menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit në kontekstin shqiptar, duke iu shërbyer punimeve të mëtejshme kërkimore në këtë fushë.

Matja e efekteve të menaxhimit të fitimeve ka rëndësi në lidhje me të kuptuarit dhe të interpretuarit të informacionit kontabël, që rrjedh nga raportet financiare vjetore. Interpretimi i drejtë i informacionit kontabël është i rëndësishëm për të gjitha grupet e interesave, si : investitorët, analistët financiarë, ndërmjetësit financiarë, menaxherët etj. të cilët rrisin përfitimin dhe efektivitetin në vendimmarrje nëse kuptojnë më mirë shkaqet dhe efektet e menaxhimit të fitimit. Gjithashtu, njohja e fenomenit dhe analizimi i tij është ndihmë të drejtuesve apo strukturave rregullatore të shoqërive, që duhet të vendosin shkallën e duhur të veprimeve të lejuara, që mund të ndërmerren nga menaxherët në mënyrë që të mund të monitorojnë problemin në lidhje me menaxhimin e rezultatit vjetor, gjatë përpilimit të pasqyrave financiare. Për më tepër, ky punim do të mund t'iu shërbejë edhe politikëbërësve në lidhje me përmirësimin e strukturave reformuese, si dhe grupimeve të tjera që janë të interesuara për të pasur informacion dhe raporte cilësore në lidhje me veprimtarinë ekonomike dhe financiare të njësive të ndryshme.

### **1.6 Shtrirja dhe kufizimet e studimit**

Ky studim shtrihet gjerësisht në territorin shqiptar. Është synuar që kampioni të derivojë kryesisht nga qendrat, që kanë përqendrim të aktiviteteve ekonomike, si Tirana, Durrësi, Fieri, Korça, Elbasani e Lushnja (66.7 % e kampionit). Megjithatë, në përbërje të kampionit ka dhe shoqëri nga Gjirokastra, Tepelena, Saranda, Laçi, Lezha, Kruja dhe Malësia e Madhe (34.3 % e kampionit), pra me një shtrirje gjeografikisht në më shumë se 50 % të territorit shqiptar.

Gjithashtu, kampioni është i diversifikuar për nga lloji i aktiviteteve ekonomike dhe përkatësisë industriale. Aktivitetet ekonomike i përkasin 12 nga 17 grupe gjithsej të

klasifikuara sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike në Shqipëri (NVE Rev.1), e cila është identike me Kodimin Standard Industrial European të Aktiviteteve Ekonomike (NACE/REV 1.1), të pranuar dhe të aplikueshëm nga autoritetet dhe institucionet shqiptare. Kampioni gjithashtu është i diversifikuar për nga forma e organizimit (sh.a. dhe sh.p.k.), për nga përkatësia në pronësi shtetërore apo private si dhe aktivitete ekonomike që prodhojnë të mira apo shërbime. Një shpërndarje e gjerë dhe e mirë diversifikuar e kampionit është efikase për përgjithësimin e rezultateve.

Megjithatë, duhet përmendur se shoqëritë që përbëjnë kampionin nuk janë në shpërndarje proporcionale me aktivitetet ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e vet në rrethet e sipërpërmendura, në industritë përkatëse, apo edhe sipas formës së organizimit, pronësisë etj., pasi në shumicën e rasteve shoqëritë janë përzgjedhur në mënyrë rastësore. Kjo nuk ka mundësuar ruajtjen e proporcioneve midis kategorive përkatëse dhe ky përbën një kufizim të punimit. Sidoqoftë, përdorimi i teknikës “One Way Welch ANOVA” e përdorur në analizat empirike e korrigjon këtë problem dhe përmirëson saktësinë e rezultateve.

Për sa i përket variablave të konsideruar në studim ato janë përzgjedhur duke u mbështetur në studimet e mëparshme. Cilësia e auditimit gjerësisht është identifikuar nga variabëli dikotomik Big4 (vlera 1) dhe jo Big4 (vlera 0). Në këtë studim, pikërisht ky variabël është konsideruar në analizën empirike për të vlerësuar lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve. Ndërkohë që specializimi i audituesve sipas industrive, pagesa e përfituar e audituesve për shërbimin e kryer (auditimin e pasqyrave financiare) ndaj njësive ekonomike (Palmrose 1986) vlerësohen të jenë matës të tjerë indirekt, eficientë të cilësisë së auditimit. Në këtë studim nuk është mundur të përfshihen këta matës për arsye se ka qenë e pamundur mbledhja e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e këtyre treguesve. Gjatë kontaktit me auditues të ndryshëm të dhëna të tilla janë konsideruar konfidenciale.

### **1.7 Përkufizimi i termave kryesor**

Më poshtë paraqiten disa përkufizime dhe sqarimi i disa termave kryesorë të cilat janë përdorur gjerësisht përgjatë punimit.

**Menaxhimi i fitimeve-** “menaxhimi i fitimeve ndodh kur menaxherët përdorin gjykimet e tyre gjatë raportimit financiar dhe strukturimit të transaksioneve me qëllim

ndryshimin e rezultateve të raportuara, ose keqinformimin e disa palëve të interesuara në lidhje me treguesit e performancës së shoqërisë, apo ndikimin mbi rezultatet kontraktuale që varen nga shifrat e raportuara”. Healy dhe Whalen (1999)

**Rrjedhje totale ( total accruals)** = E ardhura neto – (Fluksi operativ i mjeteve monetare + fluksi investues i mjeteve monetare)

*total accruals = net income - (Cash flow from operations+cash flows from investing activities).*

Rrjedhjet përfshijnë rregullimet që menaxherët kryejnë për të vlerësuar rezultatet duke i kthyer ato nga baza monetare në baza rrjedhëse. Formula e mësipërme e llogaritjes së rrjedhjeve (accruals) sipas Dechow (2006) përdoret për të treguar në lidhje me veprimet rrjedhëse që lidhen me aktivitetet a) operative dhe b) investuese. Kjo mënyrë llogaritjeje është përdorur në punim për vlerësimin e rrjedhjeve totale.

**Rrjedhje normale ( non-discretionary accruals, or normal accruals or expected accruals)**,- konsiderohet ai komponent i parashikueshëm i rrjedhjeve totale i stimuluar nga ciklet e biznesit apo i justifikuar nga ecuria normale e treguesve të biznesit. Për të vlerësuar rrjedhjet normale përdoren modele statistikore të trajtuara gjerësisht në këtë punim.

**Rrjedhje jonormale- (discretionary accruals, or ubnormal accruals or unexpected accruals)**,- konsiderohet ai komponent i pa-parashikueshëm i rrjedhjeve totale, i pa justifikuar nga ecuria normale e treguesve të biznesit. Rrjedhjet jonormale llogariten si diferencë midis rrjedhjeve totale dhe atyre normale. Vlera jo zero e rrjedhjeve jonormale përdoret si tregues indirekt i fenomenit të menaxhimit të fitimeve.

## 1.8 Organizimi i studimit

Ky studim është i organizuar në pesë kapituj. Në kapitullin e parë paraqitet një hyrje me konceptet e menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit si dhe theksohet arsyeja për të cilën kërkimi ndërmerret dhe rëndësia e këtij studimi. Kapitulli i dytë identifikon, vlerëson dhe interpreton literaturën ekzistuese në lidhje me menaxhimin e fitimeve, cilësinë e auditimit dhe ndikimin që ka procesi i auditimit mbi këtë fenomen, si dhe faktorët e tjerë që ndikojnë mbi menaxhimin e fitimeve. Në kapitullin e tretë parashtrahet një informacion i detajuar në lidhje me testet, teknikat dhe metodat kryesore të përdorura në këtë punim sipas pyetjeve kërkimore-shkencore dhe

hipotezave të parashtruara. Në kapitullin e katërt përshkruhet kampioni i vlefshëm për studim. Analiza dhe paraqitja e rezultateve në këtë pjesë janë paraqitur sipas hipotezave të testueshme përkatëse. Së fundi, studimi paraqet diskutimin e gjetjeve kryesore duke konkluduar për çështjet e trajtuara, paraqet kontributin teorik e praktik të punimit si dhe jep disa rekomandime për kërkime të mëtejshme në këtë fushë.

## KAPITULLI I DYTË

### SHQYRTIMI I LITERATURËS

Qëllimi i këtij kapitulli është të hulumtojë mbi literaturën ekzistuese bashkëkohore e cila përkufizon fenomenin e menaxhimit të fitimeve dhe të trajton çështje e problematika që e lidhin këtë fenomen, me a) procesin e auditimit, cilësia e të cilit siguron dhe cilësinë e informacionit dhe raportimit financiar në shoqëritë private dhe në ato publike, b) madhësinë e aktivitetit të shoqërisë, c) përkatësinë në sektorin publik apo privat të aktiviteteve ekonomike, d) si dhe disa faktorë të tjerë. Ky kapitull do të shërbejë si bazë teorike për përjasjen e fenomeneve dhe problematikave të ndryshme në kontekstin shqiptar.

#### 2.1 Menaxhimi i fitimeve

Një tregues i rëndësishëm për investitorët, i pasqyruar në raportet financiare vjetore është fitimi i periudhës kontabël. Ai mat performancën e shoqërisë gjatë vitit dhe llogaritet si efekti neto i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës kontabël. Menaxherët për arsye të ndryshme mund të ndikojnë te fitimi duke ndërhyrë apo “menaxhuar” shifrat e raportuara. Pikërisht rregullimi i fitimit kontabël nga menaxheret emërtohet me termin “menaxhimi i fitimeve”. Kontabiliteti në vetvete është një sistem informacioni në shërbim të përdoruesve të tij dhe pasqyrat financiare, si produkt i këtij sistemi kanë objektiv kryesor të përcjellin informacionin financiar në funksion të marrjes së vendimeve ekonomike. Nëse do të pranojmë se iniciativat e “menaxhimit të fitimeve” çojnë në shtrembërim të rezultatit kjo do të thotë se raportet financiare mund të konsiderohen jo cilësore, duke përcjellë informacion jo cilësor te përdoruesit e informacionit financiar dhe grupet e ndryshme të interesave.

Teorikisht menaxhimi i fitimeve nuk është fenomen “i keq” dhe për më tepër që në shumë raste, ky fenomen është legal. Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të kontabilitetit, u japin liri veprimi kontabilistëve, që mbi bazën e gjykimit të tyre të përzgjedhin metoda të ndryshme vlerësimi dhe për rrjedhojë të mund të përftohen rezultate të ndryshme. Kështu për shembull, menaxherët mbi bazën e gjykimit të tyre mund të vlerësojnë jetën ekonomike të përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, duke ndikuar jo vetëm në fitimin të vitit financiar aktual, por dhe në atë të viteve në vazhdim. Gjithashtu përzgjedhja e metodave LIFO, FIFO dhe e mesatares bëjnë që të

përftohen rezultate të ndryshme në lidhje me vlerësimin e kostos së inventarëve. Akoma më tej, menaxherët gjykojnë në mënyra të ndryshme në lidhje me kapitalin punues (përzgjedhja e nivelit të inventarëve, politikat në lidhje me llogaritë e arkëtueshme), me nivelin e shpenzimeve të ndryshme (si p.sh., shpenzimet për kërkim-zhvillim, shpenzimet për reklama e promocion etj.). Pra të gjitha këto gjykime, që padyshim janë dhe vendime të menaxherëve, reflektohen te llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe për rrjedhim edhe tek fitimi neto.

Studime të ndryshme kanë konsideruar fenomenin e menaxhimit të fitimeve si të padëshiruar, sepse mund të çojnë në degradim të cilësisë së raportimit financiar (Sankar dhe Subramanyam 2001). Ndërsa Arya, Glover dhe Sunder (2003) argumentojnë se iniciativat e menaxhimit të fitimeve të ndërmarra brenda kufijve mund të përmirësojnë efikasitetin në vendimmarrje. Akoma më tej, Ronen dhe Yaari (2008) sugjerojnë se jo të gjitha iniciativat e menaxhimit të fitimeve janë “të këqija”. Ata iç përmbledhin përkufizimet e disa autorëve dhe i rendisin ato në tri kategori:

- E bardhë- menaxhim i fitimit përmirëson transparencën e raporteve,
- Gri- menaxhimi i fitimit, brenda kufijve të lejuar nga standardet mund të përmirësojë transparencën e raporteve por mund të jetë dhe oportunist.
- E zezë - menaxhimi i fitimit rezulton në shtrembërime të rezultatit dhe mashtrim

**Tabela 2.1 Përkufizime alternative të menaxhimit të fitimeve**

	Përkufizimi	Burimi
E bardhë	Menaxhimi i fitimeve do të thotë të përfitohet nga fleksibiliteti në zgjedhjen dhe aplikimin e metodave kontabël me qëllim përftimin e informacionit sinjalizues në lidhje me rrjedhën e flukseve të parasë në të ardhmen	Ronen dhe Sadan (1981), Demski , Patten dhe Eolfson(1984); Suh(1990); Demski (1998); Benish (2001), Sanakar dhe Subramanyam(2001)
Gri	Menaxhimi i fitimeve është	Fields, Lys dhe Vincent (2001);

	përzgjedhja e metodave kontabël njëkohësisht për të maksimizuar përfitimet individuale të menaxherëve dhe për të përmirësuar efikasitetin ekonomike	Skott (2003)
E zezë	Menaxhimi i fitimeve është teknika e përdorimit të mashtrimeve që shtrembërojnë rezultatin dhe reduktojnë transparencën e raporteve financiare	Schipper (1989); Healy and Whalen (1999); Tzur dhe Yaari (1999); Cthourou, Bedard dhe Courteau (2001); Miller dhe Bahnsen (2002)

*Burimi: Tabela 2.1 është përshtatur sipas Ronen, J dhe Yaari V. (2008), fq. 26*

Menaxhimi i fitimeve mund të përkufizohet gjithashtu edhe si “ *strategji e të gjeneruarit të fitimit kontabël duke përdorur gjykimin menaxherial mbi përzgjedhjen e metodave kontabël të cilat ndikojnë mbi fluksin e parasë nga aktiviteti i shfrytëzimit*” (Philips 2003, fq. 463). DeGeorge (1999) e përkufizon këtë fenomen si “*liri veprimi e menaxherëve për të influencuar mbi rezultatet e publikuara ndaj aksionarëve*”. Ndërsa, sipas Healy dhe Whalen (1999) “*menaxhimi i fitimeve ndodh kur menaxherët përdorin gjykimet e tyre gjatë raportimit financiar dhe strukturimit të transaksioneve me qëllim ndryshimin e rezultateve të raportuara, ose keqinformimin e disa palëve të interesuara në lidhje me treguesit e performancës së shoqërisë, apo ndikimin mbi rezultatet kontraktuale që varen nga shifrat e raportuara*”. Ky i fundit në literaturat e menaxhimit të fitimeve konsiderohet si përkufizimi që përshkruan më mirë këtë fenomen.

Me gjithë ngjashmëritë që kanë përcaktimet në lidhje me menaxhimin e fitimeve Benish (2001 fq. 5) thekson se ndërmjet akademikëve nuk ka një konsensus të plotë në lidhje me identifikimin e këtij fenomeni. Nëse analizojmë përkufizimet e mësipërme, vërehet se ato theksojnë se menaxhimi i fitimeve rrjedh nga iniciativa të ndërmarra nga menaxherët, të cilët mund të keqpërdorin të drejtën që iu është dhënë nga standardet e kontabilitetit për të ushtruar gjykimin e tyre në raportimin financiar. Këto veprime çojnë në rezultate të ndryshme nga performanca aktuale e shoqërisë dhe në këtë mënyrë grupet e interesave keqinformohen. Pra, përkufizimet kanë në thelb

veprimet e ndërmarra nga menaxherët në lidhje me përpunimin dhe raportimin e rezultateve të veprimtarisë nga njëra anë dhe nga ana tjetër janë investitorët apo palët e tjera që u paraqitet ky informacion dhe që janë të interesuar të sigurojnë cilësinë e tij. Shkalla e saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit financiar ndikon mbi cilësinë e vendimmarrjes, në situata të ndryshme. Në këtë këndvështrim menaxhimi i fitimeve vjen si rezultat i ekzistencës së kërkesës dhe ofertës për informacion financiar (Foster 1986). Është e kuptueshme që kërkesën e përbejnë ato palë që përdorin informacionin financiar me qëllim vendimmarrjen apo për qëllime të tjera, si aksionarët, kreditorët, strukturat shtetërore, publiku etj, palë këto të cilat nuk kanë akses në gjithë informacionin që prodhon aktiviteti i shoqërive. Ndërsa, ofertën e përbejnë pikërisht menaxherët të cilët përpunojnë informacionin dhe e paraqesin atë në formën e pasqyrave financiare, në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara.

Me gjithë faktin se mund të pranojmë që rezultatet ushtrimore menaxhohen në shumë shoqëri, është e rëndësishme që ato të mos klasifikohen si “jo morale” apo “jo etike” (ajo çka në tabelën e mësipërme është përcaktuar në zonën e “zezë”) dhe pa dyshim të derivojë në fenomenin e “mashtimit”. Kështu, menaxhimi i fitimit mund të përdoret nga menaxherët oportunistë, dhe mund të çojë në degradim të cilësisë së informacionit dhe raportimit financiar.

### **2.2 Motivet e menaxhimit të fitimit**

Koncepti i menaxhimit të fitimit në fakt ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe shumë prej tyre janë fokusuar në identifikimin e faktorëve që motivojnë këtë fenomen. Është vërejtur se motive të tilla mund të jenë të lidhura me skemën e shpërblimeve dhe pozicionimin e menaxherëve mbi baza rezultatesh, ndikimin mbi çmimet e aksioneve, evazionin fiskal, zbutjen e fitimit të periudhës, shmangien ndaj pagesës së dividendëve etj.

Investitorët përdorin informacionin kontabël për të bërë vlerësimin e aksioneve të tyre dhe shpesh mund të përfshihen në iniciativa të menaxhimit të fitimeve. Rezultatet empirike tregojnë se këto iniciativa ndeshen jo rrallë. Një situatë e tillë mund të jetë rasti i ofertave fillestare publike (IPO) në tregun e kapitalit (Teoh 1998). Gjithashtu, fitimi mund të menaxhohet qëllimisht për të favorizuar ose jo marrëdhëniet kontraktuale me të tretët. Disa studime evidentojnë raste të iniciativave të menaxhimit të fitimit për të shmangur pengesat në lidhje me huamarrjen (Sweeney 1994). Disa të

tjera sjellin argumente se menaxherët rrisin fitimin me qëllim rritjen e shpërblimit të tyre aktual apo të ardhshëm (Holthausen 1995). Po ashtu, P.Sercu, H. Vander Bauwhede dhe Willekens (2002), sjellin evidencë në lidhje me menaxhimin e fitimeve, me qëllim reduktimin e tatimeve si dhe në lidhje me politikat e kreditimit duke ndikuar në marrëdhëniet me bankat apo kreditorë të tjerë. Healy dhe Wahlen (1999), klasifikojnë këto motive në: motivet që lidhen me tregun e kapitalit, motivet kontraktuale dhe të tjera.

### **Motivet që lidhen me tregun e kapitalit**

Analistët financiarë përdorin informacionin që rrjedh nga pasqyrat financiare, dhe nga burime të tjera për të përcaktuar ecurinë e ardhshme të një firme. Elementët kryesor të këtij procesi janë parashikimi i të ardhurave nga shitja dhe fitimi i periudhës. Analistët përgjithësisht vendosin objektiva në lidhje me realizimin e këtyre treguesve në periudha afatshkurtra, që janë të rëndësishme për t'u arritur sepse në të kundërt mund të rrezikohet vlera e aksioneve të shoqërisë në treg. Sipas DeAngelo (1988), fitimi i periudhës është një tregues i rëndësishëm i shoqërive në tregun e kapitalit. Ai ngre hipotezën se menaxherët e shoqërive blerëse tentojnë të zvogëlojnë fitimin dhe nga ekzaminimi i ndryshimit të rrjedhjeve rezulton se menaxherët e shoqërive blerëse nuk përfshihen shumë në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Perry dhe Williams (1994) ekzaminuan rrjedhjet jonormale duke kontrolluar për ndryshime në të ardhura gjë që tregoi për një prirje negative ose fitim të reduktuar nga shoqëritë blerëse në tregun e kapitalit. Studime të tjera evidentojnë rritje të fitimeve të raportuara gjatë periudhave të ofertave për kapital. Erikson dhe Wang (1999) hetuan në lidhje me menaxhimin e fitimeve të raportuara gjatë periudhës para shpalljes së bashkimit të aksioneve, në një kampion shoqëriish përvetësuese të aksioneve. Rezultatet tregojnë se fitimet menaxhohen pozitivisht, kjo në përputhje dhe me përfundimin se shoqëritë përpiqen të përmirësojnë rezultatet e raportuara me qëllim rritjen e çmimit të aksioneve të tyre në tregun e kapitalit. Cohen dhe Zarowin (2010) hetuan mbi praktikën e menaxhimit të fitimeve të ndërmarra nga shoqëritë përpara procesit të ofertave sezonale të kapitalit. Ata evidentuan se këto shoqëri menaxhojnë ndjeshëm fitimet duke i zmadhuar ato artificialisht, pikërisht përpara këtij procesi. Ndërkohë që periudhat post ofertave sezonale të kapitalit reflektojnë një performancë

të dobët të veprimtarisë së shfrytëzimit, si pasojë e aktiviteteve të ndërmarra për të menaxhuar fitimet.

### **Motivet kontraktuale**

Një shoqëri ekonomike mund të përkufizohet si një formë ligjore organizimi tek e cila hyjnë në marrëdhënie kontraktuale shumë palë të interesuara (Jensen and Meckling 1976). Me qëllim që kjo shoqëri të funksionojë me efikasitet të plotë është e rëndësishme që të përpilohen dhe zbatohen kontrata me punonjësit, furnitorët, kreditorët, klientët etj. Por, ekzistenca pikërisht e kontratave mund të stimulojë iniciativat e menaxhimit të fitimeve dhe është e vështirë, madje e kushtueshme, që këto iniciativa të monitorohen dhe për më tepër të korrigjohen (Watts and Zimmerman 1978).

#### ➤ **Kontratat e kompensimit**

Fitimi i periudhës është një tregues i rëndësishëm i performancës së një shoqërie dhe shpesh përdoret si tregues bazë në lidhje me skemat e kompensimit të menaxherëve. Ekzistenca e konfliktit të agjencisë është një nga faktorët nxitës të iniciativave oportuniste të menaxherëve për të ndërhyrë mbi shifrat kontabël në mënyrë që të përmirësojnë rezultatet e raportuara dhe të rrisin reputacionin e tyre. Në rastet kur pronësia është e ndarë nga menaxhimi është më se e qartë që interesat e dy grupimeve (menaxherë dhe pronarë) divergjojnë. Menaxherët mund të nxitën për të ndërmarrë iniciativat e menaxhimit të fitimeve, duke përmirësuar rezultatet e raportuara me qëllim që të përfitojnë nga bonuset, nëse shpërblimi i tyre është i lidhur me to dhe të rrisin reputacionin duke u pozicionuar më mirë në hierarkinë e menaxhimit (Salamon dhe Smith, 1979). Sa më pak të përfshihen pronarët në menaxhim, aq më shumë gjasa ka që menaxherët të ndërhyjnë për të ndryshuar shifrat kontabël të raportuara. Healy (1985) sjell evidencë në lidhje me iniciativat e menaxhimit të fitimeve në rastet kur shpërblimi i menaxherëve varet nga përmbushja objektive lidhur me realizimin e fitimit. Ai shpjegon se nëse fitimet janë nën kufirin e vendosur si objektiv për t'u realizuar, menaxherët ka gjasa të menaxhojnë negativisht fitimin, duke reduktuar të ardhurat me qëllim transferimin e tyre në periudhat pasardhëse, duke rritur shanset e marrjes së bonuseve në të ardhmen. Nëse fitimet janë ndërmjet kufijve të lejuar ka gjasa që menaxherët të menaxhojnë fitimin pozitivisht duke rritur të ardhurat e njohura të periudhës me qëllim maksimizimin e fitimit dhe për rrjedhojë dhe

maksimizimin e shpërblimeve vetjake në këto periudha. Nëse fitimi rezulton të jetë tejkaluar ka gjasa që menaxherët të menaxhojnë fitimin negativisht.

### ➤ **Kontratat e huamarrjes**

Marrëdhënie të rëndësishme kontraktuale për shoqërinë janë edhe ato me kreditorët. Pra, shoqëritë marrin borxh për të financuar një pjesë të aktivitetit të tyre dhe me rritjen e borxhit mund të rriten dhe konfliktet midis aksionarëve dhe huadhënësve. Sa më e madhe të jetë “leva” financiare e një shoqërie (raporti detyrime totale/aktive totale), aq më i madh mund të jetë rreziku i shkeljes së kontratave dhe njëkohësisht edhe kostoja e financimit me borxh (Smith and Warner, 1979). Kështu shoqëritë mund të menaxhojnë shifrat kontabël për të përmirësuar rezultatet, me qëllim që të zvogëlojnë raportin e levës financiare dhe të prodhojnë indikatorë më të mirë, në rastet kur lind nevoja për të kontraktuar me huadhënësit. Në këtë kontekst mund të pritët një lidhje pozitive midis menaxhimit të fitimeve dhe levës financiare. Por, mos harrojmë që sa më shumë të jetë financuar me borxh aktiviteti i shoqërisë, aq më shumë rritet presioni i huadhënësve ndaj shoqërisë, aq më të kujdesshëm janë ata duke ushtruar kontrollë më të shpeshta dhe më të detajuara të treguesve dhe aktivitetit të saj. Kjo do të thotë që menaxhimi ka më pak mundësi për të ndërmarrë iniciativë të qëllimshme, për të përmirësuar në dukje treguesit e performancës së shoqërisë.

Studime të tjera tregojnë për lidhje pozitive midis “levës” financiare dhe iniciativave të menaxhimit të fitimeve (Beneish 1997, Sweeney 1994). Për të shmangur ndonjë prishje të kontratave të borxhit shoqëritë me levë të madhe financiare ndërmarrin iniciativë duke menaxhuar pozitivisht fitimin (Becker et al 1998, Sweeney 1994). Nga ana tjetër shoqëritë me “levë” të lartë financiare mund të rezultojnë në probleme financiare. Ato mund të përpiqen të rinegociojnë me huadhënësit për të rimarrë hua dhe kështu mund të përfshihen në iniciativat e menaxhimit të fitimeve ( DeAngelo dhe Skinner 1994).

### **Motive të tjera**

Në literaturën mbi menaxhimin e fitimeve ka studime të cilat tregojnë për mënyrën sesi menaxherët përpiqen të minimizojnë kostot politike, p.sh në rastet kur qeveria mund të ndërhyjë nëpërmjet reformave rregullatore dhe sistemit të tatim - taksave. Watts dhe Zimmerman (1978), Holthausen dhe Leftwich (1983), Lim dhe Matolcsy

(1999). Një nga motivet që në fakt ka tërhequr vëmendjen e disa studiuesve është edhe ai i lidhur me fshehjen e fitimeve reale me qëllim reduktimin e pagesave të tatimit mbi të fitimin. Sercu, Bauwhede dhe Willekens (2002) në një studim të realizuar me një kampion të përbërë nga shoqëri private në Belgjikë gjejnë evidencë në lidhje me reduktimin e fitimeve me qëllim reduktimin e tatimeve. Gjithashtu, në përfundime të ngjashme arritën edhe Coppens dhe Peek (2005) në një studim mbi shoqëritë private në Europë. Monem (2003) argumentonte se menaxherët mundohen të shmangin tatim-taksat nëpërmjet menaxhimit negativisht të fitimeve (duke i reduktuar ato) sepse, rezultatet e raportuara janë bazë për llogaritjen e detyrimeve për tatimet dhe taksat. Kështu mund të mendohet se menaxherët në kompromis dhe me pronarët planifikojnë nivele të pranueshme të fitimit të tatueshëm dhe rrjedhimisht planifikojnë nivele të pranueshme të tatimit mbi fitimin, me qëllim përmbushjen e shifrave të planifikuara. Kështu ata mund të përfshihen në iniciativa të menaxhimit të fitimeve.

Megjithatë cilado që të jenë motivet që nxisin menaxherët apo dhe pronarët të përfshihen në iniciativat e menaxhimit të fitimeve, duhet të pranojmë që ato mund të rezultojnë në degradim të cilësisë së informacionit financiar.

### **2.3 Matja e menaxhimit të fitimeve**

Vrojtimi i procesit të ndërhyrjeve të menaxherëve mbi fitimin e raportuar, praktikisht është i pamundur. Pra, është e vështirë të përcaktohet në mënyrë sasiore se sa është menaxhuar fitimi. Për këtë arsye në analizat empirike është i nevojshme përdorimi i treguesve që përfaqësojnë fenomenin dhe që bëjnë të mundur matjen e tij.

Studiues të ndryshëm kanë përdorur tregues përfaqësues për të bërë të mundur evidentimin e menaxhimit të fitimit. Përgjithësisht ata përcaktojnë këtë fenomen nëpërmjet llogaritjes së rrjedhjeve jonormale të cilat përcaktohen nga shkalla e gabimit që rezulton nga diferenca midis rrjedhjeve totale (RT) dhe rrjedhjeve normale (RN). Pra, modelet fillimisht llogarisin rrjedhjet totale dhe më pas ato ndahen në komponent normal dhe jonormal. Në këtë këndvështrim rrjedhjet totale janë shuma aritmetike e rrjedhjeve normale (të pritshme) dhe rrjedhjeve jo normale (RJN) (jo të pritshme). Janë pikërisht rrjedhjet jonormale evidenca e së cilave reflekton për veprime të ndërmarra nga menaxherët për faktin se ato nuk justifikohen nga ecuria normale e treguesve të biznesit.

Modelet që serviren shpesh në studimet mbi menaxhimin e fitimeve dhe që përdoren për të zbërthyer rrjedhjet totale në normale dhe jo normale janë Modeli Healy (1985), Modeli DeAngelo (1986), Modeli Jones (1991), Modeli Jones i Modifikuar (Dechow, Sloan dhe Sweeney 1995), Modeli i Industrisë (Dechow, Sloan dhe Sweeney 1995), dhe Modeli Jones Cross-Sectional (DeFond dhe Jiambalvo 1994), Modeli i Zgjeruar Jones – Cash Flow (Kasznik 1999), Modeli i Matjes së Performancës (Kothari, Leone dhe Wasley (2005), etj..

Në mënyrë të përmbledhur disa prej modeleve të sipërpërmendura jepen në vijim:

➤ **Modeli Healy (1985)**

Healy (1985) startoi me përpjekjet më të hershme në literaturat që kanë trajtuar menaxhimin të fitimeve për të vlerësuar këtë fenomen nëpërmjet devijimit të nivelit normal të rrjedhjeve totale. Në këtë model përfshihen rrjedhjet në kapitalin punues të cilat përcaktohen sipas zërave të bilancit, ku:

$$RT = \Delta AQ - \Delta DASH - \Delta CASH + \Delta B - Am \quad (1)$$

$$TA = \Delta CA - \Delta CL - \Delta CASH + \Delta STD - Dep \quad (1)$$

Ku :

RT (TA) = Rrjedhjet Totale në Kapitalin Punues (*total accruals*)

AQ ( $\Delta CA$ ) = Ndryshimi në Aktivet Afatshkurtra, (*change in current assets*)

DASH( $\Delta CL$ ) = Ndryshimi në Detyrime Afatshkurtra, (*change in current liabilities*)

CASH – Ndryshimi në Mjete Monetare, (*change in cash and cash equivalents*)

B ( $\Delta STD$ ) = Ndryshimi në Borxh Afatgjatë i përfshirë në Detyrimet Afatshkurtra (*change in debt included in current liabilities*)

Am (Dep) = Shpenzimet e Amortizimit të periudhës (*depreciation and amortization expense*)

Sipas këtij ekuacioni, Healy përcakton Rrjedhjet Totale në secilën periudhë. Ndërsa rrjedhjet normale i përcakton me raportin e mëposhtëm

$$RN = \frac{\sum \left( \frac{RT}{A_t - 1} \right)_{it}}{n} \quad (2)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion rezulton si më poshtë :

$$NDA = \frac{\sum \left( \frac{TA}{A_t - 1} \right)_{it}}{n} \quad (2)$$

Ku :

RN ( NDA) = Rrjedhjet normale ( *nondiscretionary accruals*)

A = Aktivet totale (*Total assets*)

n= numri i viteve në periudhën e vlerësimit (*the number of years in the estimation period*)

Diferenca e ekuacionit 1 dhe 2, pra Rrjedhjeve Totale me ato Normale përcakton Rrjedhjet Jonormale. Modeli Healy mbështetet mbi supozimin se vlera e rrjedhjeve jo-normale të pritshme është zero dhe nëse diferenca midis rrjedhjeve totale (ekuacioni 1) dhe rrjedhjeve normale (ekuacioni 2) është jo-zero atëherë kjo vjen si rezultat i menaxhimit të fitimeve.

➤ **Modeli DeAngelo (1986)**

Sipas DeAngelo, rrjedhjet normale varen nga rrjedhjet totale të periudhës paraardhëse (t-1). Ky model supozon se rrjedhjet totale në vitin aktual janë të barabarta me rrjedhjet totale të vitit paraardhës. Pra, nëse diferenca midis tyre është jo-zero kjo evidenton rrjedhjet jonormale që janë të lidhura me menaxhimin e fitimit.

$$RJN = (RT t) - (RT t - 1)(3)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion rezulton si më poshtë :

$$DA = (TA t) - (TA t - 1)(3)$$

**Ku:**

RJN (DA)= Rrjedhjet jonormale ( *Discretionary accruals*)

RT (TA)=Rrjedhjet totale ( *Total accruals*)

➤ **Modeli Jones (Jones 1991)**

Ndërsa, Jones përcakton se rrjedhjet jonormale varen nga rrethana dhe situata të ndryshme të gjendjes financiare të shoqërisë. Ai supozon se variacioni i të ardhurave nga shitja sjell ndryshime mbi kapitalin punues dhe si rrjedhojë ndryshime në

rrjedhjet totale. Gjithashtu, amortizimi i aktiveve afatgjata materiale sjell ndryshime mbi rrjedhjet totale. Kështu, Jones në regresionin e tij, si variabla të pavarur që përcaktojnë rrjedhjet normale përdor ndryshimin e të ardhurave nga shitja dhe Aktivet Afatgjata Materiale Bruto dhe propozon modelin e mëposhtëm për të zbërthyer rrjedhjet totale në komponent normal dhe jonormal. Pra, rrjedhjet totale të pritshme shprehen nga një funksion regresioni i shumëfishtë linear, ku variablat që i shpjegojnë ato janë 1) e ardhura nga shitja (për të kontrolluar nevojat në kapitalin punues p.sh inventarët, llogaritë e arkëtueshme), dhe 2) aktivet e afatgjata materiale bruto (për të kontrolluar amortizimin normal të tyre).

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \varepsilon_{it} \quad (4)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion regresioni rezulton si më poshtë :

$$\frac{NDA_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta REV_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{PPE_{it}}{A_{i,t-1}} + \varepsilon_{it} \quad (4)$$

Ku:

$RN_{it}$  (  $NDA_{it}$ ) rrjedhjet normale në vitin  $t$  (*non discretionary accruals of the year t*)

$SHITJE$  (  $REV$ ) = ndryshimi në të ardhura nga shitja nga viti  $t$  në krahasim me vitin  $t-1$  (*changes in revenues between years t and t-1*)

$AAGJB_{i,t}$  (  $PPE_{it}$ ) = Aktivet afatgjata materiale bruto për shoqërinë  $i$  në vitin  $t$  (*gross property plant and equipment in the year t*)

$A_{i,t-1}$  = Aktivet në total për shoqërinë  $i$  në fillim të vitit  $t$  (*total assets at the beginning of year t*)

Rrjedhjet jonormale më pas llogariten si diference e rrjedhjeve totale dhe rrjedhjeve normale të parashikuara sipas regresionit të mësipërm. Vlerat jo-zero të kësaj diference evidentojnë fenomenin e menaxhimit të fitimeve.

➤ **Modeli Jones i Modifikuar (Dechow, Sloan dhe Sweeney 1995),**

Ky është modeli më popullore i përdorur gjerësisht në literaturat e menaxhimit të fitimeve. Modeli Jones supozon se ndryshimi i të ardhurave nga shitja përcaktohet

krejtësisht si rrjedhje normale, por menaxherët mund të përdorin shitjet me kredi për të menaxhuar fitimin. Kështu në Modelin Jones të Modifikuar, Dechow, Sloan dhe Sweeney propozojnë korrigjimin në model të të ardhurave nga shitja me ndryshimin në llogaritë e arkëtueshme.

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it} - \Delta LLOG ARK_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \epsilon_{it} \quad (5)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion regresioni rezulton si më poshtë :

$$\frac{NDA_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{(\Delta REV_{it} - \Delta REC_{it})}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{PPE_{it}}{A_{i,t-1}} + \epsilon_{it} \quad (5)$$

Ku :

$\Delta LLOG ARK_{it} (\Delta REC_{it})$  = Ndryshimi në llogari të arkëtueshme për shoqërinë *i*, në vitin *t* (*net receivables in year t less net receivables in year t - 1*)

Të gjithë variablat e tjerë janë të njëjtë me modelin Jones.

Ky model ka njohur përdorim të gjerë në shumë studime dhe është vlerësuar të jetë një instrument mjaft efektiv, në testimin e menaxhimit të fitimeve krahasuar me Modelin DeAngelo (1986) , Modelin Healy (1985), Modelin Jones (1991), Modelin e Industrisë (Dechow, Sloan, and Sweeney 1995).

#### ➤ **Modeli i Industrisë (Dechow, Sloan, dhe Sweeney 1995)**

Ky model mbështetet mbi argumentin se përkatësia në industri të ndryshme e aktiviteteve ekonomike, dikton ndryshime në nivelet e treguesve të kapitalit punues. Për të korrigjuar këtë ndikim ky model regreson rrjedhjet normale me vlerat e medianës së industrisë për rrjedhjet totale. Regresioni i propozuar në këtë model është:

$$RN_t = y_1 + y_2 \text{ Mediana } (RT / A_{t-1}) \quad (6)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion regresioni rezulton si më poshtë :

$$NDA_t = y_1 + y_2 \text{ Mediana } (TA / A_{t-1}) \quad (6)$$

Ku Mediana a RT (TA) = Vlera e medianës së rrjedhjeve totale për të gjitha aktivitetet ekonomike të koduara në të njëjtën industri, sipas klasifikimit të përgjithshëm industrial të aktiviteteve ekonomike.

Këto modele janë përdorur gjerësisht në studimet dhe të kohëve të fundit dhe jo rrallë ato vijnë gjithmonë duke u modifikuar në varësi të rasteve specifike dhe studimeve të veçanta si dhe duke implikuar në modele variabla të ndryshëm me qëllim kapërcimin e vështirësive gjatë aplikimit të modeleve. Dechow, Sloan, and Sweeney (1995) kanë vlerësuar performancën e tyre në lidhje me identifikimin e fenomenit të menaxhimit të fitimeve dhe gjithashtu, kanë treguar se Modeli Jones i Modifikuar është një instrument efektiv në testimin e menaxhimit të fitimeve. Gjithashtu autorë të ndryshëm kanë përcaktuar këtë model si eficient në evidentimin e rrjedhjeve jo normale, gjë që tregon për përfshirje të menaxherëve në praktikën e menaxhimit të fitimeve. Nga ana tjetër studiues të tjerë si Yoon (2006), Chen (2011) si dhe autorë të tjerë dokumentojnë se Modeli Jones i Modifikuar nuk është eficient në identifikimin e menaxhimit të fitimit duke propozuar modifikime të tjera në modelet e paraqitura prej tyre.

➤ **Modeli i Zgjeruar Jones – Cash Flow (Kasznik 1999)**

Kasznik (1999) i ka shtuar modelit Jones të Modifikuar ndryshimin në fluksin i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit, si një variabël që shpjegon lidhjen negative midis fluksit monetar nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe Rrjedhjeve Totale. Në gjetjet e tij ai tregon se menaxherët ndërhyjnë për të rritur fitimin duke e menaxhuar atë në rastet kur shifrat e parashikuara rezultojnë të mbivlerësuara. Rrjedhjet normale vlerësohen me regresionin e mëposhtëm.

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it} - \Delta LLOG ARK_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_3 \frac{\Delta CFO_{it}}{A_{i,t-1}} + \varepsilon_{it} \quad (6)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion regresioni rezulton si më poshtë :

$$\frac{NDA_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{(\Delta REV_{it} - \Delta REC_{it})}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{PPE_{it}}{A_{i,t-1}} +$$

$$\beta_3 \frac{\Delta \text{CFO}_{it}}{A_{i,t-1}} + \varepsilon_{it} \quad (6)$$

Ku  $\Delta \text{CFO}$  = Ndryshimi në fluksin mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit midis vitit  $t$  dhe  $t-1$  (*change in operating cash flow in year  $t$  relative to year  $t-1$* ).

Të gjithë variablat e tjerë janë të njëjtë me modelin Jones të Modifikuar.

➤ **Modeli i matjes së performancës (Kothari, Leone dhe Wasley (2005))**

Kothari, Leone dhe Wasley (2005) sjellin ndryshime të tjera në Modelin Jones të Modifikuar. Së pari ata shtojnë një konstante për të kontrolluar heteroskedasticitetin dhe së dyti shtojnë në model kthimin mbi aktivet si një variabël shtesë për të kontrolluar rrjedhjet jonormale. Regresioni shtrohet si më poshtë.

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 + \beta_1 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{\Delta \text{SHITJE}_{it} - \Delta \text{LLOG ARK}_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_3 \frac{\text{AAGJB}_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_4 \text{ROA}_{t-1} + \varepsilon_{it} \quad (7)$$

Në gjuhën origjinale ky funksion regresioni rezulton si më poshtë :

$$\frac{NDA_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{(\Delta \text{REV}_{it} - \Delta \text{REC}_{it})}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{\text{PPE}_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_3 \text{ROA}_{t-1} + \varepsilon_{it} \quad (7)$$

Ku  $\text{ROA}$  = Kthimi mbi Aktivet në periudhën (*return on assets*)

Të gjithë variablat e tjerë janë të njëjtë me modelin Jones të Modifikuar.

Në modelet e mësipërme vihet re se rrjedhjet totale, normale dhe jonormale janë vendosur në raport me aktivet totale në fillim të periudhës. Këto variabla në vetvete nuk mund ti vijnë në ndihmë analizave krahasuese, pra kur duam të krahasojmë periudha të ndryshme për të njëjtën shoqëri apo rrjedhjet për shoqëri të ndryshme. Është e kuptueshme që një shoqëri më e madhe do të llogarisë vlera më të mëdha të rrjedhjeve totale. Një nga mënyrat e përdorura gjerësisht për të bërë të krahasueshëm këta variabla është llogaritja e rrjedhjeve në raport me aktivet totale (përgjithësisht aktivet në fillim të periudhës e indeksuar  $A_{t-1}$ ). Për këtë arsye në të gjitha modelet e mësipërme rrjedhjet normale janë vendosur në raport me aktivet në fillim të periudhës dhe rrjedhimisht dhe të gjithë variablat e tjerë në ekuacionet e regresionit.

Disa prej modeleve të mësipërme janë pjesë e analizës empirike në këtë punim, në funksion të zbrërthimit të rrjedhjeve totale në komponent normal dhe jonormal, me qëllim matjen e menaxhimit të fitimit në kampionin e marrë në studim.

## **2.4 Vlerësime në lidhje me tregues të ndryshëm që ndikojnë te menaxhimi i fitimeve**

Menaxhimi i fitimeve ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Të shumta janë situatat dhe sektorët që merren në konsideratë në analizat e tyre empirike. Janë përfshirë në analiza efektet mbi menaxhimin e fitimeve të faktorëve si: përmasa e njësive ekonomike, struktura e kapitalit, leva financiare, procesi i auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, struktura e ndryshme organizative dhe qeverisëse etj.. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur shoqëri të ndryshme janë përfshirë në iniciativa mashtrimi dhe kjo shpesh është bërë pikënisje për studiuesit, për të zhvilluar analiza të vlefshme për investitorët, huadhënësit, politikëbërësit dhe grupet e ndryshme të interesave.

Douglas dhe Skinner (2012), duke marrë shkas nga ngjarje jo të zakonshme në tregun e auditit në Japoni studiuuan reputacionin e shoqërive të mëdha të auditimit, klientët e mëdhenj të cilave ishin përfshirë në iniciativa flagrante, masive, mashtrimi. Bëhet fjalë për reputacionin e shoqërive të mëdha ndërkombëtare “Big 4” që ushtronin aktivitetin e tyre në Japoni. Këto ngjarje që i përkasin vitit 2006 dhe të tjera që pasuan, përftuan evidencë në lidhje me rëndësinë e reputacionit të audituesve. Kryesisht shoqëritë e mëdha dhe ato me nivel rritjeje më të madhe prishën kontratat me audituesit “Big 4”, reputacioni i të cilave konsiderohej se ishte prekur nga ngjarjet e identifikuar si skandale financiare të një shoqërie të madhe kozmetike. Japonia, ku thuajse nuk ekzistojnë akte të kontestimit të procesit të auditimit përbën një mjedis të mirë për të shqyrtuar rëndësinë e reputacionit të shoqërive audituese. Në analizë është përdorur regresioni logit shumëvariabëlsh, ku si variabël i varur është mundësia e ndryshimit të audituesit (i shprehur me variabël dikotomik), dhe variabla të pavarur si indekset për ngjarjet e ndodhura, menaxhimi i fitimeve i llogaritur sipas modelit Jones të modifikuar(1995), leva financiare, fitimet vjetore, rritja vjetore e shitjeve, pjesa e investitorëve të huaj në kapitalin aksionar, madhësia e shoqërisë, pjesa e shitjeve të realizuara nëpërmjet eksporteve etj. Autorët kanë arritur në përfundimin se cilësia e auditimit është një faktor i rëndësishëm për shoqëritë që operojnë në tregun

japonez. Por, përtej rezultateve të gjetura, mendoj se ky studim inicion nga një rast i veçantë dhe si i tillë mund të mos jetë një konkluzion që përgjithëson çdo rast.

#### **2.4.1 Cilësia e auditimit dhe lidhjet e tij me menaxhimin e fitimeve**

Sipas ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, shoqëritë që përmbushin kriteret duhet ti nënshtrohen procesit të auditimit të raporteve financiare vjetore. Dhe nëse ky proces nuk është cilësor, atëherë menaxherë oportunistë mund të përfshihen lehtësisht në praktikat e menaxhimit të fitimeve, me rezultat degradimin e cilësisë së informacionit financiar.

Cilësia e auditimit mund të përkufizohet si *“plotësimi i nevojave të investitorëve për raporte të besueshme dhe të pavarura të auditimit në lidhje me 1) kontrollin e pasqyrave financiare dhe informacionin shpjegues që rrjedh nga ky proces, 2) sigurimin në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe 3) paralajmërimin në lidhje me treguesit që mund të përbëjnë shqetësim”*.<sup>2</sup>

Si lidhet menaxhimi i fitimeve me cilësinë e auditimit?

Menaxhimi i fitimit përben një element thelbësor të procesit të auditimit, i cili në fund të fundit konsiston në : 1) evidentimin e parregullsive dhe 2) mundësinë e raportimit të tyre (DeAngelo, 1981). Duke supozuar se aftësitë teknike për të zbuluar parregullsi janë të njëjta për auditues të ndryshëm, cilësia e procesit të auditimit sigurisht që është një çështje që i përket pavarësisë së këtij procesi.

Procesi i auditimit dhe cilësia e tij është provuar se ka lidhje negative me asimetrinë e informacionit, Greg, Donald dhe Tingting (2010), e cila është një nga situatat kur menaxhimi i fitimit ka më shumë gjasa të ndodhë. Ata në një kampion prej 4,062 firmë – vit vrojtimesh për periudhën 2002-2005, evidentuan se asimetria e informacionit reduktohet nëse shoqëritë kanë kontraktuar “Auditues BigN”. Pra, audituesit luajnë rol në reduktimin e asimetrisë së informacionit dhe një prej situatave të tilla është dhe procesi i Ofertave Publike Fillestare. Titan dhe Trueman (1986)

---

<sup>2</sup> Public Company Accounting Oversight Board. Working paper developed by the Office of Research and Analysis, available at [www.pcaobus.org](http://www.pcaobus.org)

ndërtojnë një model sipas të cilit çmimi i aksioneve tenton të ngrihet nëse shoqëritë ofruese risin cilësinë e informacionit të përftuar në këtë proces. Gjithashtu, Datar (1991) gjen se asimetria e informacionit zbutet në sajë të veprimtarisë së shoqërive audituese.

Gjatë hulumtimit të literaturave, përgjithësisht vërehet se audituesit e specializuar ka të ngjarë të evidentojnë praktikat që lidhen me menaxhimin e fitimeve dhe të jenë me konservatorë në lidhje me to. Studime të tjera mbi cilësinë e auditimit fokusohen mbi ndryshimet që ekzistojnë midis audituesve BigN dhe jo Big N. Becker (1998) në një kampion prej 13,479 firmë-vit vrojtimesh identifikuan cilësinë e auditimit nëpërmjet variabëlilit dikotomik (Big6 dhe JoBig6) ndërsa menaxhimin e fitimeve të shprehur nga rrjedhjet jonormale të vlerësuara sipas Modelit Jones (1991). Ai gjen se klientët e audituesve jo Big6 rezultojnë të menaxhojnë më shumë fitimet se sa klientët e shoqërive Big6.

Tendeloo dhe Vanstraelen (2005) analizuan cilësinë e auditimit në shoqëritë private që përbëjnë dhe pjesën më të madhe të aktivitetit ekonomik në tregun europian. Analiza empirike përfshiu gjashtë vende të Europës dhe konkretisht Belgjikën, Finlandën, Francën, Holandën, Spanjën dhe Anglinë. Rezultatet treguan se kishte ndryshime të dukshme në cilësinë e auditimit, nëse në këtë proces përfshiheshin ose jo shoqëri Big 4. Në këtë kontekst, shoqëritë e mëdha të auditimit kanë më pak gjasa të kryejnë auditime me cilësi të ulët, sepse dështimi i këtij procesi do t'iu kushtojë humbjen e klientëve ( të mëdhenj) dhe tarifave të auditimit (DeAngelo, 1981).

Piot, Janin dhe Rémi (2005), investiguan efektet e variablave të cilësisë së auditimit mbi menaxhimin e fitimeve në kontekstin francez në një kampion prej 255 firmë - vit vrojtimesh, për një periudhë prej tre vitesh. Si tregues për menaxhimin e fitimeve janë përdorur rrjedhjet jonormale sipas Modelit Jones (1991). Vlera absolute e rrjedhjeve jonormale është përdorur si tregues për iniciativat që rezultojnë në rritje apo në rënie të fitimeve të raportuara. Analiza shumë-variabëlshë e përdorur ka treguar se: 1) procesi i auditimit i ndërmarrë nga një Big5 ose Jo Big5 nuk ka ndryshim, pra nuk ndikon në treguesin e menaxhimit të fitimeve, 2) prezenca në shoqëri e audituesve të brendshëm shoqërohet me zvogëlim të vlerave të rrjedhjeve jonormale, pra me implementim të një sistemi kontabël më konservator dhe 3) leva financiare ka efekte

negative mbi menaxhimin e fitimeve, pra sa me shumë të jetë financuar me borxh aktiviteti i shoqërisë ,aq më e vogël është mundësia për të menaxhuar fitimet.

Ken, Kuen-Lin Jian (2005), investiguan lidhjen e cilësisë së auditimit të matur nga madhësia e audituesit e specializimi sipas industrisë dhe menaxhimit të fitimeve i matur nga rrjedhjet jo normale në tregun e Tajvanit. Studimi morri shkas nga punime të mëparshme të ngjashme të bëra në tregun amerikan. Duke konsideruar ndryshimet që ekzistonin ndërmjet dy vendeve u pa me vend që kjo lidhje të studiohej dhe në tregun e Tajvanit. Kampioni i marrë në konsideratë ishin shoqëritë në momentin e Ofertave Fillestare Publike (IPO), prej të cilës u studiuua një kampion prej 367 njësisish të reja për periudhën kohore 1999-2002. Metodologjia e përdorur konsideroi përdorimin e Modelit Jones të Modifikuar për vlerësimin e menaxhimit të fitimeve. Hipotezat e testuara parashikonin se në shoqëritë, auditimi i të cilave realizohet nga auditues më cilësorë kishin të ngjarë të përfshihen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Gjetjet treguan se audituesit më cilësorë ishin më konservatorë në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimit dhe cilësia e auditimit ishte një përcaktues i rëndësishëm i tij në procesin e Ofertave Fillestare Publike në tregun e Tajvanit.

Carcello, Hollingsworth, Klein dhe Neal (2006) ekzaminuan lidhjen midis ekspertizës kontabël, mekanizmave qeverisës të shoqërive dhe menaxhimit të fitimeve në një kampion prej 283 shoqëri me aktivitet jo financiar. Menaxhimi i fitimeve është shprehur nga rrjedhjet jo normale të llogaritura sipas modelit Jones të Modifikuar ( të dhëna të trajtës cross sectional) duke mbështetur faktin që ky model është matës efektiv i rrjedhjeve jonormale. Rezultatet tregojnë se nuk ka një lidhje të rëndësishme midis ekzistencës së komiteteve të ekspertëve kontabël dhe menaxhimit të fitimeve.

Gerayli, Yanesari dhe Ma'atoofi (2011) në punimin e tyre të realizuar mbi një kampion prej 90 shoqëri jofinanciare në tregun iranian, për periudhën kohore 2004-2009 përfytuan evidencë në lidhje me ndikimin që kishte cilësia e auditimit mbi rrjedhjet jonormale. Ata përdorën tre tregues të ndryshëm të cilësisë së auditimit (madhësinë, specializimin dhe pavarësinë e audituesit). Rezultatet treguan për lidhje negative midis rrjedhjeve jonormale dhe cilësisë së auditimit. Autori arriti në përfundimin sesa më e vogël të ishte cilësia e auditimit aq më fleksibël ishin praktikën kontabël dhe aq më shumë gjasa kishte që të ndërmerreshin iniciativat e menaxhimit të fitimit.

Ndërsa, Alves. S, (2013) në një kampion prej 33 shoqëriish jofinanciare në Portugali, për periudhën 2003-2009, nëpërmjet regresionit të shumëfishtë linear, (metoda e katrorëve më të vegjël) ekzaminoi efektin që kishin mekanizmat e auditimit të aktivitetit (audituesit e jashtëm dhe ekzistenca e komiteteteve të auditimit), mbi menaxhimi e fitimeve. Gjetjet, në divergjencë me punimet e tjera treguan për lidhje pozitive ndërmjet cilësisë së auditimit dhe rrjedhjeve jonormale. Autori sugjeroi se ekzistenca e audituesit të jashtëm dhe komiteteve të auditimit të brendshëm, së bashku reduktojnë ndjeshëm iniciativat e menaxhimit të fitimeve.

Yasar (2013) testoi empirikisht hipotezën: “Shoqëritë me auditues Big4 ka të ngjarë të raportojnë të njëjtin nivel të rrjedhjeve jonormale si dhe shoqëritë që auditohen nga jo Big4”. Studimi u shtri në një kampion prej 290 firmë - vit vrojtimesh, nga shoqëri të listuara në bursën e Stambollit, në industrinë përpunuese për periudhën kohore 2003-2007. Rrjedhjet jonormale sipas modelit Jones të modifikuar (1995) u përdorën për të përfaqësuar menaxhimin e fitimeve, ndërsa madhësia e audituesit si variabël dikotomik u përdorur për të identifikuar cilësinë e auditimit. Variablat u regresuan së bashku dhe me variabla të tjerë kontrolli. Rezultatet treguan se madhësia e audituesit nuk ndikonte në zvogëlimin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin turk.

Ndryshimet në cilësinë e auditimit duke krahasuar shoqëritë e mëdha të auditimit dhe shoqëritë e vogla ka qenë gjithashtu objekt diskutimi, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë publik. Becker (1998) e Francis (1999) e kanë trajtuar këtë fenomen në shoqëritë publike dhe treguan se shoqëritë Big4 ndikojnë duke kufizuar iniciativat e menaxhimit të fitimeve në këtë sektor.

Në studimet e sipërpërmendura janë marrë në konsideratë përgjithësisht audituesit e jashtëm, por duhet të përmendim se rol të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së informacionit financiar kanë dhe audituesit e brendshëm. Në literaturat mbi menaxhimin e fitimeve më rrallë ekzaminohet lidhja e këtij fenomeni me procesin e auditimit të brendshëm. Douglas, Jason dhe Wood (2009) ekzaminojnë këtë lidhje në një kampion prej 528 firmë - vit vrojtimit. Ata kanë matur cilësinë e auditimit të brendshëm nëpërmjet një matësi të përbërë nga disa komponentë individual, si: 1) eksperiencia, 2) çertifikimi, 3) trajnimet, 4) koha kur audituesit e brendshëm performojnë në auditimin financiar në përqindje me kohën totale dhe 5) shuma e shpenzuar nga shoqëria për auditimin e brendshëm në raport me aktivet totale. Ndërsa

masin menaxhimin e fitimeve nëpërmjet: 1) vlerës absolute të rrjedhjeve jo normale dhe 2) tendencës për të përmbushur fitimin e parashikuar. Ata evidentojnë se cilësia e auditimit të brendshëm ka një ndikim të moderuar negativ mbi menaxhimin e fitimeve. Schneider and Wilner (1990) në gjetjet e tyre tregojnë se si auditimi i jashtëm ashtu dhe ai i brendshëm në mënyrë të ngjashme, sigurojnë cilësinë e raporteve financiare dhe bëjnë të mundur gjetjen e parregullsive.

### 2.4.2 Madhësia e shoqërisë dhe menaxhimi i fitimeve

Madhësia e shoqërisë në shumë analiza empirike të sjella nga autorë të ndryshëm është një nga faktorët që tregohet të ketë ndikim mbi menaxhimin e fitimeve. Kështu Burgstahler dhe Dichiv (1997) analizuan ndikimin e menaxhimit të fitimit mbi humbjet e raportuara të shoqërive në një kampion prej 300 shoqërish në Amerikë. Rezultatet treguan se si shoqëritë e vogla dhe ato të mëdha, menaxhojnë fitimet e tyre për të shmangur humbjet të vogla ose rëniet e vogla të fitimeve. Në 8-12 % të rasteve, shoqëritë kanë menaxhuar paraprakisht të ardhurat me qëllim rritjen e fitimeve dhe 30-44 % e shoqërive raportuan fitim të vogël negativ, në vend të fitimit real pozitiv duke menaxhuar rrjedhjet. Gjithashtu gjetjet treguan se fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe ndryshimet në kapitalin punues janë mënyra për të menaxhuar lehtësisht fitimin. Për më shumë, iniciativat e menaxhimit të fitimeve vërehen të jenë të pranishme më tepër te shoqëritë e mesme dhe të mëdha sesa tek ato të vogla.

Kim, Liu Rhee (2003) ekzaminoi empirikisht nëpërmjet një analize propabilitare, lidhjen midis menaxhimit të fitimit dhe madhësisë së shoqërisë, në shoqëri të vogla të mesme dhe të mëdha, në një kampion që përfshin një periudhë prej 18 vitesh. Gjetjet treguan se shoqëritë e vogla të mesme dhe të mëdha përfshiheshin në iniciativat e menaxhimit të fitimeve me qëllim shmangien e raportimit të humbjeve të vogla apo rëniet e vogla të fitimit. Megjithatë madhësia e shoqërisë ka ndikim të rëndësishëm mbi këto iniciativa. Rezultatet treguan se shoqëritë e vogla përfshiheshin më pak, duke shmangur menaxhimin e fitimeve në krahasim me shoqëritë e mesme dhe të mëdha.

Ahmed, Al-khabash, Thuneibat (2008) analizuan në punimin e tyre lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve, duke e parë problemin në këndvështrimin e auditit të brendshëm dhe të jashtëm në tregun jordanëz. Nga analiza

empirike u vu re se shoqëritë përfshiheshin ndjeshëm në iniciativa legale të menaxhimit të fitimeve (rritje ose zvogëlime të fitimeve), por nuk kishte ndonjë ndryshim për nga këndvështrimi i audituesve të jashtëm dhe të brendshëm në lidhje me këtë fenomen. Gjithashtu, në punim analizohej edhe menaxhimi i fitimeve duke konsideruar edhe madhësinë e shoqërisë. Gjetjet nuk treguan për ndryshime në praktikën e menaxhimit të fitimeve kur krahasoheshin shoqëritë e mëdha dhe të vogla në tregun jordanez.

Naz, Bhatti, Ghafoor dhe Husein (2011) në punimin e tyre shqyrtuan ndikimin e madhësisë së shoqërisë dhe strukturës së kapitalit mbi menaxhimin e fitimeve në tregun pakistanez. Kampioni i shqyrtuar përbëhej nga 75 shoqëri për të cilat u grumbulluan të dhëna për periudhën 2006- 2010. Në analizën empirike të përfutur aktivitetit totalë u përdorën si variabël përfaqësues i madhësisë së shoqërisë, raporti i borxhit si përfaqësues i strukturës së kapitalit dhe rrjedhjet jonormale të llogaritura sipas Modelit Jones (1991) u përdorën për të përfaqësuar menaxhimin e fitimeve. Rezultatet treguan për një lidhje negative, statistikisht të rëndësishme të strukturës së kapitalit mbi menaxhimin e fitimeve, ndërsa rezultatet për ndikimin e madhësisë së shoqërisë rezultuan jo të rëndësishme statistikisht.

Paiva dhe Lourenço (2013) hetuan gjithashtu mbi efektin që kishte madhësia e shoqërisë mbi nivelin e rrjedhjeve jonormale në një kampion prej 1,044 firmë - vit vrojtme, për shoqëri të listuara në bursën e Londrës në Mbretërinë e Bashkuar për periudhën kohore 2006-2010. Specifike në këtë studim është se kampioni i marrë në konsideratë i përkiste biznesit familjar. Rrjedhjet jonormale sipas modelit Kothary (2005) përfaqësonin menaxhimin e fitimeve ndërkohë që në regresin e parashtruar shoqëritë u klasifikuan si të mëdha dhe të vogla, duke përdorur variabël dikotomik me vlera 1 dhe 0 vlerësuar nëpërmjet mesatares së vlerave të logaritmit natyror të shitjeve neto dhe logaritmit natyror të aktiveve totale. Variabla të tjerë kontrolli u përfshinë në analizë. Rezultatet treguan se shoqëritë e mëdha kishin nivel më të ulët të menaxhimit të fitimeve.

Swastika, D. L. T. (2014) , vlerësuan efektin e madhësisë së shoqërisë të shprehur nga logaritmi natyror i aktiveve totale mbi menaxhimin e fitimeve, të shprehur nga rrjedhjet jonormale të llogaritura sipas modelit Jones (1991), në 51 shoqëri të listuara në bursën indoneziane, në industrinë ushqimore për vitin 2005. Në hipotezën

e testueshme shprehet lidhja negative midis madhësisë së shoqërisë dhe menaxhimit të fitimeve. Gjetjet treguan se madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm statistikor mbi menaxhimin e fitimeve në nivelin 95 % të besueshmërisë dhe kjo lidhje rezulton të jetë negative. Shoqëritë e mëdha kanë gjasa të shmangin menaxhimin e fitimeve.

### **2.4.3 Menaxhimi i fitimeve dhe sektori publik / privat**

Studime të tjera kanë ndërmarrë analiza duke iu referuar ndryshimeve të pronësisë së shoqërive në publike dhe private. P.sh : Saibal Ghosh, (2011) tregoi se ndryshimet në pronësi dhe në strukturën qeverisëse të shoqërive, janë faktorë që ndikojnë tek audituesit, dhe cilësia e reflektuar në punën e tyre. Autorë si Becker (1998) dhe Francis (1999) treguan se procesi i auditimit kufizoi praktikën e menaxhimit të fitimeve në institucionet publike, duke analizuar veçmas faktorët institucional, qeverisës, si dhe mënyrën e organizimit të shoqërive në sektorin publik dhe privat.

Beatty etj., (2002) u fokusua në studimin e saj në evidentimin e reduktimit /rritjes së vogël të fitimeve në sektorin bankar, publik dhe privat në Amerikë. Kampioni i marrë në studim përbëhej nga të dhëna vjetore të publikuara nga 707 banka publike dhe 1,160 banka private për periudhën kohore 1988-1998. Analizat empirike treguan se bankat publike raportonin më tepër nga sa parashikohej rritje të vogla të fitimit dhe më pak rënie të vogla. Ndërsa, bankat private raportonin më pak nga ç'parashikohej rënie të vogla të fitimeve. Për më tepër, gjetjet treguan se bankat publike raportuan statistikisht më pak rënie të fitimeve sesa bankat private. Gjithashtu, bankat publike rrisin fitimet duke rregulluar provigjonet e llogaritura për kreditë e këqija.

Heidi, Vander, Bauwhede, Marleen, Willekens (2003) në studimin e tyre, ndër të tjerash hetuan në lidhje me menaxhimin e fitimeve në sektorin publik e privat, parë në kontekstin belg, në një kampion prej 136 firmë - vit vrojtme, për periudhën kohore 1991-1997. Rrjedhjet jonormale u përdorën për të përfaqësuar menaxhimin e fitimeve. Gjetjet treguan se shoqëritë publike si dhe ato private angazhoheshin në praktikën e menaxhimit të fitimeve. Rritjet apo rëniet e fitimeve rezultonin të zbutura dhe për më tepër fitimet menaxhoheshin me qëllim realizimin e objektivave të vendosura paraprakisht.

Ball, R., dhe Shivakumar, L. (2005) studiuuan empirikisht fenomenin e menaxhimit të fitimeve në Angli duke krahasuar shoqëritë publike dhe private, dhe tregojnë se shoqëritë publike rezultojnë të kenë cilësi më të mirë të raportimit financiar.

Kempen (2010) hetoi mbi praktikën e menaxhimit të fitimeve në sektorin publik dhe privat në Holandë. Kampioni i vlefshëm në analizën empirike përbëhej nga 77 shoqëri publike dhe 315 shoqëri private, për periudhën kohore 2000-2009. Rezultatet treguan se të dy sektorët përfshihen ndjeshëm në praktikën e menaxhimit të fitimeve. Aplikimi i modelit Jones të Modifikuar (1995) për të identifikuar menaxhimin e fitimeve tregoi se shoqëritë publike menaxhonin më shumë fitimet sesa shoqëritë private.

Mard Y. & Vigneron (2014) hetuan mbi menaxhimin e fitimeve ndikuar nga ndryshimi në statusin publik/privat të shoqërive, në një kampion që përfshiu shoqëri të vogla dhe të mesme (NVM) në kontekstin francez. Kampioni përfshiu 925 vrojtme për periudhën 2002-2010. Nga krahasimi empirik i intensitetit të menaxhimit të fitimeve rezultoi se NVM-të private menaxhojnë më shpesh të ardhurat për të shmangur raportimin e humbjeve. Nga analiza e rrjedhjeve u tregua se shoqëritë publike dhe private përdorin praktikën fleksibël të kontabilitetit për të influencuar rezultatet, por duke u nisur nga motive të ndryshme. NVM-të publike menaxhojnë fitimet për të përmirësuar treguesit e performancës, ndërsa shoqëritë private menaxhojnë negativisht fitimet me qëllim reduktimin e tatimeve të pagueshme.

## **2.5 Menaxhimi i fitimeve dhe faktorë të tjerë të konsideruar në studime të ndryshme.**

Studiues të ndryshëm kanë evidentuar dallimet që mund të rezultojnë në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve kur krahasohen shoqëritë e financuara nga kapital vendas dhe shoqëritë e financuara nga Kapital i huaj. Grinblatt & Keloharju (2000), tregojnë se shoqëritë e huaja mund të performojnë më mirë për shkak të eksperiencës në fushën përkatëse. Nga ana tjetër Dvorak (2005), në një studim të ndërmarrë në tregun indonezian, sugjeron se performanca e investitorëve vendas është më e mirë për shkak të avantazhit që ata kanë në lidhje me informacionin që disponojnë për tregun vendas dhe specifikat e tij, akoma më tej Gilson dhe Milhaupt (2005) tregojnë se shoqëritë me kapital të huaj adoptojnë sisteme më efikente qeverisëse dhe

kontrolli. Ndërsa Guo, Zhang, dhe Zhou, (2012) investigojnë mbi ndikimin që kanë investitorët e huaj mbi aktivitetet e menaxhimit të fitimit në tregun japonez, në një kampion shoqërisht të listuara në Bursën e Tokios, në periudhë kohore 2004-2008. Gjetjet e tyre treguan se shoqëritë e financuara kryesisht me kapital të huaj përfshihen më pak në praktikatat e menaxhimit të fitimeve të matur nga rrjedhjet operative jonormale, shpenzimet jonormale, kostoja jonormale e produktit dhe kombinimi i faktorëve të mësipërm. Pronësia e huaj është konkluduar të jetë një faktor dhe mekanizëm shtrëngues në lidhje me aktivitetet e menaxhimit të fitimeve. Në rezultate të ngjashme ka konkluduar dhe Chung (2004), gjetjet e të cilit tregojnë se pronësia e huaj në tregun japonez është më efektive në lidhje me reduktimin e rrjedhjeve jonormale.

Bos, Pendleton dhe Toms (2011), ekzaminuan lidhjen midis përfshirjes së pronarëve në menaxhim dhe menaxhimit të fitimeve në një kampion shoqërisht të listuara në bursën angleze. Gjetjet treguan se drejtuesit ekzekutiv, njëkohësisht dhe pronarë kishin një impakt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. Gjithashtu Warfield, Wild (1995), dhe Velury, Jenkins (2006), kanë gjetur lidhje negative midis përfshirjes së pronarëve në menaxhim dhe rrjedhjeve jonormale në shoqëritë amerikane. Alves (2012), në një analizë empirike mbi 34 shoqërisht jo financiare në Portugali tregon se pronësia menaxheriale, dhe centralizimi i pronësisë në pak pronar, ndikon ndjeshëm duke kufizuar iniciativat e menaxhimit të fitimeve dhe duke përmirësuar kështu, cilësinë e raportimit financiar. Ndërsa, Rajgopal, Venkatachalam dhe Jiambalvo (1999) nuk kanë gjetur të këtë lidhje të rëndësishme midis këtyre variablave në shoqëritë amerikane. Lidhje pozitive kanë gjetur dhe Cohen, Dey dhe Lys (2008), ndërkohë që studime të tjera të ndërmarra në Europë e Kanada kanë sjellë rezultate mikse si p.sh., Gabrielsen, Gramlich dhe Plenborg (2002), Othman, Zeghal (2006) dhe Niu (2006).

Ardison, Martinez dhe Galdi (2012), studiuuan ndikimin që ka leva financiare mbi menaxhimin e fitimeve në një kampion që përfshin 21 industri të ndryshme të shtrirë në periudhën 1994-2010 në Brazil duke përdorur regresionin e shumëfishtë linear. Rezultatet e testimit treguan se nuk ka një lidhje të rëndësishme midis levës financiare dhe menaxhimit të fitimeve. Ndërsa Matinfard, Ojaghi, (2013) studiuuan lidhjen midis sjelljes oportuniste të menaxherëve që influenconte menaxhimin e

fitimeve dhe levës financiare, në një kampion shoqërisht të listuara në Bursën e Teheran, për periudhën kohore 2006-2011. Modeli Jones (1991) është përdorur për llogaritjet e rrjedhjeve jonormale, si tregues përfaqësues i menaxhimit të fitimeve. Rezultatet e përfuara nga analiza statistikore, demonstruan se ka një lidhje pozitive të rëndësishme statistikisht, midis levës financiare dhe menaxhimit të fitimeve. Shoqëritë me raport të borxhit më të lartë rezultuan të kishin rrjedhje jonormale më të larta. An, Li dhe Yu. (2013) në studimin e tyre parashtrijë hipotezën se shoqëritë me nivel të lartë të menaxhimit të fitimeve synojnë të kenë një nivel më të lartë të levës financiare. Kampioni i marrë në studim përbëhet 25798 vrojttime, të shoqërive në 37 vende, duke përfshirë një periudhë kohore prej dy dekadash. Studimi fokusohet mbi lidhjen e menaxhimit të fitimeve dhe levës financiare si dhe rolin e mjedisit institucional mbi këtë lidhje. Gjetjet treguan se shoqëritë të cilat kishin menaxhuar më shumë fitimin, rezultuan me levë financiare më të lartë gjithashtu, kjo lidhje pozitive u pa të ishte më pak e theksuar në vendet me mjedis të fortë institucional, ku investitori është më i mbrojtur dhe më konservator ndaj iniciativave të menaxhimit të fitimeve. Pjesërisht menaxhimi i fitimeve ndikohet nga mjedisi institucional, përmirësimi i të cilit çon në mbrojtje të investitorit dhe rritje të cilësisë dhe besueshmërisë së raportimit financiar.

Akoma më tej, Sabien (2013) studioi ndikimin e pronësisë menaxheriale, madhësisë së shoqërisë, levës financiare dhe ROE tek menaxhimi i fitimeve në kontekstin Indian. Kampioni përbëhej nga 51 shoqëri për periudhën 2001-2008. Gjetjet treguan se të gjithë variablat lidheshin negativisht me menaxhimin e fitimeve, por lidhja e tyre nuk ishte e rëndësishme statistikisht. Roychowdhury (2006) në studimin e tij tregon se shoqëritë mundohen të shmangin raportimin e humbjeve ose rënieve të fitimit duke ndërmarrë iniciativa reale të menaxhimit të fitimit.

## 2.6 Përmbledhje e literaturës së shqyrtuar

Në këtë kapitull së pari, u hetua literatura ekzistuese në lidhje me përkufizimet e menaxhimit të fitimeve si iniciativa të menaxherëve për të menaxhuar fitimet e raportuara. Pavarësisht përkufizimeve të ndryshme të autorëve të ndryshëm, ky punim do t'i përmbahet përkufizimit se, "menaxhimi i fitimeve ndodh kur menaxherët përdorin gjykimet e tyre gjatë raportimit financiar dhe strukturimit të transaksioneve me qëllim ndryshimin e rezultateve të raportuara, ose keqinformimin e disa palëve të interesuara në lidhje me treguesit e performancës së shoqërisë, apo ndikimin mbi rezultatet kontraktuale që varen nga shifrat e raportuara", sipas Healy dhe Whalen (1999).

Së dyti, u identifikuan motivet që nxisin menaxherët për tu përfshirë në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Më së shumti, literaturat identifikojnë motivet që lidhen me tregun e kapitalit, me marrëdhëniet kontraktuale, rregullatore, sistemin e tatim taksave etj.. Cilatdo qofshin motivet pse menaxherët përfshihen në iniciativat e menaxhimit të fitimit është e rëndësishme që ato të mos klasifikohen si jo etike apo të pa moralshme.

Së treti, studimet kanë pasur për qëllim të evidentojnë këtë fenomen pra të masin menaxhimin e fitimeve. Modele të ndryshme janë përdorur, si teknika indirekte matjeje e fenomenit pasi është e vështirë që të përcaktohet në mënyrë direkte sasiore. Të gjitha modelet e parashtruara synojnë të zbërthejnë rrjedhjet totale (të llogaritura sipas zërave të bilancit apo pasqyrës së rrjedhjes së parasë) në komponent të parashikueshëm dhe të paparashikueshëm (normal dhe jonormal) dhe pikërisht rrjedhjet jonormale janë përdorur si matës indirekt i menaxhimit të fitimeve. Në tabelën 2.2. është bërë një përmbledhje e disa punimeve të shqyrtuara dhe gjetjeve të tre. Vihet re se më së shumti autorët kanë përzgjedhur modelin Jones të Modifikuar (1995) për të përcaktuar rrjedhjet jonormale, duke supozuar se kjo teknikë është efiçente. Të supozosh se kjo teknikë është efiçente është një kufizim i këtyre studimeve, duke marrë në konsideratë faktin që ato janë kryer në ambiente të ndryshme për nga vendi (karakteristika të ndryshme social kulturore, ekonomike, politike, rregullatore etj), koha, sektorët etj.. Në analizën empirike që studion fenomenin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar konsiderohet vlerësimi

teknikave të ndryshme për të zgjedhur atë që realisht paraqitet statistikisht i vlefshëm për specifikat që mbart punimi.

Së katërti, studimet përcaktojnë variablat që ndikojnë duke favorizuar apo shtrënguar praktikat e menaxhimit të fitimeve. Dhe një nga variablat kryesorë i përmendur gjerësisht dhe i analizuar në shumë studime është cilësia e procesit të auditimit e cila është aftësia e audituesit për të gjetur (specializimi) dhe raportuar (pavarësia) gabime të mundshme gjatë procesit të hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare dhe informacionit financiar. Ashtu sikurse vërehet dhe në tabelën 2.2, rezultatet tregojnë për lidhje pozitive, negative apo neutrale të cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve. Në studime të ndryshme vihet re se ka argumente pro dhe kundër ndryshimeve në cilësinë e auditimit, duke iu referuar madhësisë së audituesit. Kështu nga njëra anë, shoqëritë e mëdha të auditimit (Big 4) synojnë të kenë një nivel uniform të cilësisë së auditimit në segmente të ndryshme të tregut, duke qenë shtrënguese në praktikat e tyre lidhur me menaxhimin e fitimeve. Nga ana tjetër mund të mendohet se shoqëritë Big4 mund të jenë “të buta” në praktikat e tyre, për faktin se rreziku i kontestimit të auditimit është i vogël, sidomos nga shoqëritë private të cilat mund zgjedhin auditues të tillë për të rritur prestigjin e vet. Autorë të ndryshëm kanë trajtuar lidhjen cilësi auditimi - menaxhim i fitimeve në shumë këndvështrime që janë të vlefshme për t’u analizuar edhe në kontekstin shqiptar.

Së pesti, një nga faktorët që shumë studime e kanë konsideruar të rëndësishëm është dhe ndikimi i madhësisë së shoqërisë mbi menaxhimin e fitimeve. Në tabelën 2.2 janë përmbledhur disa prej rezultateve të gjetura të cilat janë të ndryshme. Kështu, nga njëri këndvështrim është e qartë se së pari, raportet financiare të shoqërive të mëdha auditohen nga ekspertë kontabël të licencuar apo shoqëri të mëdha auditimi qëllimi i të cilave, ndër të tjera është të sigurojë cilësinë e pasqyrave financiare, duke bërë të mundur parandalimin e iniciativave të menaxherëve që mund të çojë në degradimin e informacionit dhe rezultatit financiar. Së dyti, shoqëritë e mëdha kanë një reputacion më të madh në treg, krahasuar me shoqëritë e vogla kështu, ato duhet të marrin në konsideratë kostot e humbjes së reputacionit, të cilat janë gjithashtu më të mëdha krahasuar me shoqëritë e vogla, një arsye kjo e fortë për mos u përfshirë në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Së treti, shoqëritë e mëdha shpesh instalojnë struktura të konsoliduara të funksionit të auditimit të brendshëm. Ato mund të kenë më pak gjasa

që menaxherët të përfshihen në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Pra, shoqëritë e mëdha mund të përfshihen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve megjithatë, dhe e kundërta mund të mendohet. Por, nga një këndvështrim i dytë vlen të përmendet se së pari, shoqëritë e mëdha mund të kenë lidhje të forta me audituesit (klientë me reputacion) dhe kjo e bën të lehtë negocimin midis tyre duke bërë që procesi i auditimit dhe raportet si output i këtij procesi të jenë me fleksibël. Së dyti, menaxherët pronarë mund të ushtrojnë autoritetin e tyre duke ndikuar mbi strukturat e auditimit të brendshëm, dhe strukturave të tjera të menaxhimit duke e realizuar lehtësisht menaxhimin e fitimeve në funksion të interesave të tyre. Së treti, shoqëritë e mëdha mund të menaxhojnë rezultatin në mënyrë që të risin mundësitë e financimit të jashtëm dhe të bëjnë më të lehtë procesin e kontraktimit me huadhënësit. Është e kuptueshme që huadhënësit janë më të sigurt që kontratat e borxhit do të përmbushen nëse një shoqëri raporton tregues të mirë të performancës. Madhësia e shoqërisë dhe ndikimi mbi menaxhimin e fitimeve parashtrohet në analizën empirike dhe në kontekstin shqiptar.

Së gjashti, përkatësia në sektorin publik e privat dhe ndryshimet bazuar në këtë faktor në lidhje me praktikatat e menaxhimit të fitimeve ka tërhequr vëmendjen e autorëve të ndryshëm. Midis sektorit publik dhe atij privat ekzistojnë ndryshime mjaft të rëndësishme. Kështu p.sh ato ndryshojnë për nga madhësia, ku shoqëritë publike kanë një numër të madh punonjësish, vlera të mëdha të aktiveve, kosto menaxhimi relativisht të mëdha etj. Gjithashtu, investitorët në shoqëritë private në krahasim me ato publike, për nga mënyra e organizimit të tyre mund të marrin rol aktiv në menaxhim duke pasur më shumë akses në informacionin që përftohet gjatë aktivitetit të shoqërisë kështu, asimetria e informacionit mund të jetë më e vogël dhe mundësia për të menaxhuar fitimet nga menaxherët është më e vogël. Pra mund të supozojmë që shoqëritë private përfshihen më pak në menaxhimin e fitimit për shkak se kanë një strukturë pronësie më të përqendruar, më tepër investitorë (në numër), që shpesh përfshihen në strukturat menaxheriale dhe për ata fitimi nuk përbën të vetmin tregues performance (Burgstahler etj. 2004). Për sa më sipër analiza empirike në kontekstin shqiptar evidenton ndryshimet që ekzistojnë në këta sektorë referuar menaxhimit të fitimeve.

Së shtati, në literaturën e shqyrtuar janë identifikuar dhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë mbi iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Të tillë janë mosha e shoqërisë që nga themelimi i aktivitetit të saj, përfshirja e drejtuesve në menaxhim, leva financiare, raporti i kthimit mbi aktivet ROA, financimi i aktivitetit me kapital të huaj, etj.. Këto dhe të tjera variabla janë konsideruar në analizën empirike që vijon në kapitujt pasardhës dhe që eksplorojnë dhe analizojnë ato në tregun shqiptar.

Për sa i përket kërkimeve në literaturë shqiptare në funksion të këtij studimi, vërehet se mungojnë studime të cilat trajtojnë empirikisht fenomenin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur gjetjet kryesore të autorëve të përmendur gjatë shqyrtimit të literaturës.

<b>Tabela 2.2. Përmbledhje e gjetjeve të disa punimeve gjatë shqyrtimit të literaturës</b>				
Burimi	Vendi ku është kryer studimi	Variabëli që përfaqëson përkatësisht: Cilësinë e auditimit- madhësinë e shoqërisë- përkatësinë në sektorin publik / privat (Variabla të pavarur)	Variabëli që përfaqëson menaxhimin e fitimeve (Variabël i varur)	Gjetjet Lidhja e variablat të varur me atë të pavarur
<b>I - Cilësia së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve</b>				
Becker (1998)	Kanada	Madhësia e audituesit (dikotomik)	Vlera absolute e RJN-Modeli Jones (1991)	Pozitive
Tendeloo dhe Vanstraelen (2005)	Belgjik, Finland, Francë, Hollandë, Spanjë dhe Angli	Madhësia e Audituesit (dikotomik)	Matës agregat i rrjedhjeve jonormale	Negative
Piot dhe Janin, Rémi, (2005),	Francë	Madhësia e Audituesit (dikotomik)	Vlera absolute e RJN-Modeli Jones (1991)	Neutrale
Ken, Kuen-Lin Jian (2005),	Tajvan	Madhësia e Audituesit (dikotomik)	RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Negative
Carcello , Hollingsworth , Klein dhe Neal (2006)	USA	Ekzistenca e ekspertizë kontabël	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Neutrale
Praëitt, Smith, dhe Wood,(2008)	Nuk është shprehur në punim	eksperiencia,certifikimi, trajnimet,koha që performojnë në auditimin financiar në përqindje me kohën totale, shuma e shpenzuar nga shoqëria për auditimin e brendshëm në raport me aktivet totale,	Vlera absolute e RJN- Modeli i matjes së performancës (Kothari, Leone dhe Wasley (2005)	Negative e moderuar
Gerayli,Yanesari, dhe Ma'atoofi (2011)",	Iran	Madhësia e audituesit, specializimi i audituesit, pavarësia e audituesit	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Negative
Douglas dhe Skinner (2012),	Japoni	Mundësia e ndryshimit të audituesit (dikotomik)	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Negative

Alves, (2013)	Portugali	Madhësia e audituesit, ekzistenca e komiteteve të auditimit (dikotomik)	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Pozitive
Yasar(2013)	Turqi	Madhësia e audituesit(dikotomik)	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Neutrale
<b>I I - madhësia e shoqërisë dhe menaxhimit të fitimeve</b>				
Burgstahler dhe Dichiv (1997)	USA	Ln e aktiveve totale	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Pozitiv
Kim, Liu Rhee (2003)		Variabël kategorik Shoqëri të mëdha, të mesme, të vogla	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Pozitiv
Ahmed, Al-khabash, Thuneibat, (2008)	Jordani	Ln e aktiveve totale	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Neutral
Naz,Bhatti, Ghafoor dheHusein (2011)	Pakistan	Ln e aktiveve totale	Vlera absolute e RJN-Modeli Jones (1991)	Neutral
Paiva dhe Lourenço (2013)	Francë	Variabël dikotomik Shoqëri të mëdha, të vogla	Kothary et al. (2005)	Negativ
Swastika, D. L. T. (2014)	Indonezi	Ln e aktiveve totale	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones (1991)	Negativ
<b>I I I - përkatësia e shoqërive në sektorit publik/privat dhe menaxhimit të fitimeve</b>				
Beatty et al. (2002)	Amerikë	Variabël dikotomik, Banka publike/banka private	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Publike >sesa private
Vander Bauhede, H.,&Willekens, M (2003)	Belgjik	Variabël dikotomik, publike/ private	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Neutral
Ball, R., dhe Shivakumar, L. (2005).	Angli	Variabël dikotomik, publike/ private		Private > sesa Publike
Kempen (2010)	Hollandë	Variabël dikotomik, publike/ private	Vlera absolute e RJN -Modeli Jones i modifikuar(1995)	Publike > sesa private
Mard, Y., & Vigneron	Francë	Variabël dikotomik, SME publike/ SME private	Rrjedhjet jonormale	Private > sesa Publike

Burimi: Përmbledhja e gjetjeve është realizuar nga autori gjatë shqyrtimit të literaturës së konsideruar në punim.

## KAPITULLI I TRETË

### ZHVILLIMI I HIPOTEZAVE DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Ky studim ka për qëllim të përftojë evidencë të menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar, si dhe të ekzaminojë empirikisht, lidhjen midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë, përkatësisë në sektorin publik e privat si dhe disa faktorëve të tjerë që kanë ndikim mbi të.

Në funksion të përmbushjes së qëllimit, studimi adreson pyetjet e mëposhtme kërkimore:

1. A përfshihen menaxherët në shoqëritë, që operojnë në tregun shqiptar në iniciativat e menaxhimit të fitimeve?
2. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë, ku në procesin e auditimit përfshihen auditues Big4 dhe në ato ku përfshihen auditues jo Big4, në kontekstin shqiptar?
3. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve kur krahasojmë shoqëritë e mëdha dhe të vogla në tregun shqiptar?
4. A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që i përkasin sektorit publik dhe atij privat në Shqipëri?
5. Cilët janë faktorët e tjerë që duhen konsideruar si indikatorë, për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe cili është ndikimi i tyre në kontekstin shqiptar?

#### 3.1 Sigurimi i të dhënave

Kampioni i marrë në studim përfshin të dhëna nga shoqëri publike me aktivitet fitimprurës dhe shoqëri private, të cilat në përmbushje të kriterëve kanë të audituara pasqyrat financiare. Ato janë siguruar për një periudhë kohore prej tre vitesh dhe më konkretisht për vitet 2010-2011-2012. Institucionet financiare (bankat, shoqëritë e sigurimit dhe të mikrokreditit) që operojnë në tregun shqiptar nuk janë përfshirë në studim. Kështu, popullsia e konsideruar përbëhet nga:

- shoqëri private me aktivitet ekonomik fitimprurës
- shoqëri publike me aktivitet ekonomik fitimprurës

- shoqëri publike apo private të cilat përmbushin kriteret e auditimit të pasqyrave financiare

Nuk janë të përfshirë në studim:

- në përputhje me kërkimet gjatë shqyrtimit të literaturës, bankat dhe shoqëritë e sigurimeve dhe të mikrokreditit përjashtohen nga kampioni, për shkak të karakteristikave të ndryshme që ka kjo industri,
- shoqëritë me më pak se tre vite aktivitet,
- shoqëritë që nuk përmbushin kriteret e auditimit të pasqyrave financiare.

Të dhënat janë grumbulluar kryesisht nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit dhe më pak nga kontakte të drejtpërdrejta me përfaqësues të shoqërive të ndryshme. Të dhënat janë të tipit mikroekonomik dhe për çdo shoqëri janë kërkuar dhe siguruar pasqyrat financiare dhe raportet e ekspertëve kontabël, për tre vitet e konsideruara në studim. Në të dhënat e grumbulluara sipas këtyre kriterëve janë realizuar 258 firmë - vit vrojtme që i përkasin 86 shoqërive të ndryshme private dhe publike, në dymbëdhjetë industri të ndryshme të koduara në përputhje me Klasifikimin e Përgjithshëm Industrial European të Aktiviteteve Ekonomike (NACE. Rev.1.1) i pranuar dhe nga autoritetet Shqiptare.

### **3.2 Menaxhimi i të dhënave**

Analiza empirike është një proces që fillon me mbledhjen e të dhënave pra së pari, me përcaktimin e një kamioni të vlefshme për studim. Numri minimal i vrojtmeve i nevojshëm për t'u konsideruar në këtë studim është llogaritur sipas formulës së propozuar nga Tabachnick dhe Fidell (2007). Kjo formulë merr në konsideratë numrin e variablave të pavarur për llogaritjen e madhësisë së kampionit të vlefshëm për studim<sup>3</sup>. Të dhënat janë grumbulluar në periudhën prill 2013 – dhjetor 2013, ku për secilën shoqëri janë kërkuar: 1) Pasqyrat financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasqyra e flukseve të parasë, pasqyra e amortizimit të aktiveve

---

<sup>3</sup>  $N \geq 50 + 8m$ , ku N është numri minimal i firm-vit vrojtmeve në kampion dhe m = numri i variablave të pavarur (Tabachnick & Fidell, 2007), fq. 123.

afatgjata materiale) dhe 2) Raporti i Ekspertit Kontabël të Autorizuar, për vitet 2010-2011-2012.

Menaxhimi i të dhënave është realizuar në dy faza. Faza e parë konsiston në pastrimin dhe hedhjen e të dhënave në programin SPSS 21 dhe faza e dytë, në analizimin e të dhënave. Gjatë grumbullimit të të dhënave u vu re se për disa shoqëri mund të mungonin “Pasqyra e flukseve të parasë”, “Raporti i ekspertit kontabël të autorizuar” apo disponoheshin pasqyra të ndërtuara me të dhëna jo të plota. Për disa prej variablave të konsideruar në analizë është dashur të sigurohet informacion nga kontakte të drejtpërdrejta, telefon apo email, me përfaqësues të shoqërive të ndryshme, apo dhe eksplorimi i faqeve zyrtare të shoqërive në internet. Në disa raste ka qenë i pamundur sigurimi i gjithë informacionit të nevojshëm. Pasqyrat e shoqërive në të cilat të dhënat ishin të pamjaftueshme, apo të papërshtatshme për të llogaritur dhe identifikuar variablat, apo shoqëritë për të cilat nuk është siguruar informacioni i plotë në lidhje me të gjithë variablat e konsideruar në punim, janë përjashtuar nga kampioni.

Hedhja e të dhënave në program është kryer në bazë të kodimit të të dhënave, sipas variablave përkatës.

### **3.3 Zhvillimi i hipotezave dhe teknikat e përzgjedhura në funksion të vërtetimit të tyre**

Duke përqasur çështjet e trajtuara në studimet e shqyrtuara në kapitullin e dytë të këtij punimi, mendoj se do te ishte me vlerë një studim i mirëfilltë që analizon lidhjen midis menaxhimit të fitimeve, cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë, përkatësisë në sektorin publik apo privat, si dhe disa faktorëve të tjerë të vlefshëm për tu trajtuar në kontekstin shqiptar.

#### **3.3.1 Evidentimi e fenomenit “menaxhim i fitimeve”**

Referuar literaturës së shqyrtuar, studime të ndryshme kanë sjellë evidenca të ndryshme në lidhje me fenomenin e “menaxhimit të fitimeve”. Motivuar nga ky fakt, si dhe nga fenomene të dukshme, të ngjashme me menaxhimin e fitimeve në tregun shqiptar është e rëndësishme që ky fenomen të studiohet dhe të mundësohet evidencë e vlefshme në kontekstin shqiptar. Kështu natyrshëm lind pyetja : “A përfshihen

menaxherët në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar në iniciativat e menaxhimit të fitimeve?

Në përgjigje të pyetjes së mësipërme analizohet një kampion i vlefshëm për studim, i përbërë nga shoqëri publike dhe private, me aktivitete fitimprurës, që i përkasin industrive të ndryshme, madhësive të ndryshme (për nga aktiviteti që ushtrojnë), formave të ndryshme të pronësisë dhe organizimit, me qëllim që të arrihet në një konkluzion gjithëpërfshirës dhe përgjithësues.

Fillimisht e nevojshme të identifikohet dhe më pas matet menaxhimi i fitimit. Në fakt është e pranueshme të themi se menaxhimi i fitimeve ekziston dhe është një iniciativë që ndërmerret jo rrallë nga menaxherët e njësive ekonomike, përderisa rregullat në kontabilitet e lejojnë këtë veprim. Është më se e qartë se kontabiliteti mbi baza rrjedhëse dhe kontabiliteti mbi baza monetare ndryshojnë për nga mënyra e vlerësimit të rrjedhjeve dhe llogaritjes së rezultateve dhe veprimet që nuk shoqërohen me rrjedhje monetare mund të përbëjnë elementë mbi të cilët menaxherët mund të ndërhyjnë për ti ndryshuar, për motive të ndryshme të përmendura kapitullin e dytë në këtë studim. Studimet kanë përdorur teknika të ndryshme indirekte të vlerësimit dhe matjes së menaxhimit të fitimit dhe rrjedhjet jonormale janë përdorur kryesisht për të përfaqësuar këtë fenomen. Duke marrë shkas nga sa më sipër, vlerësoj me vend testimin statistikor të disa modeleve që janë përdorur gjerësisht në literaturat mbi menaxhimin e fitimeve dhe që bëjnë të mundur zbërthimin e rrjedhjeve totale në elementë normal dhe jonormale. Gjatë testimit vlerësohet modeli më eficient me qëllim aplikimin e tij në analizat në vazhdim të këtij punimi. Më konkretisht në kampionin e vlefshëm për studim do të vlerësohen: 1) *Modeli Jones* (Jones 1991), 2) *Modeli Jones i Modifikuar* (Dechow, Sloan dhe Sweeney 1995), 3) *Modeli i Zgjeruar Jones – Cash Flow* (Kasznik 1999) dhe 4) *Modeli i Matjes së Performancës* (Kothari, Leone dhe Wasley 2005).

Prej analizës përzgjidhet modeli me parametrat më të mirë statistikor për të zbërthyer rrjedhjet totale në normale dhe jonormale, për t'u përdorur më tej në analizën empirike. Rrjedhjet jonormale llogariten sipas hapave të mëposhtëm:

➤ **Hapi 1 – Llogaritja e rrjedhjeve totale**

Rrjedhjet përfshijnë të gjitha rregullimet që menaxhimit i lejojnë të kryejnë për të vlerësuar rezultatet duke i kthyer ato nga baza monetare në baza rrjedhëse. Ndryshimet në kapitalin punues janë pjesë e rrjedhjeve totale. Në shumë studime janë pikërisht ndryshimet në zërat e kapitalit punues, ato që përgjithësisht përdoren në llogaritjen e rrjedhjeve. Duke qenë se janë elementë afatshkurtër dhe probabiliteti i ndërhyrjes për ti ndryshuar (menaxhuar) është dhe më i madh.

Rrjedhjet totale mund të llogariten në dy mënyra:

1. Duke konsideruar zërat e bilancit
2. Duke konsideruar pasqyrën e flukseve të parasë

Të dyja mënyrat konvergjojnë në të njëjtat rezultate përderisa pasqyra e flukseve të parasë derivon nga bilanci kontabël. Kështu, rrjedhjet sipas zërave të bilancit llogariten si:

$RT = \text{Ndryshimi në Aktive Afatshkurtra} - \text{Ndryshimin në Detyrime Afatshkurtra} - \text{Ndryshim në Aktive Monetare} + \text{Ndryshimi në Huamarrjet Afatshkurtra ose Afatgjata, por që maturohet në vitin përkatës - Amortizimin e periudhës}$

Shumë studime kanë përdorur këtë mënyrë për të vlerësuar rrjedhjet totale. Por, duke qenë se pasqyra e flukseve të parasë e bën edhe më të thjeshtë këtë vlerësim, në këtë studim është konsideruar llogaritja e rrjedhjeve totale sipas kësaj pasqyre ku:

$RT = \text{Fitimi neto i vitit ushtrimor (FN)}^4 - \text{Fluksi i parave nga aktiviteti i shfrytëzimit (CFO)}^5$

$$RT = FN - CFO$$

Sipas Dechow (2006), fluksi i rrjedhjeve të parasë përcaktohet si shumë e fluksit të parave nga aktiviteti i shfrytëzimit (CFO) + fluksi i parave nga aktivitetet e investimit (CFI)<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Fitimi neto i vitit financiar, raportuar sipas pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

<sup>5</sup> Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit i raportuar sipas pasqyrës së flukseve të parasë me metodën indirekte.

Pra rrjedhjet totale llogariten si:

$$RT = FN - (CFO + CFI) \quad (1)$$

Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaria investuese përdoret në këtë formulë me qëllim që të reflektojë ndikimin e parave të shpenzuara në krijimin e aktiveve afatgjata materiale, apo investime të tjera të kapitalizuara dhe të mara si aktive afatgjata në bilancin kontabël të periudhës. Në këtë mënyrë do të matet më mirë efekti i flukseve të mjeteve monetare mbi rezultatin. Kjo formë përcaktimi dhe llogaritjeje e rrjedhjeve totale është e ngjashme me punimet e autorëve Richardson (2005) dhe Fairfield, Whisenant, Yohn (2003a) cituar dhe nga Patricia M. Dechow, z weili Ge, (2006). Përcaktimi i më sipërm do të përdoret dhe në këtë punim gjatë analizave të mëtejshme.

#### ➤ Hapi 2- Llogaritja e rrjedhjeve normale

Flukset e konsideruar jo normale janë ato, që tregojnë për situata ku menaxhimi i fitimeve mund të ketë ndodhur. Problemi qëndron në shpërbërjen e rrjedhjeve totale në elementë të parashikueshëm (rrjedhje normale) dhe të paparashikueshëm ( rrjedhje jo-normale).

$$\text{Rrjedhjet totale (RT)} = \text{Rrjedhje normale (RN)} + \text{Rrjedhje jo normale (RJN)} \quad (2)$$

Studiues të ndryshëm përdorin instrumente apo modele për të vlerësuar rrjedhjet totale të cilët synojnë të ndajnë ato në komponentë normal dhe jo normal.

Vihet re se modelet aplikojnë të dhëna në formën e serive kohore si dhe të dhëna të kryqëzuara. Parametrat e modeleve të serive kohore vlerësohen për çdo shoqëri në një vit të veçantë, të konsideruar në studim, ndërsa parametrat në modelet me të dhëna të kryqëzuara vlerësohen duke marrë në konsideratë një periudhë kohore prej disa vitesh për të njëjtën shoqëri që i përket të njëjtës industrie. Në këtë studim të dhënat organizohen në formë të kryqëzuar, ku për çdo shoqëri të konsideruar do të realizohen tre firmë - vit vrojtime.

---

<sup>6</sup> Paraja neto e përdorur nga aktivitetet investuese sipas pasqyrës së flukseve të parasë me metodën indirekte

Për sa i përket përzgjedhjes së modeleve, do të konsiderohen në analizë katër modele të cilat të detajuar janë paraqitur në kapitullin e shqyrtimit të literaturës. Më konkretisht këto modele janë:

1. *Modeli Jones (1991)*

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \epsilon_{it}$$

2. *Modeli Jones i Modifikuar (Dechow, Sloan dhe Sweeney 1995),*

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it} - \Delta LOG ARK_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \epsilon_{it}$$

3. *Modeli i Zgjeruar Jones – Cash Flow (Kaszniak 1999)*

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_1 \frac{\Delta SHITJE_{it} - \Delta LOG ARK_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_3 \frac{\Delta CFO_{it}}{A_{i,t-1}} + \epsilon_{it}$$

4. *Modeli i matjes së performancës (Kothari, Leone dhe Wasley (2005)*

$$\frac{RN_{it}}{A_{i,t-1}} = \beta_0 + \beta_1 \frac{1}{A_{i,t-1}} + \beta_2 \frac{\Delta SHITJE_{it} - \Delta LOG ARK_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_3 \frac{AAGJB_{it}}{A_{i,t-1}} + \beta_4 ROA_{t-1} + \epsilon_{it}$$

Autorë të ndryshëm kanë vërtetuar efikasitetin e modeleve të sipërpërmendura. Gjetjet e tyre tregojnë se Modeli Jones i Modifikuar, është instrument cilësor për zbulimin e rrjedhjeve totale në normale dhe jonormale, dhe ky model ka gjetur gjerësisht përdorim në punimet që trajtojnë fenomenin e menaxhimit të fitimeve ( në shumë raste është marrë e mirëqenë efikasiteti i tij). Megjithatë në kontekstin shqiptar ky rezultat ngelet për t'u verifikuar , duke marrë në konsideratë faktin që studimet e autorëve të ndryshëm janë kryer në ambiente të ndryshme për nga vendi (karakteristika të ndryshme social kulturore, ekonomike, politike, rregullatore etj),

koha, sektorët etj.. Modelet e mësipërme, në këtë këndvështrim duhet të testohen statistikisht dhe në kontekstin shqiptar duke u bërë kështu pjesë e analizës së mëtejshme në këtë studim.

Përzgjedhja e modelit më të mirë për të zbërthyer rrjedhjet totale në normale dhe jonormale bëhet pasi vlerësohet rëndësia statistikore e secilit prej tyre, aplikuar në kampionin e vlefshëm në studim. Modelet janë të trajtës regresion i shumëfishtë linear, Metoda e Katrorëve më të Vegjël. Fillimisht është e rëndësishme të testohen supozimet bazë mbi të cilat mbështetet regresioni i shumëfishtë linear.

- Supozimi se mbetjet kanë mesatare të barabartë me zero
- Supozimi mbi **homoskedasticitetin**, i cili përcakton se varianca e mbetjeve është e njëjtë në çdo vrojtim. Mosplotësimi i këtij kushti apo heteroskedasticiteti testohet nëpërmjet testit White.
- Supozimi se midis mbetjeve të modelit nuk ka korelacion apo kovarianca midis termave të mbetjeve të çdo dy vrojtimeve është zero. Shkelja e këtij supozimi çon në prezencën e **autokorelacionit**, i cili testohet për çdo model nëpërmjet testit Durbin Watson.
- Supozimi se mbetjet kanë **shpërndarje normale**. Nëse mbetjet nuk kanë shpërndarje normale, atëherë mundet që rezultatet të mos jenë të besueshme dhe të vlefshme (Tabachinal dhe Fidel 2007). Për t'u siguruar në lidhje me normalitetin identifikohen vlerat ekstreme të firmë - vit vrojtimeve. Sipas Tabachinal dhe Fidel (2007), fq.128 vlera ekstreme identifikohen ato për të cilat Z statistikore (standardised residuals values) janë  $>3.3$  ose  $<-3.3$ . Shkalla me të cilën vlerat ekstreme (outliers) ndikojnë në regresion varet nga mënyra se si ato shpërndahen krahasimisht me rastet e tjera në analizë. Rastet e veçanta që kanë efekt të madh në regresion quhen raste influencuese dhe një nga teknikat e matjes së tyre është llogaritja e distancës Cook (Cook 1979), vlera kritike e së cilës përdoret për pastrimin e kampionit nga këto raste me qëllim sigurimin e shpërndarjes normale. Vlera kritike  $cook.s = 4/(n-k-1)$ , ku  $n$ = numri i firmë - vit vrojtimeve dhe  $k$ = numri i variablave të pavarur. Sipas Tabachinal dhe Fidel (2007), fq.75 vlera maksimale e distancës Cook të pranueshme është 0.094.

- Supozimi se variablat e pavarur nuk kanë lidhje të fortë midis tyre. Mosplotësimi i këtij kushti çon në **multikolinearitet** ( $r > 0.9$ ), i cili do të testohet nëpërmjet statistika VIF dhe tolerancës ( $r > 0.9$ ). Toleranca  $< 0.1$  ose VIF  $> 10$  tregon për probleme të multikolinearitetit.

Pas kontrollit në lidhje me supozimet e mësipërme do të vlerësohet dhe rëndësia e koeficientëve të pjesshëm të regresionit si dhe konkludohet mbi rëndësinë statistikore të modeleve nëpërmjet analizës së variancës dhe kriterit Fisher. Në këtë mënyrë përzgjidhet modeli që parashikon më mirë rrjedhjet totale dhe konsiderohet më i përshtatshëm në analizat e mëtejshme gjatë llogaritjes së rrjedhjeve jonormale.

### ➤ Hapi 3 – llogaritja e rrjedhjeve jonormale

Rrjedhjet jonormale ose jo të pritshme llogariten si diferencë midis rrjedhjeve totale të llogaritura sipas pasqyrës së flukseve të parasë  $RT = FN - (CFO + CFI)$  të konsideruar në hapin e parë dhe rrjedhjeve normale të regresuara sipas modelit I, II, III ose IV të konsideruar në hapin e dytë.

$$RJN_{it} = RT_{it} - RN_{it} \text{ (të llogaritura sipas modelit të përzgjedhur)}$$

Pra, termi i gabimit përcakton pikërisht rrjedhjet jo normale, vlera absolute e të cilave është përdorur si tregues i “menaxhimit të fitimeve”. Sa më e madhe të jetë kjo vlerë, aq më e dobët është cilësia e fitimeve të raportuara. Është e kuptueshme që vlerat pozitive të RJN-së tregojnë për menaxhim në rritje të fitimit dhe vlerat negative tregojnë për menaxhim në zvogëlim të fitimit. Në vijim përcaktohen rrjedhjet jonormale (RJN) për secilin rast në kampionin e vlefshëm në studim, të përbërë nga shoqëri publike dhe private, me aktivitete fitim prurës, që i përkasin industrive të ndryshme, madhësive të ndryshme (për nga aktiviteti që ushtrojnë), formave të ndryshme të pronësisë dhe organizimit. Kështu, rrjedhjet jonormale do të jenë tregues i matshëm dhe do të përdoren në analizë në funksion të identifikimit dhe sigurimit të evidencës në lidhje me menaxhimin e fitimeve në kontekstin shqiptar.

### 3.3.2 Madhësia e shoqërisë audituese

Në Shqipëri tregu i auditimit shfaqet i konsoliduar dhe gjithashtu katër shoqëri të mëdha ndërkombëtare operojnë duke ndarë pjesën e tregut me të gjithë operatorët e

tjerë të auditimit. Këto shoqëri janë konsideruar Big4 dhe do të jenë pjesë e analizës për kontrollin e menaxhimit të fitimeve krahasuar me shoqëritë e tjera dhe personat fizik që operojnë në tregun shqiptar si Ekspertë Kontabël të Autorizuar. Duke konsideruar studimet gjatë hulumtimit të literaturës vërehet se gjetjet janë të ndryshme. Disa studime faktojnë se shoqëritë Big N manifestojnë cilësi më të dobët auditimi (Becker 1998, Alves 2013) duke rezultuar në vlera më të larta të rrjedhjeve jonormale. Disa të tjera tregojnë se shoqëritë BigN kanë efekt negativ mbi menaxhimin e fitimeve, duke qenë më konservatorë në praktikën që lidhen me të (Tendeloo dhe Vanstraelen 2005, Ken, Kuen-Lin Jian 2005, Prawitt, Smith, dhe Wood 2008, Gerayli, Yanesari, dhe Ma'atoofi 2011", Douglas dhe Skinner 2012). Ndërkohë që studime të tjera tregojnë se si audituesit e vegjël, ashtu dhe shoqëri të mëdha auditimi sillen njësoj në lidhje me menaxhimin e fitimeve (Piot dhe Janin, Rémi, (2005) Yasar(2013). Për sa më sipër gjej me vend analizimin e këtij fenomeni në kontekstin shqiptar duke parashtruar hipotezën e më poshtme:

- *H1- Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar.*

Në përfaqje më studime të tjera që ekzaminon lidhjen e menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit (shih tabelën nr 2.2, në lidhje me variablat që shprehin cilësinë e auditimit), **madhësia e audituesit** përfaqëson cilësinë e auditimit dhe do të shprehet me variabël dikotomik (**AUD**), që merr vlerë 1 nëse audituesi i aktivitetit ekonomik të shoqërive që përbëjnë kampionin është një shoqëri Big4 dhe 0 nëse jo. Duke supozuar që audituesit e mëdhenj janë më të aftë për të vërejtur parregullsitë (të specializuar) dhe për t'i raportuar ato (të pavarur), si dhe janë më shtrëngues në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve, rrjedhimisht janë më cilësor, pritet të evidentohet një lidhje negative midis madhësisë së audituesit dhe menaxhimit të fitimeve.

Për të hetuar nëse ekzistojnë ndryshime në lidhje me menaxhimin e fitimeve, përfaqësuar nga rrjedhjet jonormale sipas modelit të përzgjedhur (I, II, III apo IV), ndërmjet shoqërive të audituara, përkatësisht nga Big4 dhe jo Big4 do të përdoret analiza e variancës (One Way Welch ANOVA). Kjo teknikë është e përshtatshme në rastin kur variabël i varur është i vazhduar dhe variabël i pavarur është nominal apo kategorik, gjë që bën të mundur krahasimin e vlerave mesatare të variabël të varur ndërmjet dy ose më shumë grupeve. Kriteri i vendimmarrjes është rëndësia e testit

Fisher, me nivel besueshmërie 95%. Vlerat, statistikisht të rëndësishme të testit F (për  $p < 0.05$ ), tregojnë për ndryshime të rëndësishme midis grupeve në lidhje me menaxhimin e fitimeve përfaqësuar nga rrjedhjet jonormale. Ndërkohë, në përdorimin e kësaj teknike është e rëndësishme të ekzaminohet normaliteti i shpërndarjes dhe homogjeniteti i variancave. Për të identifikuar nëse shpërndarja e vlerave të menaxhimit të fitimit është normale verifikojmë fillimisht vlerat e asimetrisë në shpërndarje dhe vlerat e koeficientit Kurtosis. Testi Leven's përdoret për të konfirmuar homogjenitetin e variancave, i cili teston nëse variancat e rezultateve janë të njëjta për secilin nga të dy grupet. Nëse vlerat e testit Leven's janë më të mëdha se 0.05 atëherë nuk çenohet supozimi i homogjenitetit të variancave.

Rezultati konfirmohet dhe nëpërmjet llogaritjes së testit Eta Squared, si një nga testet më të zakonshëm statistikore që tregon mbi madhësinë e efektit, në këtë rast të përkatësisë Big4 dhe joBig4 (në procesin e auditimit të shoqërive) mbi menaxhimin e fitimeve. SPSS 21 i cili është programi i përdorur për procedimin dhe nxjerrjen e rezultateve nuk e jep mundësinë e llogaritjes së kësaj statistike, prandaj ajo do të llogaritet veçmas si :

$$\text{Eta Squared} = \frac{\text{Sum of squares betuen groups}}{\text{Total sum of squared}}$$

Cohen's (1988.fq.284-7), klasifikon vlerat e raportit Eta Squared për të matur madhësinë e efektit mbi variabëlin e varur, ku vlerat deri në 0.01 tregojnë për efekt të vogël, deri në 0.06 efekt mesatar dhe mbi 0.14 efekt të madh të madhësisë së audituesit mbi fenomenin e menaxhimit të fitimeve.

### 3.3.3 Efekti i përmasave të shoqërisë në praktikat e menaxhimit të fitimeve

Duke konsideruar literaturën e hulumtuar në kapitullin e dytë të këtij punimi vihet re se autorë të ndryshëm sjellin argumente të ndryshme në lidhje me menaxhimin e fitimeve, ndikuar nga madhësia e aktivitetit të shoqërisë. Kështu, nga njëra anë mund të mendohet se shoqëritë e mëdha mund të jenë konservatore në lidhje me iniciativat e menaxhimit të fitimit (Paiva dhe Lourenço 2013), por nga ana tjetër mund të mendohet edhe e kundërta (Burgstahler dhe Dichiv 1997, Kim Liu Rhee 2003). Nuk kanë munguar dhe rastet me rezultate neutrale, kur madhësia e shoqërisë nuk ndikon

mbi menaxhimin e fitimeve. (Ahmed, Al-Khabash dhe Thuneibat (2008), Naz, Bhatti, Ghafoor dhe Husein ,(2011))

Duke përmbledhur konsideratat gjatë shqyrtimit të literaturës, hipotezat e testueshme që parashtrihen janë:

➤ H2 – *Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve*

➤ H3 – *Ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve*

Variabëli i varur është menaxhimi i fitimeve i shprehur nga vlera absolute e rrjedhjeve jonormale. Ndërsa për të identifikuar ndryshimet në përmasat e aktivitetit dhe për të klasifikuar shoqëritë në të mëdha dhe të vogla konsiderojmë treguesit e mëposhtëm të cilët janë variablat e pavarur në analizë:

a) Variabëli që do të përdoret si tregues i madhësisë së shoqërisë është LN AKTIVE- logaritmi natyror i aktiveve totale i vlerësuar sipas bilancit kontabël të shoqërive që përbëjnë kampionin e vlefshëm për studim në çdo vit përkatës. Më pas për të bërë ndarjen e kampionit në dy kategori, përkatësisht shoqëri të mëdha dhe të vogla, llogaritet vlera mesatare për kampionin e logaritmit natyror të aktiveve totale (LN AKTIVE). Shoqëritë me LN AKTIVE më të mëdha se mesatarja konsiderohen të mëdha dhe shoqëritë me LN AKTIVE më të vogël ose të barabartë me mesataren e kampionit konsiderohen të vogla duke marrë përkatësisht vlerat 1 dhe 0.

b) Për të identifikuar rastet e rritjeve ekstreme në shoqëri të ndryshme, një tjetër tregues përfshihet në analizë. Variabëli SHITJE i shprehur si ndryshimi në përqindje i të ardhurave nga shitja nga viti në vit në funksion të identifikimit të rasteve kur shoqëritë me rritje të madhe mund të rezultojnë në asimetri informacioni, shkak ky që mund të çojë në përfshirje të menaxherëve në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Për këtë variabël të dhënat e kampionit renditen sipas industrive, në mënyrë që ato të jenë të grupuara sipas karakteristikave homogjene të industrisë të cilës i përkasin. Për çdo industri llogaritet mesatarja e rritjes në përqindje të shitjeve. Shoqëria konsiderohet me rritje të madhe të shitjeve nëse treguesi individual i ndryshimit në përqindje të shitjeve është më i madh se mesatarja e industrisë, duke marrë vlerën 1 dhe me rritje të vogël të shitjeve nëse ky tregues është më i vogël ose i barabartë me mesataren e industrisë, duke marrë vlerën 0.

Për të parë nëse ekzistojnë ndryshime në lidhje me menaxhimin e fitimeve të shprehur nga rrjedhjet jonormale, të derivuara nga modeli i përzgjedhur (hapi 3) dhe madhësisë së shoqërisë, të shprehur nga logaritmi natyror i aktiveve totale dhe ndryshimi në përqindje i shitjeve konsiderohet analiza Two-Way ANOVA. Kjo teknikë është e përshtatshme në rastin kur variabëli i varur merr vlera numerike të vazhduara dhe dy variablat e pavarur janë fiks ose kategorik me dy ose më shumë grupime. Gjithashtu, kjo teknikë bën të mundur evidentimin e efektit që kanë variablat e pavarur (secili më vete) si dhe efektin e kombinimit të tyre mbi variabëlin e varur.

Dhe në këtë rast ka vend konfirmimi i normalitetit të shpërndarjes (asimetria dhe koeficienti Kurtosis), homogjenitetit të variancave (konsiderimi i testit Leven's) si dhe madhësisë së efektit që kanë grupimet mbi variabëlin e varur që përfaqëson menaxhimin e fitimeve (partial eta squared)

Kriteri i vendimmarrjes në këtë rast është rëndësia e testit Fisher, bazuar në gabimin e llojit të parë  $\alpha = 0.05$ . Sipas kësaj teknike do të përcaktohet nëse ka ndryshime statistikisht të rëndësishme në vlerat mesatare të variablave të varur përkatësisht për secilin grup, shoqëri e vogël - shoqëri e madhe dhe shoqëri me rritje të vogël të shitjeve - shoqëri me rritje të madhe të shitjeve, si dhe do të vërehet nëse ka bashkëveprim midis variablave të pavarur dhe nëse ky bashkëveprim është statistikisht i rëndësishëm mbi ndryshimet në mesataren e variablit të varur.

### **3.3.4 Menaxhimi i fitimeve – sektori publik kundrejt atij privat**

Përkatësia në sektorin publik apo privat i shoqërive konsiderohet në analizën në vijim. Është e qartë se ka ndryshime të rëndësishme që lidhjen me pronësinë, mënyrën e financimit të aktivitetit, organizimi dhe format e qeverisjes etj., dhe që të dy sektorët përfshihen në procesin e auditimit të aktivitetit të tyre. Beatty etj. (2002, Kempen (2010) dhe Mard Y, dhe Vigner në studimet e tyre tregojnë se në shoqëritë publike ndërmarrin më shpesh iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Ndërsa Heidi Vander Bauwhede, Marleen Willekens (2003) nuk gjen ndryshime të rëndësishme ndërmjet dy sektorëve për sa i përket këtij fenomeni. Në përjasje të konsideratave të mësipërme në realitetin shqiptar parashtrohet hipoteza e më poshtme.

- *H4- Përkatësia e në sektorin publik/privat të shoqërive më tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.*

Menaxhimi i fitimeve konsiderohet rishtas në këtë analizë si variabël i varur, i shprehur nëpërmjet rrjedhjeve jonormale të vlerësuara sipas modelit të përzgjedhur në hapin 3, për të investiguar mbi cilësinë e raportimit financiar në sektorin publik dhe privat, natyrisht duke i mëshuar rishtazi faktit se raportimi financiar është më cilësor nëse menaxhimi i fitimit reduktohet.

Variabëli i pavarur që përcakton nëse shoqëria i përket sektorit publik apo privat identifikohet nga variabëli dikotomik (GOV), i cili merr vlerën GOV=1, nëse shoqëria e ushtron aktivitetin në sektorin publik dhe GOV=0, nëse shoqëria i përket sektorit privat të prodhimit të të mirave apo shërbimeve. Sikurse vihet re, në analizë përfshihen një variabël i varur që merr vlera numerike të vazhduara dhe një variabël i pavarur dikotomik. Edhe në këtë rast sikurse është trajtuar e detajuar më sipër në këtë kapitull, (për vërtetimin e hipotezës H1) metoda e përzgjedhur për të testuar hipotezën H5 është analiza një-variabëlshe Welch ANOVA. Kriteri i vendimmarrjes edhe në këtë rast është rëndësia e testit Fisher, bazuar në gabimin e llojit të parë  $\alpha = 0.05$ . Ndërkohë, për të identifikuar nëse shpërndarja e vlerave të menaxhimit të fitimeve është normale, verifikojmë vlerat e asimetrisë në shpërndarje dhe vlerat e koeficientit Kurtosis. Gjithashtu, testi Leven's do të përdoret për të konfirmuar homogjenitetin e variancave, si dhe testit Eta Squared, për të konfirmuar madhësinë e efektit që ka përkatësia e aktiviteteve të shoqërive në sektorin publik apo privat mbi menaxhimin e fitimeve të identifikuar nga vlera absolute e rrjedhjeve jonormale.

### 3.3.5 Analiza shumëvariabëlshe

Hipotezat e ngritura mbi lidhjet midis menaxhimit të fitimeve dhe cilësisë së auditimit, madhësisë së shoqërisë, dhe përkatësisë në sektorin publik apo privat, konsiderojnë faktorë specifikë të cilët në realitet nuk mund të veprojnë në izolim. Për këtë arsye do të ishte e dobishme të konsiderohet një analizë shumëvariabëlshe që përfshin disa faktorë, për të identifikuar rëndësinë e tyre dhe ndikimin sasior që kanë këta variabla (gjithëseciliprej tyre dhe të gjithë të marrë sëbashku), mbi iniciativat e ndërmarra nga menaxherët për të ndërhyrë mbi shifrat kontabël të raportuara. Në këtë mënyrë do të përcaktohen ata faktorë që duhen konsideruar si indikatorë, për të

kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe gjithashtu ndikimi sasior i tyre mbi këtë fenomen.

Kështu, për të plotësuar analizën hetohen faktorët e tjerë që parashikojnë menaxhimin e fitimeve, nëpërmjet analizës shumëvariabëlshe dhe identifikohet nëse ka ndonjë divergjencë me rezultatet e analizës ANOVA të përdorur gjatë analizës (përkatesisht hipotezat H1-H4). Në analizën shumëvariabëlshe konsiderohet regresion i shumëfishtë linear (metoda e katrorëve më të vegjël). Kjo teknikë është përzgjedhur sepse:

- Është gjerësisht e përdorur në shpjegimin e fenomeneve të ndryshme në shkencat shoqërore,
- Është më së shumti e përdorur edhe në studimet e shqyrtuara në kapitullin e dytë të këtij punimi,
- Është e thjeshtë në përdorim dhe interpretimin e rezultateve,
- Është një teknikë e përshtatshme për të eksploruar lidhjen midis një variabëli të varur që merr vlera të vazhduara numerike dhe një grupi variablash të pavarur të ndryshëm (fiks, kategorik apo të vazhduar),
- Kjo metodë përcakton se si varianca e variablave të pavarur përcaktojnë variancën e variabëlit të varur. Gjithashtu, përcakton ndikimin individual sasior që kanë variabëlat e pavarur.

### **3.3.5.1 Variablat e përfshirë në regresion**

#### **A. Variabëli i varur**

Sikurse është përmendur gjatë këtij punimi dhe në përjasje me pjesën dërmuese të literaturës së shqyrtuar (shih tabela nr 2.2), variabëli që shpreh menaxhimin e fitimeve është vlera absolute e rrjedhjeve jonormale (ABS RJN). Ky variabël matet nëpërmjet termit të gabimit në regresionin, sipas modelit të përzgjedhur (I, II, III apo IV). Është pikërisht ABS RJN që do të përdoret si variabël i varur në regresionin e konsideruar në analizën shumëvariabëlshe. Rrjedhjet jonormale janë konsideruar në vlerë absolute pasi në fokus është menaxhimi i fitimit si fenomen, pavarësisht faktit nëse ai ka ndikuar në rritjen apo zvogëlimin e fitimit të raportuar.

#### **B. Variablat e pavarur të konsideruar regresion :**

➤ **Variabël që shpreh cilësinë e auditimit**

- DeAngelo (1981) ka analizuar teorikisht lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe madhësisë së audituesit, duke argumentuar se audituesit e mëdhenj kanë një numër të madh klientësh, duke qenë më të pavarur dhe duke prodhuar kështu procese më cilësore auditimi. Në përputhje me këtë studim, por dhe me shumë të tjera, si Davidson (1993), Lennox (1999) etj.. (shih tabelën nr. 2.2), do të identifikojmë **Madhësinë e audituesit të jashtëm** me variabël dikotomik **AUDITUES it**, i cili merr vlerë  $AUDITUES = 1$ , nëse shoqëria i është nënshtruar procesit të auditimit të pasqyrave financiare nga një Auditues i madh Big4 dhe  $AUDITUES = 0$ , nëse pasqyrat financiare të shoqërisë janë audituar nga një JoBig4 (ashtu sikurse është specifikuar dhe në pyetjen e dytë kërkimore). Duke supozuar që audituesit e mëdhenj janë më të aftë për të vërejtur parregullsitë (të specializuar) dhe për t'i raportuar ato (të pavarur), si dhe janë më shtrëngues në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve, pritet të evidentohet një lidhje negative midis madhësisë së audituesit dhe menaxhimit të fitimeve.

➤ **Variablat që shprehin karakteristika të shoqërisë**

- **Madhësia e shoqërisë** - e shprehur me logaritmin natyror të aktiveve totale të shoqërisë në vitin  $i$ , **LN AKTIVE**. Në ndryshim nga analiza e variacionit Welch Anova e përdorur për të analizuar ndikimin e madhësisë së shoqërisë mbi menaxhimin e fitimeve, në këtë regresion madhësia e shoqërisë, shprehet nga logaritmi natyror i aktiveve të shoqërisë për çdo firmë - vit vrojtim, duke marrë vlera të vazhduara numerike.
- **Mosha e shoqërisë** e shprehur me logaritmin natyror të viteve të aktivitetit, (**LN MOSHA it**) që prej themelimit të saj. Sipas studimeve të mëparshme, është treguar se menaxhimi i fitimeve ndryshon gjatë ciklit të jetës së shoqërive (Anthony dhe Ramesh 1992). Shoqëri më të vjetra në moshë dhe më të konsoliduara në sektorin e tregut në të cilin operojnë kanë më pak gjasa të përfshihen në menaxhimin e fitimeve. Pra, pritet të rezultojë një lidhje negative midis moshës së shoqërisë dhe menaxhimit të fitimeve.

- **Përfshirja e pronarëve në strukturat drejtuese**, identifikohet me variabël dikotomik. Nëse shoqëri administrohet nga drejtues pronar, variabli merr vlerën **DREJTUES PRONAR=1**, nëse jo **DREJTUES PRONAR = 0**. Përfshirja e pronarëve në menaxhim ka qenë objekt analize i disa studimeve. Duke menduar se marrëdhëniet kontraktuale menaxher - pronar ndikojnë në iniciativat që mund të ndërmerren nga menaxherët dhe që rezultojnë në menaxhim të fitimeve, kryesisht duke i përmirësuar shifrat e raportuara për të përfituar reputacion më të mirë, shpërblim më të mirë etj, është zgjedhur ky variabël për të identifikuar nëse pronarët përfshihen në menaxhim apo jo. Pritet që rezultatet të shprehin lidhje negative. Sa më shumë të përfshihen pronarët në menaxhim, aq më pak gjasa ka të ndërmerren iniciativa të menaxhimit të fitimeve nga menaxherët. Variabëli drejtues pronar ose jo pronar, për shoqëritë që përbëjnë kampionin është identifikuar nga shqyrtimi i dokumenteve të tërhequra nga QKR (në shënimet e përgjithshme mbi pasqyrat financiare të Raportit të Audituesit është lehtësisht e identifikueshme forma e pronësisë si dhe përbërja e pronarëve dhe administratorëve të shoqërisë), nga kontakte të drejtpërdrejta me administratorët në disa raste ose nga informacioni në faqet zyrtare të publikuara të shoqërive përkatëse.
- **Kompleksiteti i shoqërisë** i vlerësuar nëpërmjet numrit të degëve që operojnë në territore të ndryshme (numri i segmenteve) **KOMPLEKSITETI**. Duke supozuar se, sa më komplekse të jenë shoqëritë, aq më shumë mbështetje mund të kërkojnë nga auditues të specializuar, duke rritur kështu kërkesën për auditim më cilësor dhe raportim financiar cilësor, me rrjedhje kufizimin e iniciativave të menaxhimit të fitimit. Konsideruar supozimin e mësipërm pritet që shoqëritë më komplekse të rezultojnë me vlera më të vogla të rrjedhjeve jonormale. Variabëli **KOMPLEKSITETI** është dikotomik dhe me vlerën **KOMPLEKSITETI =1**, nëse numri i degëve është më shumë se 1 dhe vlerën **KOMPLEKSITETI =0**, nëse numri i degëve është vetëm 1.

➤ **Variabla që shprehin performancën e shoqërive**

- **LEVA FINANCIARE** e shprehur nga raporti detyrime totale / aktive totale e llogaritur për çdo firmë - vit vrojtim në kampionin e vlefshëm në studim. Pritshmëria është se sa më i madh të jetë financimi me borxh, aq më e lartë është kërkesa për auditim me cilësi të lartë nga ana e huadhënësve. Studime të mëparshme kanë gjetur ndikim të konsiderueshëm të levës financiare mbi zvogëlimin apo rritjen e të ardhurave. Kështu shoqëritë mund të përmirësojnë rezultatin e raportuar, me qëllim që të sigurojnë me lehtë financimin me borxh (Press dhe Weintrop 1990; Watts dhe Zimmerman, 1990; DeFond dhe Jiambalvo, 1994; Young, 1999). Ndërsa DeAngelo dhe Skinner (1994) tregojnë se shoqëritë mund të zvogëlojnë fitimet për qëllime të rilidhjes së kontratave. Me qenë se, variabëli i varur është në vlerë absolute, leva financiare do të përdoret për të dy efektet (rritëse dhe rënëse) dhe pritjet të ketë shenje negative sikurse tregojnë dhe studime të mëparshme (Frankel, Johnson dhe Nelson 2002). Në regresion raporti i levës financiare paraqitet si logaritëm natyror i raportit të levës financiare - **LN LEVA FINANCIARE.**, dhe merr vlera të vazhduara numerike.
- Për të identifikuar **rezultatin ushtrimor negativ** do të përdoret variabël dikotomik **HUMBJE** = 1, nëse është raportuar rezultat negativ dhe **HUMBJE** = 0 nëse jo. Një nga motivet që mund të çojë në informacion jo cilësor, dhe menaxhim të fitimit të raportuar është dhe evazioni fiskal. Gjithashtu, menaxherët mund të ndryshojnë rezultatet për të zbutur efektin e rezultateve negative. Sipas Park dhe Shin (2004), shoqëritë që ndeshen me kufizime financimi të aktivitetit të vet mundohen të shmangin raportimin e humbjeve. Për më tepër Roychowdhury (2006) evidenton se menaxherët ndërmarrin aktivitete reale me qëllim shmangien e rezultateve negative. Reduktimi i fitimit dhe ndonjëherë raportimi i humbjeve mund të jetë tregues që lë shkak për të investiguar më shumë në lidhje me këtë fenomen. Në këtë këndvështrim ka gjasa që shoqëritë me rezultate negative të kenë rrjedhje jonormale më të larta.
- **Rritja vjetore e shitjeve (SHITJE)** e shprehur si ndryshimi në përqindje nga viti në vit i të ardhurave nga shitja, do të përdoret në analizë në funksion të identifikimit të rasteve kur shoqëritë me rritje të madhe të

shitjeve mund të rezultojnë në asimetri informacioni, shkak ky, i cili mund të çojë në përfshirje të menaxherëve në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Në dallim nga analiza Two Way ANOVA e përdorur në pyetjen e tretë kërkimore, ky variabël në regresionin e shumëfishtë linear merr vlera të vazhduara numerike. Variabëli Shitje gjithashtu do të paraqitet i logaritmuar me bazë e (**LN SHITJE**).

- **ROA it** - Variabëli shprehet si raport i fitimit neto dhe totalit të aktiveve dhe është një tregues që shpesh përdoret nga investitorët, për të kuptuar se si aktiviteti i tyre konverton investimet në vlera monetare. Përdorimi i këtij variabëli mbështetet mbi supozimin se shoqëritë me performancë të lartë kanë kërkesë më të ulët për proces cilësor të auditimit. (Young, 1999; Dechow etj., 1995). Gjithashtu nivele të larta fitimi mund të jenë sinjale për rritje ekonomike, dhe mundësi të reja investimi, të cilat mund të kërkojnë financim të ri nga burime të jashtme të shoqërisë. Rrjedhimisht, kërkesa për raporte cilësore të prodhuara nga kontabiliteti do të rritet. Kështu, performanca e lartë kufizon nevojën për të menaxhuar fitimet. (Kothary etj., 2005; Ali etj., 2007). Për sa më sipër pritet të ketë një lidhje negative midis ROA it dhe vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale. Raporti **ROA it** llogaritet për çdo firmë - vit vrojtim sipas zërave të raportuara në bilancin kontabël të shoqërive, në kampionin e vlefshëm në studim dhe merr vlera të vazhduara numerike. Në regresion do të shprehet në formën e logaritmit natyror (**LN ROA**).

### ➤ Variabla që shprehin formën e pronësisë

- **Financimi me kapital të huaj** i aktivitetit të shoqërisë ka të ngjarë të çojë në rritje të kërkesës për proces cilësor të auditimit të raporteve financiare. Oxelheim dhe Randøy (2003) në punimin e tyre sugjerojnë se sa më e madhe të jetë përpjesa e investitorëve të huaj dhe bordit të drejtuesve të huaj në shoqëri, aq më shtrënguese do të jenë strukturat qeverisëse të korporatave. Për rrjedhojë, iniciativat e menaxhimit të fitimeve ka gjasa që të kufizohen. Për sa më sipër pritet të evidentohen vlera më të ulëta të rrjedhjeve jonormale në ato shoqëri të cilat financohen plotësisht apo pjesërisht nga kapital i huaj. Ky tregues do të identifikohet si variabël

dikotomik **KAPITAL HUAJ** dhe do të marrë vlerën **KAPITAL HUAJ = 1**, nëse aktiviteti është financuar pjesërisht ose plotësisht nga kapital i huaj dhe **KAPITAL HUAJ = 0**, nëse aktiviteti është financuar nga kapital vendas.


- Referuar ndryshimeve midis sektorit publik dhe privat, specifikuar dhe në pyetjen e katërt kërkimore, në regresion përfshihet variabël dikotomik **GOV = 1**, nëse shoqëria i përket sektorit publik dhe **GOV = 0**, nëse i përket sektorit privat.

Konsideruar grupin e variablave të përzgjedhur të specifikuar si më lartë, funksioni shumëvariabëlsh do të ketë formën:

$$R_{JN} it = 0 + 1 \text{ AUDITUES } it + 2 \text{ LN AKTIVE } it + 3 \text{ LN SHITJE } it + 4 \text{ GOV } i + 5 \text{ LN MOSHA } it + 6 \text{ DREJTUES PRONAR } i + 7 \text{ KOMPLEKSITETI } i + 8 \text{ LN LEVA FINANCIARE } it + 9 \text{ HUMBJE } it + 10 \text{ LN ROA } it + 11 \text{ KAPITALI HUAJ } it + it.$$

Në figurën e mëposhtme ilustron kuadri konceptual i regresionit të shumëfishtë linear të trajtës OLS.

**Figura 3.1. Kuadri konceptual i regresionit**



Për sa më sipër hipotezat e testueshme në funksionin e regresionit janë :

- H1: Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve, në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar. (Konfirmimi i hipotezës H1 nëpërmjet analizës shumë variabëlshë).
- H2: Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H2 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshë).
- H3: Ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H3 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshë).
- H4: Përkatësia në sektorin publik/privat të shoqërive më tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H4 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshë)
- H5: Moshë e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H6: Pronësia menaxheriale ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H7: Kompleksiteti ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H8: Leva financiare ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H9: Shoqëritë me rezultat negativ rezultojnë me nivele më të larta të menaxhimit të fitimit
- H10: Shoqëritë me ROA më të lartë rezultojnë me nivele më të ulëta të menaxhimit të fitimit
- H11: Kapital i huaj ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve

Për të ekzaminuar rëndësinë e parametrave të modelit përfundimtar përdorim regresionin e shumëfishtë linear, metoda e katrorëve më të vegjël (OLS), si një nga instrumentet më popullore që shprehin lidhjen midis variablave, në këtë rast i përzgjedhur për të ekzaminuar lidhjen midis rrjedhjeve jonormale dhe faktorëve të konsideruar në analizë si variabla të pavarur, me ndikim mbi menaxhimin e fitimeve. Modeli vlerësohet fillimisht në lidhje me supozimet bazë mbi të cilat mbështetet regresioni i shumëfishtë linear (mesatarja e mbetjeve është e barabartë me zero, heteroskedasticiteti nuk është i pranishëm, autokorelacioni nuk është i pranishëm,

shpërndarja e mbetjeve është normale, multikolineariteti nuk është i pranishëm), ashtu sikurse është specifikuar në analizën për llogaritjen e rrjedhjeve jonormale (hapi 2). Për të testuar rëndësinë e modelit bazohemi te analiza e variancës dhe kriterit Fisher duke konkluduar në lidhje me rëndësinë statistikore të koefiçienteve të pjesshëm të regresionit. Nëpërmjet programit SPSS 21, për vlerësimin e regresionit dhe konfirmimin e rezultateve konsiderohet metoda standarde (enter), e cila konsideron të gjithë variablat në të njëjtën kohë, si dhe metoda Stepwise, e cila konsideron variablat një nga një dhe eliminon variablat jo të rëndësishëm. Gjithashtu, mesatarja, devijimi standard, vlerat e asimetrisë dhe koefiçientit Kurtosis përdoren për të vlerësuar rrjedhjet jonormale, si treguesi i përzgjedhur për të përfaqësuar dhe evidentuar fenomenin e menaxhimit të fitimeve

### **3.4 Përmbledhje e kapitullit të tretë**

Në kapitullin e shqyrtimit të literaturës u tregua se ekziston një numër i konsiderueshëm studimesh që ekzaminojnë menaxhimin e fitimeve dhe lidhjet e tij me faktorë të ndryshëm, në kontekste të ndryshme në vende të zhvilluara dhe në zhvillim. Në përjasje të studimeve të mësipërme në këtë kapitull u identifikuan faktorët që janë përdorur për të shpjeguar këtë fenomen si dhe marrëdhëniet midis tyre. Duke u mbështetur në këto marrëdhënie janë ndërtuar hipotezat e testueshme të studimit, si dhe janë specifikuar teknikat që përdoren për testimin e tyre. Teknikat e përzgjedhura në studim janë teknikat: Welsh ANOVA, Two Way ANOVA dhe Regresioni i Shumëfishtë Linear (OLS). Hipotezat e testueshme janë ngritur për të identifikuar dhe ekzaminuar fenomenin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar si dhe lidhjen e tij me cilësinë e auditimit, madhësinë e shoqërisë, përkatësinë në sektorin publik e privat të shoqërive dhe faktorë të tjerë të përzgjedhur në analizë.

## KAPITULLI I KAT RT

## ANALIZA E REZULTATEVE

Menaxhimi i fitimeve është një fenomen, i cili ka qenë objekt studimi, kritikash dhe shqetësimi për shumë studiues. Në kontekstin shqiptar është me vlerë të trajtohet ky fenomen, duke i shtuar literaturës ekzistuese rezultatin që prodhojnë analizat njëvariabëlshë dhe shumëvariabëlshë që lidhen me studimin e fenomenit të menaxhimit të fitimeve të trajtuar në këtë kapitull, si dhe lidhjen e tij me cilësinë e auditimit e faktorë të tjerë të konsideruar në analizë.

#### 4.1 Përshkrimi i kampionit

Në tabelën e 4.1 paraqitet kampioni i vlefshëm për studim. Nga gjithsej 258 firmë - vit vrojtmeve që i përkasin shoqërive të ndryshme për nga aktiviteti, forma e organizimit, pronësia etj., të vlefshme janë vetëm 205 firmë - vit vrojtme. Pra, 58 firmë - vit vrojtmeve janë përjashtuar për arsye të mungesës së të dhënave në lidhje me vlerësimin e variablave që përfshihen në studim. Më konkretisht janë përjashtuar nga kampioni shoqëri të cilat:

- kanë më pak se tre vite aktivitet,
- mungojnë një ose disa prej pasqyrave financiare,
- mungon raporti i Ekspertit Kontabël të Autorizuar,
- pasqyrat financiare janë konstatuar të kenë të dhëna jo të plota (apo me gabime).
- nuk është siguruar informacion i plotë për të gjitha variablat e konsideruar në studim.

**Tabela 4.1. Përshkrimi i kampionit të vlefshëm për studim**

	Firmë – vit vrojtme	Në %
Numri totali i firmë - vit vrojtmeve	258	100%
Firmë - vit vrojtme të përjashtuara për mungesa të dhënash në lidhje me llogaritjen e rrjedhjeve jonormale	53	21%
<b>Kampioni final i studimit</b>	<b>205</b>	<b>79%</b>

*Burimi: Përlllogaritje të autorit*

Tabela nr 4.2, paraqet klasifikimin e shoqërive në kampion, në përputhje me Klasifikimin e Përgjithshëm Industrial European të Aktiviteteve Ekonomike (NACE. Rev.1.1) i pranuar dhe nga autoritetet Shqiptare (NVE 1.1). Sipas INSTAT,<sup>7</sup> ndërmarrjet aktive për vitin 2013 klasifikohen në 16 industri (përveç institucioneve financiare që nuk janë përfshirë në studim), prej të cilave në kampion identifikohen shoqëri të klasifikuara në 12 industri dominuese. Vihet re se aktiviteti ekonomik dominues në kampion është ai i tregtisë së përgjithshme me 24.3% të kampionit në konvergencë edhe me të dhënat e INSTAT ku, sipas statistikave të raportuara në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve Aktive 2013, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake, të klasifikuara në seksionin G përbën sektorin dominues (në numër aktivitetesh ekonomike).

Gjithashtu, më së shumti shoqëritë që përbëjnë kampionin auditohen nga auditues jo Big4 dhe vetëm në 9.7% të rasteve, auditimi i pasqyrave financiare është realizuar nga shoqëri Big4 që operojnë në tregun shqiptar. Kjo shpërndarje konsiderohet normale, pasi klientët e shoqërive Big4 veç të tjerash janë bankat e nivelit të dytë, ndërkohë që sektori bankar nuk është objekt i kësaj analize.

**Tabela 4.2. Përbërja e kampionit sipas klasifikimit industrial dhe përfshirjes së shoqërive Big4 në procesin e auditimit.**

Nr	Seksioni	Klasifikimi Industrial sipas NVE 1.1	Shoqëri të audituara nga Big4		Shoqëri të audituara nga Jo-Big4		Shoqëri Gjithsej	
			Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	A	Bujqësi	1	0.5	1	0.5	1	0.5
2	C	Industri nxjerrëse	1	0.5	0	0	1	0.5
3	D	Industri përpunuese	1	0.5	41	20	42	20.4

<sup>7</sup> Regjistri Statistikor i ndërmarrjeve 2013-Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik NVE 1.1

4	E	Prodhim, shpërndarje energji, ujë, gaz.	0	0	15	7.3	15	7.3
5	F	Ndërtim	3	1.5	17	8.3	20	10.3
6	G	Tregti	0	0	50	26.4	50	24.3
7	H	Hotel, restorant, kafe	0	0	6	2.9	6	2.9
8	I	Transport, magazinim , komunikacion	7	3.4	17	8.3	24	11.7
9	K	Real estate, shërbime të tjera për ndërmarrjet	6	2.9	18	8.8	24	11.7
10	M	Arsimi	0	0	4	2	4	1.9
11	N	Shëndetësia	0	0	11	8.4	11	5.3
12	P	Administrim publik	0	0	6	2.9	6	2.9
		<b>TOTALI</b>	<b>19</b>	<b>9.7</b>	<b>186</b>	<b>90.3</b>	<b>205</b>	<b>100</b>

*Burimi: Përlllogaritje të autorit*

Tabela nr 4.3 jep të dhëna në lidhje me formën e organizimit, pronësinë, prodhimin e të mirave dhe shërbimeve dhe financimin me kapital të huaj. Nga vërtetimi i të dhënave në kampion, 72% e përbëjnë shoqëri të organizuara si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe vetëm 28% janë Shoqëri Aksionare. Gjithashtu, në kampion dominon sektori privat me 84%, kundrejt shoqërive shtetërore me aktivitet tregtar me 16%. Për sa i përket produktit të krijuar, tregu i shërbimeve përfaqësohet me 60% të kampionit, ndërsa ai i të mirave me 40%. Shoqëritë që financohen pjesërisht apo plotësisht me kapital të huaj përbëjnë 35% të firmë - vit vërtetimeve.


**Tabela 4. 3. Klasifikimi sipas formës së organizimit, pronësisë, prodhimit të të mirave dhe shërbimeve dhe financimin me kapital të huaj**

			Nr	%
1	Forma e organizimit	Sh.a	57	28
		Sh.p.k	148	72
2	Pronësia	Pronësi private	171	84

		Pronësi Shtetërore	34	16
3	Prodhim të mirash apo shërbimesh	Të mira	81	40
		Shërbime	125	60
4	Financimi me kapital të huaj ose vendas	Kapital i huaj	72	35
		Kapital vendas	133	65

*Burimi: Përlogaritje të autorit*

Për sa i përket shpërndarjes së kampionit sipas ndarjeve administrative, vihet re se përqendrimi më i madh është në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë me 50% të firmë – vit vrojtimeve, ashtu sikurse raportohet dhe nga INSTAT<sup>8</sup>, në regjistrin e ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2013. Grafiku i më poshtëm tregon këtë shpërndarje në gjithsej 9 Qarqe në tregun shqiptar.



**Figura 4.1: Shpërndarja e kampionit sipas Qarqeve**

Nga përshkrimi i kampionit të mësipërm, të vlefshëm në këtë studim vihet re një diversifikim i tij në lidhje me shtrirjen gjeografike, formën e organizimit, pronësinë,

<sup>8</sup> Regjistri Statistikor i ndërmarrjeve 2013-Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik NVE 1.1

prodhimin e të mirave dhe shërbimeve dhe mënyrën së financimit (financim me kapital të huaj apo vendas) me qëllim që, analiza empirike të përftojë rezultate sa më përfaqësuese për tregun shqiptar.

## 4.2 Analiza e rezultateve

### 4.2.1 Evidentimi i fenomenit “menaxhim i fitimeve”

***Pyetja kërkimore 1:*** A përfshihen menaxherët në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar në iniciativat e menaxhimit të fitimeve?

#### Hapi 1 – Llogaritja e rrjedhjeve totale

Sikurse është prezantuar dhe në kapitullin e shqyrtimit të literaturës rrjedhjet totale janë llogaritur sipas formulës së më poshtme:

$$RT = FN - (CFO + CFI) \quad (1)$$

Ku:

RT = rrjedhjet totale

FN = fitimi neto

CFO = fluksit i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit

CFI = fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i investimit.

Për çdo shoqëri është shqyrtuar bilanci kontabël dhe pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, për të bërë të mundur llogaritjen e këtij variabëli i cili më pas është vendosur në raport me totalin e aktivitetit në fillim të periudhës dhe është përdorur në analizën në vazhdim për vlerësimin e rrjedhjeve jonormale.

#### Hapi 2 - Llogaritja e rrjedhjeve normale

Për të vijuar me vlerësimin e rrjedhjeve jonormale, vlera absolute e të cilave do të jetë variabëli i cili shpreh menaxhimin e fitimeve dhe përbën evidencë se në tregun shqiptar ky fenomen është prezent, fillimisht u vlerësuan modelet e parashtruara në kapitullin e dytë të këtij punimi.

Për të përzgjedhur modelin më eficient në përcaktimin e rrjedhjeve jonormale, janë vlerësuar të gjitha modelet për t'u siguruar në lidhje me rëndësinë statistikore të secilit prej tyre. Tabela nr 4.4 paraqet në mënyrë të përmbledhur statistikatat kryesore

të modeleve të konsideruar në metodën e katrorëve më të vegjël (OLS), ndërkohë që në aneksin A paraqiten të plota statistikat për të dhënat e procesuara në programin SPSS 21, për të gjitha modelet.

Tabela 4.4. Statistika kryesore përmbledhëse e modeleve të vlerësimit të rrjedhjeve normale

modeli	Statistika F	Sig F	R <sup>2</sup> e rregulluar	Durbin Wartson	White test statistika LM	t	Sig(t)	Statistika të Kolinearitetit	
								Toleranca	VIF
Modeli Jones	4.517	0,004	5.8%	1,927	LM=13.99				
1/ A t-1					P( Chi square(8)) >13.99 = 0.081938	2.625	,009	,912	1.096
SHITJE/A t-1						1.599	,112	,946	1.057
AAGJ/ A t-1						0.580	,563	,850	1.052
Modeli Jones i Modifikuar	6.24	0,000	8,6%	1,897	LM= 55.03				
1/ A t-1					P( Chi square(8)) >55.03= 0.000	3.892	,000	,944	1.060
( SHITJE- LLOG ARK)/A t-1						-1.200	,232	,983	1.018
AAGJ/ A t-1						,997	,320	,960	1.042
Modeli i zgjeruar Jones - Cash flow	8.118	0,000	15,50%	1,842	LM= 25.87				
1/ A t-1					P( Chi square(13)) >25.87= 0.018	2.916	,004	,962	1.040
( SHITJE- LLOG ARK)/A t-1						-2.313	,022	,924	1.082

**Cilësia e Auditimit dhe Menaxhimi i Fitimeve: Rasti i Shqipërisë**

AAGJ/ A t-1						1.871	,063	,966	1.036
CFO /A t-1						-2.896	,004	,918	1,089
Modeli i Matjes së Performancës	106.237	0,000	74.4%	2.029	LM= 13.59				
KONSTANTIA					P( Chi square(13) >13.59 = 0.481	3,212	,002		
1/ A t-1						-0,038	,970	,836	1.196
( SHITJE- LLOG ARK)/A t-1						-5.991	,000	,990	1.910
AAGJ/ A t-1						-2.092	,038	,847	1.181
ROA it						18.668	,000	,929	1.077

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 2.*

## I. Modeli Jones

- Variabëli i varur - RT it ( rrjedhjet totale të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë për çdo firmë - vit vrojtim (n=205), në raport me aktivet totale në fillim të vitit përkatës.  $RT = FN - (CFO + CFI)$
- Variablat e pavarur:  $1/A_{t-1}$  (inversi i aktivitet), Shitje i  $/A_{i,t-1}$  (ndryshimi në të ardhurat nga shitja) në raport me aktivet në fillim të vitit,  $AAGJM_{it}/A_{i,t-1}$  (aktivet afatgjata materiale bruto në raport me aktivet në fillim të vitit përkatës).

Për të vlerësuar modelin fillimisht janë testuar supozimet bazë mbi të cilat ngrihet funksioni i regresionit të shumëfishtë linear. Për t'u siguruar në lidhje me normalitetin e shpërndarjes së të dhënave dhe vlerat ekstreme influencuese, fillimisht janë llogaritur vlera e standardizuar e mbetjeve (standardised residual values) dhe janë përjashtuar nga kampioni tre raste që rezultojnë të kishin z statistikore  $>3.3$  ose  $<-3.3$ . Më pas është llogaritur vlera kritike e distancës Cook, e cila rezulton të jetë e barabartë me 0.0202.<sup>9</sup> Pas pastrimit të kampionit nga rastet ku distanca Cook's është më e madhe se vlera kritike, shpërndarja e mbetjeve rezulton thuhet normale. Në këtë konkluzion arrihet edhe nëpërmjet inspektimit pamor të grafikëve (plots) (shih Apendiks A). Pas veprimeve të mësipërme kampioni është reduktuar në 172 firmë - vit vrojtime. Për t'u siguruar në lidhje me homoskedasticitetin testi White është realizuar nëpërmjet programit statistikor Gretl. (pasi SPSS 21 nuk llogarit drejtpërdrejt këtë statistikë). White test tregon se heteroskedasticiteti nuk është i pranishëm përderisa (p Chi square(8)  $>13.99 = 0.081938$ ) ku p është më e madhe se 0.05, për nivelin e besueshmërisë 95%. Për më shumë, testi Durbin-Watson përdoret për të kontrolluar në lidhje me prezencën e autokorrelacionit. Fakti që kjo statistikë rezulton të jetë ndërmjet vlerave të lejueshme (1.5-2.5) dhe më konkretisht, statistika Durbin-Watson = 1,927 tregon se nuk është shkelur supozimi në lidhje me autokorrelacionin. Ndërsa, multikolineariteti është vlerësuar nëpërmjet statistikës VIF (Variance Inflation Factor) dhe tolerancës përkatëse. Kjo statistikë është raporti i variancës së standardizuar me variancën unike. Nëse e para është 10 herë më e madhe se e dyta që do të thotë se VIF është më e madhe se 10, atëherë është shkelur

<sup>9</sup> Vlera kritike e distancës Cook 's'  $= 4/(n-k-1) = 1/(203-3-1) = 0.020101$ .

supozimi i multikolinearititetit (Hair et al., 2009). Në rastin konkret kjo statistikë varion nga 1.052 (më e vogla) në 1.096 (më e madhja), duke konkluduar se variablat e pavarur nuk kanë lidhje të fortë midis tyre. Këtë fakt e vërtetojmë edhe nëse vërejmë statistikën në lidhje me korrelacionin e variablave të pavarur të modelit 1 në Apendiks A. Sikurse vihet re në tabelën e mësipërme  $R^2=5.8\%$  që do të thotë se modeli i regresionit (variablat e pavarur) mund të shpjegojë vetëm 5.8% të varacionit të variabëlites së varur. Ndërsa, për sa i përket variablave të konsideruar në model vihet re se vetëm inversi i aktivitetit ( $1/A_{i,t-1}$ ) paraqitet i rëndësishëm statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95% të sigurisë. Kjo bie ndesh me faktin që modeli në tërësi paraqitet i rëndësishëm pasi statistika  $F(3,169) = 4.517$  (sig  $F = 0.004$ ).

## II. Modeli Jones i Modifikuar

- Variabëlites i varur - RT it (rrjedhjet totale të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë për çdo firmë - vit vrojtim ( $n=205$ ), në raport me aktivet në fillim të vitit përkatës.  $RT = FN - (CFO + CFI)$
- Variablat e pavarur:  $1/A_{i,t-1}$  (inversi i aktivitetit), ( shitje it - Llogari Arkëtueshme it) /  $A_{i,t-1}$  (ndryshimi në të ardhurat nga shitja i korrigjuar me ndryshimet në llogari të arkëtueshme në raport me aktivet në fillim të vitit),  $AAGJM_{it} / A_{i,t-1}$  (aktivet afatgjata material bruto në raport me aktivet totale në fillim të vitit përkatës).

Në modelin e dytë të paraqitur janë përjashtuar 4 raste me z statistikore  $>3.3$  ose  $<-3.3$ . Pas llogaritjes së vlerës kritike Cook's, e cila rezulton të jetë e barabartë me 0.0203.<sup>10</sup>, kampioni pastrohet nga rastet influencuese dhe reduktohet në 169 firmë - vit vrojtime dhe shpërndarja mbetjeve rezulton thuhet normale sikurse vërehet dhe nga inspektimit pamor i grafikëve (plots) (shih Apendiks A). Testi White është realizuar nëpërmjet programit GRETL dhe tregon se probleme të heteroskedasticitetit janë të pranishme, pasi  $p(\text{Chi square}(8)) > 55.03 = 0.000$ , pra p është më e vogël se 0.05, për nivelin e rëndësisë 95%. Testi Durbin-Watson rezulton të jetë ndërmjet vlerave të lejueshme (1.5-2.5) dhe më konkretisht, statistika Durbin-Watson = 1,897 tregon se nuk është shkelur supozimi në lidhje me autokorrelacionin. Ndërsa multikolineariteti i vlerësuar nëpërmjet statistikës VIF (Variance Inflation Factor) dhe

<sup>10</sup> Vlera kritike e distancës Cook 's' =  $4/(n-k-1) = 1/(201-3-1) = 0.0203$ .

tolerancës përkatëse nuk është i pranishëm, pasi statistikat VIF për çdo variabël të pavarur janë më i vogla se 10 dhe tolerancat më të mëdha se 0.1.  $R^2=8,6\%$  që do të thotë se modeli i regresionit (variablat e pavarur) mund të shpjegojë vetëm 8,6% të variacionit të variablit të varur. Ndërsa, për sa i përket variablave të konsideruar në model vihet re se ashtu sikurse dhe në modelin e parë, vetëm inversi i aktivitetit ( $1/A_{t-1}$ ) paraqitet i rëndësishëm statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95% të sigurisë. Ndërkohë, modeli në tërësi paraqitet i rëndësishëm statistikisht pasi  $F(3,166)=6.294$ , ( $\text{sig}F=0.000$ ). Korrigjimi që në këtë model bëhet ndryshimit të shitjeve nga viti në vit me ndryshimin në llogaritjen të arkëtueshme, nuk tregon të ketë rezultuar në ndryshime të konsiderueshme statistikore ndërmjet modelit Jones dhe modelit Jones të Modifikuar.

### III. Modeli i Zgjeruar Jones - Cash flow

- Variabli i varur - RT it (rrjedhjet totale të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë për çdo firmë - vit vrojtim në raport me aktivet në fillim të vitit përkatës.  $RT = FN - (CFO + CFI)$
- Variablat e pavarur:  $1/A_{t-1}$  (inversi i aktivitetit), ( Shitje it- Llogaritja Arkëtueshme it) /  $A_{i,t-1}$  (ndryshimi në të ardhurat nga shitja i korrigjuar me ndryshimet në llogaritjen të arkëtueshme në raport me aktivet në fillim të vitit),  $AAGJM_{it} / A_{i,t-1}$  (aktivet afatgjata material bruto në raport me aktivet në fillim të vitit përkatës) dhe  $CFO / A_{i,t-1}$  (ndryshimi i fluksit të parave nga veprimtaria e shfrytëzimit në raport me aktivet totale në fillim të vitit).

Në Modelin e Zgjeruar Jones - Cash Flow, pas pastrimit të kampionit nga rastet ekstreme të vlerësuar nëpërmjet Z statistikor (standardised residuals values) dhe vlerës kritike Cook's, e cila është e barabartë me 0.021<sup>11</sup> janë 155 firmë - vit vrojtime për të cilat shpërndarja mbetjeje rezulton thuhet normale (shih grafikët në Apendiks A). Ky model gjithashtu shfaq probleme të heteroskedasticitetit, pasi testi White rezulton  $LM=25.87$ ,  $P(\text{Chi square}(13) > 25.87) = 0.018$ . Ndërsa supozimi në lidhje me autokorrelacionin nuk rezulton të jetë shkelur, pasi statistika e Testit Durbin-Watson = 1.842 paraqitet të jetë me vlera brenda kufijve të lejuar. Gjithashtu,

<sup>11</sup> Vlera kritike e distances Cook 's=  $4/(n-k-1) = 1/(199-4-1) = 0.02072$ .

supozimi në lidhje me multikolinearitetin (statistika VIF për të gjithë variablat e pavarur është më e vogël se 10) nuk rezulton të jetë shkelur. Ndërkohë që,  $R^2=15,6\%$  është konsiderueshëm më i lartë se dy modelet e para. Variabli i ri i futur në model CFO, ka përmirësuar aftësinë shpjeguese të variablave të pavarur ndaj variancës së variablit të varur. Nga inspektimi i statistikës t dhe sig(t) për të gjithë variablat shpjegues, jo të gjithë paraqiten të besueshëm dhe të rëndësishëm statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95% të sigurisë. Megjithatë, variabli i konsideruar rishtazi CFO vlerësohet të jetë i rëndësishëm. Ndërsa, aktivet afatgjata materiale dhe ndryshimi në të ardhurat nga shitja, i korrigjuar me ndryshimet në llogari të arkëtueshme nuk janë tregues të mirë të rrjedhjeve. Modeli në tërësi paraqitet i rëndësishëm statistikisht ( $F(4;151)=8.118$ , Sig F=0.000) në nivelin 95 % të besueshmërisë.

#### IV. Modeli i matjes së performancës

- Variabli i varur - RT it ( rrjedhjet totale të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë për çdo firmë - vit vrojtim për n=205, në raport me aktivet në fillim të vitit përkatës.  $RT = FN - (CFO + CFI)$
- Variablat e pavarur:  $1/A_{i,t-1}$  (inversi i aktivitetit), ( Shitje it- Llogari Arkëtueshme it) /  $A_{i,t-1}$ , (ndryshimi në të ardhurat nga shitja i korrigjuar me ndryshimet në llogari të arkëtueshme në raport me aktivet në fillim të vitit),  $AAGJM_{it} / A_{i,t-1}$  (aktivet afatgjata materiale bruto në raport me aktivet totale në fillim të vitit përkatës) dhe ROA (raporti i kthimit mbi aktivet në vitin përkatës).

Edhe në analizën e këtij modeli janë përjashtuar rastet me z statistikore  $>3.3$  ose  $<-3.3$ . Dhe pas llogaritjes së vlerës kritike Cook,s, e cila rezulton të jetë e barabartë me 0,021<sup>12</sup>, kampioni pastrohet nga rastet influencuese dhe reduktohet në 146 firmë - vit vrojtime dhe shpërndarja mbetjeve rezulton thuhet normale, (shih Apendiks A). Testi White tregon se supozimi mbi heteroskedasticitetin nuk shkelet,  $LM=13.59$  dhe  $P(\text{Chi square}(13) >13.59) = 0.481$ , p është më e madhe se 0.05, për nivelin e rëndësisë 95%. Testi Durbin–Watson rezulton të jetë 2.029, vlerë kjo brenda intervalit të lejueshëm (1.5-2.5) dhe tregon se nuk është shkelur supozimi në lidhje me

<sup>12</sup> Vlera kritike e distances Cook 's=  $4/(n-k-1) = 1/(201-4-1) = 0.021$ .

autokorrelacionin. Ndërsa, multikolineariteti i vlerësuar nëpërmjet statistikës VIF (Varianca Inflation Factor) dhe tolerancës përkatëse nuk është i pranishëm, pasi statistikat VIF për çdo variabël të pavarur janë më të vogla se 10 dhe tolerancat, më e mëdha se 0.1. Ky model paraqitet më i rëndësishëm statistikisht në krahasim me tre modelet e më sipërme pasi statistika F është më e lartë ( $F=106.237$ ,  $\text{Sig}(F)=0.000$ ). Gjithashtu, më e mirë paraqitet të jetë dhe aftësia shpjeguese e variacionit të variabëlilit të varur pasi  $R^2=74.4\%$ . Për sa i përket variablave të pavarur, vihet re se variabëli i konsideruar rishitas në model ROA, paraqitet i rëndësishëm statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95% .

Duke përmbledhur, gjatë analizës krahasuese të modeleve të parashtruara më sipër vërejmë se për kampionin e vlefshëm në studim është më i përshtatshëm për t'u përdorur Modeli 4, i cili statistikisht tregohet të jetë më i mirë për sa i përket rëndësisë statistikore të modelit dhe variablave, si dhe testeve përkatës në lidhje me multikolinearitetin, heteroskedasticitetin dhe autokorrelacionin të nevojshëm për një model të trajtës OLS. Pavarësisht gjetjeve të autorëve të ndryshëm që vlerësojnë efikasitetin e Modelit Jones të Modifikuar, si një instrument cilësor për zbërthimin e rrjedhjeve totale në normale dhe jonormale, në analizën e mësipërme ky model si dhe Modelet Jones të Modifikuar me CFO rezultojnë të jenë më pak eficient sesa Modeli i Matjes së Performancës i zhvilluar nga *Kothari, Leone dhe Wasley (2005)*. Për rrjedhojë, ky model përdoret në përllogaritjet e rrjedhjeve jonormale, vlera absolute e të cilave përdoret si tregues i menaxhimit të fitimeve dhe është konsideruar në analizat e mëtejshme në këtë punim, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të parashtruara në funksion të përmbushjes së objektivave dhe qëllimit të këtij punimi.

### Hapi 3 – Llogaritja e rrjedhjeve jonormale

Hapi tjetër në përpunimin dhe analizën e të dhënave përkon me ndarjen e rrjedhjeve totale në rrjedhje normale (të pritshme) dhe jonormale (jo të pritshme). Përllogaritjet bëhen sipas ekuacionit të rrjedhur nga analiza e mësipërme ( modeli 4)

$$RJN_{it} = \frac{RT_{it}}{A_{i,t-1}} - (0.021 - 0.002 \frac{1}{A_{i,t-1}} - 0.253 \frac{\Delta SHITJE - \Delta LLOG ARK}{A_{i,t-1}} - 0.096 \frac{AAGJM_{it}}{A_{i,t-1}} + 0.814 ROA)$$

Diferenca midis rrjedhjeve totale të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë për çdo shoqëri dhe rrjedhjeve sipas Modelit 4, ose e thënë ndryshe termi i gabimit është pikërisht treguesi që përdoret për të identifikuar “menaxhimin e fitimeve”.

Në tabelën e më poshtme jepen në mënyrë të përmbledhur statistikat në lidhje me llogaritjen e rrjedhjeve jonormale.

**Tabela 4.5. Statistika përshkruese të rrjedhjeve jonormale**

	RJN negative	RJN pozitive	RJN absolute
Mesatarja	-,2310	,5811	,4107
Mediana	-,0906	,0962	,0747
Varianca	,139	11,889	9,522
Devijimi standard	,37236	3,44811	3,08573
Minimumi	-1,63	,00	-1,63
Maksimumi	-,01	40,48	40,48
N	43	162	205
%	21%	79%	100%

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Sipas rezultateve në tabelën e mësipërme tregohet se 43 nga 205 vrojtme rezultojnë me vlera negative, me një mesatare prej  $RJN=(-0,2310)$ , që do të thotë se në 21% të rasteve shoqëritë kanë menaxhuar negativisht fitimet e raportuara për arsye jo të justifikueshme të aktivitetit normal të biznesit, ndërsa 162 raste me një mesatare prej  $RJN=(0,5811)$ , që përkon me 79 % të rasteve, shoqëritë i kanë menaxhuar pozitivisht ato.

Në vijim të analizës vlerësohen rrjedhjet jonormale në vlerë absolute sepse nuk konsiderohet nëse fitimet janë menaxhuar pozitivisht apo negativisht, por vetëm faktin që fitimet janë menaxhuar. Kështu, variabëli RJN (rrjedhje jo normale) transformohet në Abs RJN (vlera absolute e rrjedhjeve jonormale). Për të vlerësuar shpërndarjen normale të këtij variabëli, fillimisht vërejmë statistikat e Asimetrisë (A)

dhe koeficientit Kurtosiz (Q) si dhe zhvillojmë testet e normalitetit Shapiro-Wilk dhe Kolmogorov-Smirnov. Në tabelën 4.6 jepen statistikave përshkruese dhe testet e normalitetit për variabëlin Abs RJN ( vlera absolute e rrjedhjeve jonormale).

**Tabela 4.6. Statistika përshkruese për variabëlin Abs RJN**

	Statistika	Gabimi standard
Mesatare	,508	,215
Mediana	,096	
Varianca	9,432	
Devijimi standard	3,071	
Minimum	,000	
Maksimum	40,480	
Asimetria	11,539	,170
Koeficienti Kurtosis	144,540	,338
Testet e normalitetit	Statistika	Sig.
Shapiro-Wilk	,121	0,000
Kolmogorov-Smirnov	,434	0,000

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Sipas statistikave të mësipërme vërejmë se shpërndarja e variabëlit nuk është normale, përderisa Asimetria =11,539 dhe Kurtosis= 144,540, vlera këto të cilat duhet të jenë sa më afër vlerës 0, gjithashtu dhe testet e normalitetit nuk tregojnë për shpërndarje normale të variabëlit dhe në këto kushte rezultatet e analizës mund të çenohen. Atëherë është e nevojshme të bëhen transformimet e mëposhtme.

1. Të transformohet variabëli në logaritëm natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale.
2. Të identifikohen rastet me Z statistikor 3.3 dhe -3.3, dhe kampioni të pastrohet nga këto vlera të cilat konsiderohen si të veçanta.

Pas transformimit dhe llogaritjes së Z statistikor, janë vërejtur 5 raste të veçanta të cilat janë përjashtuar nga kampioni duke e reduktuar atë në 200 firmë - vit vrojtime dhe sërish është vërejtur normaliteti i shpërndarjes. Tabela e mëposhtme jep statistikën përshkuese të variabëlilit LnAbsRJN (logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale)

**Tabela 4.7. Statistika përshkuese për variabëlin logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale pas transformimit**

	Statistika	Gabimi standard
Mesatare	-2,278	,09217
Mediana	-2,341	
Varianca	1,699	
Devijimi standard	1,3034	
Minimum	-6,770	
Maksimum	2,690	
Asimetria	,113	,172
Koeficienti Kurtosis	2,293	,342
Testet e normalitetit	Statistika	Sig.
Shapiro-Wilk	,959	,000
Kolmogorov-Smirnov	,101	,000

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Në rezultatet e mësipërme vërejmë se shpërndarja e vlerave të variabëlilit paraqitet thuajse normale. Skewness dhe Kurtosis janë reduktuar përkatësisht në 0,113 dhe 2,293. Gjithashtu, vlerat e testeve të normalitetit tregojnë se ka shumë të ngjarë që kampioni të rrjedhë nga shpërndarja normale.

Duke u mbështetur në studimet e mëparshme kemi pranuar faktin se rrjedhjet jonormale janë një matës i mirë i menaxhimit të fitimeve, atëherë gjithashtu pranojmë se menaxhimi i fitimeve është një fenomen i dukshëm në kampionin e marrë në

studim. Në këtë mënyrë i jepet përgjigje pyetjes së parë kërkimore në lidhje me ekzistencën e fenomenit të menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar.

#### 4.2.2 Madhësia e shoqërisë audituese

***Pyetja e dytë kërkimore:*** A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë, ku në procesin e auditimit përfshihen auditues Big4 dhe në ato ku përfshihen auditues jo Big4, në kontekstin shqiptar?

*Vërtetimi i hipotezës H 1-* Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve, në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar)

Për të investiguar nëse ka ndryshime në menaxhimin e fitimeve referuar ndikimit që ka procesi i auditimit të pasqyrave financiare të shoqërive i kryer përkatësisht nga shoqëri Big4 dhe jo Big4 të auditimit, u përdor teknika Welch ANOVA. Kjo teknikë është efikase në rastet kur përqindja e pjesëmarrësve të kampionit nuk është e njëjtë. Rëndësia e testit Fisher, bazuar në gabimin e llojit të parë  $\alpha = 0.05$  përcakton nëse është i rëndësishëm ose jo ndryshimi në menaxhimin e fitimeve ndërmjet shoqërive të audituara nga një Big4 dhe të shoqërive të audituara nga një jo Big4. Ndërkohë, për të identifikuar normalitetin e shpërndarjes së vlerave të menaxhimit të fitimeve, i shprehur nga logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale u kontrollua fillimisht për vlerat e asimetrisë në shpërndarje dhe vlerat e koeficientit Kurtosis. Gjithashtu, u konfirmua dhe homogjeniteti i variancave nëpërmjet testeve përkatës.

##### ➤ Normaliteti i shpërndarjes

Tabela 4.8 paraqet të dhëna përshkruese në lidhje me mesataren, devijimin standard, asimetrinë dhe koeficientin Kurtosis për vlerat e Logaritmit Natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN), sipas kategorive përkatëse. Asimetria e vlerave për shoqëritë e audituara nga Big4 ( $A = 0.563$ ) dhe për shoqëritë e audituara nga jo Big4 ( $A = 0.98$ ) është afër zeros. Gjithashtu, edhe koeficienti Kurtosis për shoqëritë e audituara përkatësisht nga Big4 dhe jo Big4 është  $Q = 0.564$  dhe  $Q = 2.311$ . Meqenëse, vlerat e Asimetrisë dhe Kurtosis janë afër zeros, shpërndarja paraqitet pothuajse normale.

**Tabela 4.8. Të dhëna përshkruese për vlerat e logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN) sipas kategorive Big4 dhe Jo Big4**

	Big4		Jo Big4	
	Statistika	Gabimi standard	Statistika	Gabimi standard
Mesatarja	-2,2004	,23855	-2,2862	,09909
Mediana	-2,2456		-2,3469	
Varianca	1,138		1,767	
Devijimi standard	1,06683		1,32944	
Minimum	-4,12		-6,77	
Maksimum	,09		2,69	
Asimetria	,563	,512	,098	,181
Koefiçienti Kurtosis	,564	,992	2,311	,360

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

➤ **Homogjeniteti i variancave**

Homogjeniteti i variancave është testuar nëpërmjet testit Levene's, treguar në tabelën 4.9. Nëse vërejmë vlerat e rëndësisë për këtë test (Sig Levene=0.455) ajo është me madhe se 0.05 që do të thotë se supozimi mbi homogjenitetin e variancave nuk është shkelur. Për të siguruar këtë rezultat janë kryer dhe testet Robust Welsh dhe Brown-Forsythe (Tabela 4.10). Statistikat e testeve dhe rëndësia e tyre konfirmojnë rezultatin e më sipërm.

**Tabela 4.9. Testi i homogjenitetit të variancës**

Statistika Levene	df1	df2	Sig.
,561	1	198	,455

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

**Tabela 4.10. Testet Robust, Welsh dhe Brown-Forsythe**

	Statistika	df1	df2	Sig.
Welch	,110	1	26,040	,742
Brown-Forsythe	,110	1	26,040	,742

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

➤ **Analiza Anova**

Pas konfirmimit të normalitetit të shpërndarjes dhe homogjenitetit të variancave mund t'i referohemi analizës së variancës për të investiguar nëse ekziston ndonjë ndryshim në menaxhimin e fitimeve nëse shoqëritë auditohen ose jo nga shoqëri Big4. Nga statistikat, në tabelën e mëposhtme vërehet se vlera e testit Fisher është e ulët  $F(1,198)=0.078$  dhe rëndësia statistikore e tij është konsiderueshëm më e madhe se 0.05, që do të thotë se rezultatet tregojnë se nuk ka ndryshime të rëndësishme statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95%, në lidhje me menaxhimin e fitimeve, nëse krahasohen shoqëri të audituara nga Big4 dhe shoqëri të audituara nga joBig4.

**Tabela 4.11. Welch ANOVA**

	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	,132	1	,132	,078	,781
Në grupe	337,990	198	1,707		
Totali	338,122	199			

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Ndërkohë, testi Eta Squared llogaritet për të konfirmuar rezultatin e mësipërm. Ky test është i barabartë me  $0.00039^{13}$ . Sipas Cohen's (1988, pp.284-7), vlerat e raportit Eta Squared, për të matur madhësinë e efektit mbi variabëlin e varur, më të vogla se 0.01 tregojnë për efekt të vogël të madhësisë së audituesit mbi fenomenin e menaxhimit të fitimeve (thujse të papërfillshëm). Pra, rezultatet tregojnë se shoqëritë Big4 dhe jo-Big4 të auditimit sillen pothuajse njësoj në lidhje me sigurimin e cilësisë së auditimit të pasqyrave financiare të shoqërive. Në këtë mënyrë hipoteza H1 e parashtruar nuk vërtetohet. Pohimi se: Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve, në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar, rrëzohet.

Nga analiza e mësipërme rezulton se nuk ka lidhje të rëndësishme midis cilësisë së auditimit e përfaqësuar nga madhësia e audituesit ( Big4 dhe joBig4) dhe menaxhimit të fitimeve. Testuar nëpërmjet analizës së variancës Welsh Anova, ku  $F=0,078$ ,  $Sig(F)= 0,781$ . Hipoteza H1 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të besueshmërisë.

Pohimi i riformuluar është:

“Nuk ka ndryshime të rëndësishëm në menaxhimin e fitimeve midis shoqërive që auditohen nga shoqëri Big4 dhe JoBig4 të auditimit”.

### **4.2.3 Efekti i përmasave të shoqërisë në praktikat e menaxhimit të fitimeve**

***Pyetja e tretë kërkimore:*** A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikat e menaxhimit të fitimeve kur krahasojmë shoqëritë e mëdha dhe të vogla në tregun shqiptar?

*Vërtetimi i hipotezave H2 -H3*

H2 – Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve

H3 – Ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve

Për të hetuar nëse madhësia e aktivitetit dhe ndryshimi në përqindje të shitjeve, ka ndikim mbi menaxhimin e fitimeve u përdor teknika Two Way Between Groups ANOVA.

<sup>13</sup> Eta Squared= Sum of squares between groups/total sum of squares =  $0.132/338.122=0.00039$

Kjo teknikë është efi­kase në rastet kur përqindja e pjesëmarrësve të kampio­nit nuk është e njëjtë dhe kur variabëli i varur është i vazhduar dhe variablat e pavarur janë fik­so­re apo kategori­k me dy ose më shumë kategori. Rëndësia e testit Fisher, bazuar në gabimin e llojit të parë,  $\alpha = 0.05$  përcakton nëse është i rëndësishëm ose jo ndryshimi i variabëlve të pavarur të variabëli i varur. Ndërkohë, për të identifikuar normalitetin e shpërndarjes së vlerave të menaxhimit të fitimeve, i shprehur nga logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale u kontrollua fillimisht për vlerat e asimetrisë në shpërndarje dhe vlerat e koeficientit Kurtosis. Gjithashtu, u konfirmua dhe homogjeniteti i variancave nëpërmjet testit Levene's.

### ➤ Kategorizimi i variablave

Për të kategorizuar shoqëritë në të mëdha dhe të vogla është përdorur vlera mesatare e logaritmit natyror të aktiveve të shoqërive, e cila rezulton 12.209. Shoqëritë kategorizohen si të mëdha, nëse vlera e këtij variabëli qëndron mbi mesataren dhe marrin vlerën 1. Ndërsa, me vlerën 0 identifikohen shoqëritë e vogla, me vlera të variabëlve më të vogla ose të barabarta me mesataren.

Gjithashtu, për variabëlën Shitje, i cili shpreh ndryshimin në përqindje të të ardhurave nga shitja është bërë grupimi i të dhënave sipas përkatësisë në industri dhe është llogaritur mesatarja e variablave për çdo grupim. Shoqëria është konsideruar të ketë rritje të madhe të shitjeve, nëse treguesi individual i ndryshimit në përqindje të shitjeve është më i madh se mesatarja e industrisë dhe merr vlerën (1) dhe me rritje të vogël të shitjeve, nëse ky tregues është më i vogël ose i barabartë me mesataren e industrisë duke marrë vlerën (0).

Tabela e mëposhtme jep të dhëna në lidhje me kategorizimin e shoqërive në të mëdha dhe të vogla si dhe shoqëri me rritje të madhe dhe të vogël të shitjeve, e ndarë gjithashtu, sipas klasifikimit industrial për çdo aktivitet ekonomik.

**Tabela 4.12. Kategorizimi i shoqërive sipas madhësisë**

Nr	Seksioni	Klasifikimi Industrial sipas NVE 1.1	Shoqëri Gjithsej	Madhësia e shoqërisë		Rritja mesatare e shitjeve ne% sipas industrisë në	Rritja e shitjeve ne %	
				E madhe	e vogël		e madhe	e vogël

## Cilësia e Auditimit dhe Menaxhimi i Fitimeve: Rasti i Shqipërisë

1	C	Industri nxjerrëse	1	1	0	-83,51	0	1
2	D	Industri përpunuese	41	30	11	21,096	13	28
3	E	Prodhim, shpërndarje energji, ujë, gaz.	15	12	3	10,69	6	9
4	F	Ndërtim	22	11	11	51,93	11	11
5	G	Tregti	48	13	35	74,81	13	35
6	H	Hotel, restorant, kafe	6	3	3	-2,37	4	2
7	I	Transport, magazinim , komunikacion	23	13	10	29,57	3	20
8	K	Real estate, shërbime të tjera për ndërmarrjet	24	3	21	30,91	9	15
9	M	Arsimi	4	0	4	97,68	2	2
10	N	Shëndetësia	10	0	10	83,85	3	7
11	P	Administrim publik	6	6	0	15,74	2	4
<b>TOTALI në numër</b>			<b>200</b>	<b>92</b>	<b>108</b>		<b>66</b>	<b>134</b>
<b>TOTALI në %</b>			<b>100%</b>	<b>46%</b>	<b>54%</b>		<b>33%</b>	<b>67%</b>

*Burimi: Sipas përlllogaritjeve të autorit për kategorizimin e kampionit të vlefshëm në studim*

Në kampionin e përbërë nga 200 firmë – vit vrojtme rezultoi se 92 raste ose 46% e rasteve u kategorizuan si shoqëri të mëdha dhe 108 raste ose 54% të rasteve u kategorizuan si shoqëri të vogla. Gjithashtu, 66 raste ose 33% rezultuan të kishin ritëm të rritjes së shitjeve më të lartë se mesatarja e industrisë përkatëse dhe 134 raste ose 67% rezultuan se kishin rritje të shitjeve më të vogël ose të barabartë me mesataren e industrisë përkatëse. Tabela e mëposhtme paraqet disa nga statistikat përshkruese sipas grupimeve të marra në analizë ku variabëli i varur që shpreh menaxhimin e fitimeve është logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale.

**Tabela 4.13. Statistika përshkruese**

Variabëli i varur: Ln Abs RJN

Madhësia e shoqërisë	rritje e shitjeve e madhe /e vogël	Mesatare	Devijimi standard	N
shoqëri e vogël	rritje e vogël e shitjeve	-2,4351	1,17550	74
	rritje e madhe e shitjeve	-1,4959	1,64669	34
	Total	-2,1394	1,40395	108
shoqëri e madhe	rritje e vogël e shitjeve	-2,5407	1,07213	60
	rritje e madhe e shitjeve	-2,2506	1,30954	32
	Total	-2,4398	1,16136	92
Total	rritje e vogël e shitjeve	-2,4824	1,12744	134
	rritje e madhe e shitjeve	-1,8618	1,52936	66
	Total	-2,2776	1,30350	200

Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21

➤ **Normaliteti i shpërndarjes**

Përpara se të kalojmë në paraqitjen e rezultateve të analizës Two Way Anova vërehet normaliteti i shpërndarjes së të dhënave. Tabela 4.14 paraqet të dhëna në lidhje me, asimetrinë dhe koeficientin Kurtosis sipas kategorive të ndryshimit në madhësi dhe ndryshimit në ritmin e rritjes së shitjeve të shoqërive për 200 firmë - vit vrojttimeve. Asimetria e vlerave për shoqëritë e mëdha ( $A = -0,062$ ) dhe për shoqëritë e vogla ( $A = 0,104$ ) është në intervalin  $\pm 1$ . Vlera e asimetrisë paraqitet në po këtë interval edhe për faktorin “rritje e shitjeve”, përkatësisht ( $A = -0,028$ ) për shoqëritë më rritje të madhe të shitjeve dhe ( $A = 0,181$ ) për shoqëritë me rritje të vogël të shitjeve. Për sa i përket koeficientëve Kurtosis vlerat shfaqen disi shqetësuese. Në të gjitha rastet ato janë më të mëdha se 1. Pra, shpërndarja për të dy grupimet nuk shfaqet tërësisht normale, megjithatë ky problem është i rëndësishëm për tu konsideruar në kampionet e vogla me  $n < 50$ . Në kampionet e mëdha këto vlera nuk përbëjnë problem të rëndësishëm.

**Tabela 4.14. Vlerat e asimetrisë dhe koeficientit Kurtosis sipas faktorëve të madhësisë dhe ndryshimit të shitjeve të shoqërive për 200 firmë-vit vrojtime.**

	N	Asimetria	Koeficienti Kurtosis
Shoqëri të mëdha	92	-,062	1,129
Shoqëri të vogla	108	,104	2,651
Rritje e madhe e shitjeve	66	-,028	2,246
Rritje e vogël e shitjeve	134	-,181	1,842

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

➤ **Homogjeniteti i variancave**

Homogjeniteti i variancave është testuar nëpërmjet testit Levene’s, treguar në tabelën 4.15. Nëse vërejmë vlerat e rëndësishme statistikore për këtë test (Sig Levene = 0.091) ajo është me e madhe se 0.05 që do të thotë se supozimi mbi homogjenitetin e variancave nuk është shkelur.

**Tabela 4.15. Testi Levene’s, mbi barazinë e gabimit të variancave të variabëlilit të varur**

F	df1	df2	Sig.
2,183	3	196	0,091

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Teston hipotezën 0 – Gabimi i variancave të variabëlilit të varur është i barabartë për grupimet.

a. Modeli: Intercepti + Madhësia e shoqërisë + Ritje e Shitjeve + Madhësia e shoqërisë \* Ritje e Shitjeve

➤ **Rezultatet të analizës Two Way Anova**

Tabela 4.16 Paraqet efektin ndërmjet grupeve sipas analizës Two Way Anova mbi menaxhimin e fitimeve. Vërehet se ndryshimi i shoqërive për nga madhësia ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në nivelin e besueshmërisë 95% mbi menaxhimin e fitimeve ( $F(1,196)=5.129, p < .05$ ) dhe hipoteza H2-“Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve” vërtetohet .

Nga krahasimi i vlerave të mesatares së logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale, përkatësisht për shoqëritë e mëdha dhe të vogla vërejmë se shoqëritë e mëdha janë përfshirë më pak në menaxhimin e fitimeve sesa shoqëritë e vogla. Nga llogaritja e testi Eta Squared i cili rezulton të jete i barabartë me 0.026. Siapas Cohen’s (1988.pp.284-7), kjo vlerë tregon për një ndikim me efekt mesatar të madhësisë së shoqërisë mbi menaxhimin e fitimeve. Për sa i përket ndryshimit të shitjeve dhe efektit mbi menaxhimin e fitimeve të dhënat tregojnë ( $F(1,196)=10.475, p < 0.05$ ) se ky efekt është i rëndësishëm statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95%. Në këtë mënyrë arrijmë në përfundimin se, pohimi “ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve” qëndron, pra hipoteza H3 vërtetohet.

Nëse krahasojmë vlerat mesatare të variabël të varur midis kategorive, “rrije e madhe shitjeve” dhe “rrije e vogël e shitjeve”, vëmë re se shoqëritë që kanë rezultuar me rritje më të vogël të shitjeve kanë menaxhuar më shumë fitimet. Ndërsa i parëndësishëm statistikisht paraqitet efekti i bashkëveprimit të dy faktorëve (variablave të pavarur) mbi menaxhimin e fitimeve përdërisa  $F(1,167)=2.92, p = 0.05$ .

**Tabela 4.16. Efekti ndërmjet grupeve sipas analizës Two Way Anova**

Variabël i varur: Ln Abs RJN

	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.	Partial Eta Squared
Modeli i korigjuar	26,791	3	8,930	5,622	,001	,079
Intercepti	837,478	1	837,478	527,237	,000	,729
madhësia	8,147	1	8,147	5,129	,025	,026
Rritje Shitje	16,638	1	16,638	10,475	,001	,051
madhësia * Ritje Shitje	4,638	1	4,638	2,920	,089	,015
Gabimi	311,332	196	1,588			
Total	1375,614	200				
Total i korigjuar	338,122	199				

Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21

#### 4.2.4 Menaxhimi i fitimeve - sektori publik kundrejt atij privat

**Pyetja e katërt kërkimore:** A ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që i përkasin sektorit publik dhe atij privat në Shqipëri?

*Vërtetimi i hipotezës H4-* Përkatësia në sektorin publik apo privat të shoqërive në tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.

Për të hetuar nëse ka ndryshime në menaxhimin e fitimeve referuar ndikimin që ka përkatësia e shoqërive në sektorin publik dhe privat, u përdor teknika Welch ANOVA. Kjo teknikë është efikase në rastet kur përqindja e pjesëmarrësve të kampionit nuk është e njëjtë. Rëndësia e testit Fisher, bazuar në gabimin e llojit të parë  $\alpha = 0.05$ , përcakton nëse është i rëndësishëm ose jo ndryshimi në menaxhimin e fitimeve

referuar ndryshimit në përkatësi të shoqërive në sektorin publik e privat. Për të identifikuar normalitetin e shpërndarjes së vlerave të menaxhimit të fitimeve i shprehur nga logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale, u kontrollua

fillimisht për vlerat e asimetrisë në shpërndarje dhe vlerat e koeficientit Kurtosis. Gjithashtu, u konfirmua dhe homogjeniteti i variancave nëpërmjet testeve përkatës.

### Normaliteti i shpërndarjes

**Tabela 4.17. Të dhëna përshkruese për vlerat e Logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN) sipas kategorive: a) pronësi private dhe b) pronësi shtetërore**

	Pronësi Private		Pronësi Shtetërore	
	Statistika	Gabimi standard	Statistika	Gabimi standard
Mesatare	-2,1783	,10353	-2,7625	,17635
Mediana	-2,2870		-2,7484	
Varianca	1,779		1,057	
Devijimi standard	1,33393		1,02828	
Minimum	-6,77		-5,15	
Maksimum	2,69		-,52	
Asimetria	,091	,188	-,558	,403
Koeficienti Kurtosis	2,346	,375	1,140	,788

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Tabela 4.17 paraqet të dhëna përshkruese në lidhje me mesataren, devijimin standard, asimetrinë dhe koeficientin Kurtosis për vlerat e Logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale (Ln Abs RJN), sipas kategorive përkatëse. Asimetria e vlerave për shoqëritë në përkatësi të sektorit privat ( $A = 0.091$ ) dhe për shoqëritë në përkatësi të sektorit publik ( $A = -0,558$ ) është afër zeros. Ndërsa, koeficienti kurtosis për shoqëritë përkatësisht private dhe publike është  $Q = 2.346$  dhe  $Q=1.140$ . Kështu vlerat e asimetrisë janë afër vlerës 0, ndërsa koeficienti kurtoziz paraqitet më i madh sesa 1. Kjo situatë do të përbente problem nëse kampioni do të ishte i vogël (për  $n < 50$ ). Në kampionet e mëdha dhe në rastin tonë  $n=200$ , ky problem është i kapërcyeshëm. Kështu shpërndarja paraqitet pothuajse normale dhe rezultatet e analizës do të merren në konsideratë.

### Homogjeniteti i variancave

Homogjeniteti i variancave është testuar nëpërmjet testit Levene's, treguar në tabelën 4.18. Nëse vërejmë vlerën e rëndësisë për këtë test (Sig (Levene)=0.201) ajo është me e madhe se 0.05, që do të thotë se supozimi mbi homogjenitetin e variancave nuk është shkelur. Për të siguruar këtë rezultat janë kryer dhe testet Robust Welch dhe Brown-Forsythe (Tabela 4.19). Statistikat e testeve dhe rëndësia e tyre konfirmojnë rezultatin e mësipërm.

**Tabela 4.18. Testi i homogjenitetit të variancës**

Statistika Levene	df1	df2	Sig.
1,648	1	198	,201

**Tabela 4.19. Testet Robust Welch dhe Brown-Forsythe**

	Statistika	df1	df2	Sig.
Welch	8,163	1	58,285	,006
Brown-Forsythe	8,163	1	58,285	,006

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

### Anova

Pas konfirmimit të normalitetit të shpërndarjes dhe homogjenitetit të variancave mund t'i referohemi analizës së variancës, për të investiguar nëse ekziston ndonjë ndryshim në menaxhimin e fitimeve nëse shoqëritë i p-përkasin sektori publik apo atij privat. Nga statistikatat në tabelën e mëposhtme vërehet se vlera e testit Fisher është  $F(1,198) = 5,806$  dhe rëndësia statistikore e tij është më e vogël se 0.05. Kjo do të thotë se rezultatet tregojnë për ndryshime të rëndësishme statistikisht në nivelin e besueshmërisë 95%, në lidhje me menaxhimin e fitimeve nëse krahasohen shoqëritë private me ato publike.

**Tabela 4.20 Welsh ANOVA**

	Shuma e katrorëve	df	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	9,633	1	9,633	5,806	,017
Në Groupe	328,489	198	1,659		
Total	338,122	199			

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Ndërkohë testi Eta Squared llogaritet për të konfirmuar rezultatin e mësipërm. Ky test është i barabartë me  $0.02849^{14}$ . Sipas Cohen's (1988, pp.284-7), vlerat e raportit Eta Squared për të matur madhësinë e efektit mbi variabëlin e varur, në intervalin 0.01-0.06 tregojnë për efekt mesatar të përkatësisë së shoqërisë në sektorin publik e privat mbi fenomenin e menaxhimit të fitimeve. Pra, edhe testi Eta Squared konfirmon rezultatin e rrjedhur nga analiza Anova. Nëse vërejmë mesataret e LnAbs RJN në tabelën përmbledhëse të të dhënave përshkruese, tregohet se për shoqëritë publike kjo vlerë është më e madhe. Kjo do të thotë se shoqëritë publike angazhohen më shumë në praktikën e menaxhimit të fitimeve në krahasim me shoqëritë private. Në këtë mënyrë pohimi se: “Përkatësia në sektorin publik/privat të shoqërive më tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve”, vërtetohet.

#### 4.2.5 Analiza shumëvariabëlshe

**Pyetja e pestë kërkimore:** Cilët janë faktorët e tjerë që duhen konsideruar si indikatorë, për të kontrolluar menaxhimin e fitimeve dhe cili është ndikimi i tyre në kontekstin shqiptar?

*Vërtetimi i hipotezave:*

H1: Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve, në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar. (Konfirmimi i hipotezës H1 nëpërmjet analizës shumë variabëlshe).

H2: Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H2 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshe).

<sup>14</sup> Eta Squared = Sum of squares between groups/total sum of squares =  $=9.633/338.122 = 0.02849$

- H3: Ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H3 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshe).
- H4: Përkatësia në sektorin publik/privat të shoqërive më tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. (Konfirmim i hipotezës H4 nëpërmjet analizës shumëvariabëlshe)
- H5: Moshë e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H6: Pronësia menaxheriale ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H7: Kompleksiteti ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H8: Leva financiare ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
- H9: Shoqëritë me rezultat negativ rezultojnë me nivele më të larta të menaxhimit të fitimit
- H10: Shoqëritë me ROA më të larta rezultojnë me nivele më të ulëta të menaxhimit të fitimit
- H11: Kapital i huaj ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve

Për vërtetimin e hipotezave të mësipërme u përdor regresioni i shumëfishtë linear (Metoda e Katroreve më të Vegjël). Modeli u vlerësua në lidhje me supozimet bazë mbi të cilat mbështetet përdorimi i kësaj metode, (mesatarja e mbetjeve është e barabartë me zero, heteroskedasticiteti nuk është i pranishëm, autokorrelacioni nuk është i pranishëm, shpërndarja e mbetjeve është normale, multikolineariteti nuk është i pranishëm) . Rëndësia e modelit u vlerësua nëpërmjet analizës së variancës dhe kriterit Fisher duke konkluduar në lidhje me rëndësinë statistikore të koeficientëve të pjesëshëm të regresionit. Nëpërmjet programit SPSS 21, për vlerësimin e regresionit dhe konfirmimin e rezultateve u përdor metoda standarde (enter) e cila konsideron të gjithë variablat në të njëjtën kohë. Gjithashtu, për të konfirmuar rezultatet e më sipërme u përdor dhe metoda Stepwise e cila konsideron variablat statistikisht të rëndësishëm një nga një dhe eliminon variablat jo të rëndësishëm statistikisht.

### ➤ Vlerat ekstreme

Regresioni i shumëfishtë është shumë i ndryshëm ndaj vlerave ekstreme, të cilat janë kombinim unik i karakteristikave të identifikueshme si të ndryshme nga vëzhgimet e tjera. Këto vlera ekstreme mund të shtrembërojnë rezultatet dhe për rrjedhojë dhe interpretimin e tyre. Për pastrimin e kampionit nga vlerat ekstreme fillimisht janë

vëzhguar ato raste që paraqiten me vlera më të mëdha sesa (3.3) ose më të vogla sesa (-3,3) devijime standarde nga mesatarja dhe më pas është llogaritur distanca Cook's dhe është krahasuar me vlerën kritike të saj e cila rezulton të jetë 0.022<sup>15</sup>. kampioni është pastruar nga vlerat me z statistikor më të madhe se +3.3 ose më të vogla se -3.3 dhe me vlera më të mëdha se vlera kritike të distancës Cook's. Pas këtij veprimi kampioni reduktohet në 176 firmë - vit vrojtme.

### ➤ **Madhësia e kampionit**

Madhësia e kampionit është e rëndësishme për të arritur në rezultate përgjithësuese. Formula që rekomandojnë Tabachnick dhe Fidell (2007, fq.123) në lidhje me numrin e rasteve në kampion, i përdorur gjerësisht në studimet në shkencat shoqërore është  $N > 50 + 8m$  ku:

$N$  = madhësia e kampionit

$m$  = numri i variabëlve të pavarur të konsideruar në regresion.

Në regresionin e konsideruar numri i variabëlave të pavarur është 11, kështu kampioni duhet të jetë më i madh se 138<sup>16</sup> raste. Në rastin tonë kampioni përbëhet nga 176 firmë - vit vrojtme dhe arrijmë në përfundimin se ai është i përshtatshëm për këtë studim.

### ➤ **Vlerësimi i normalitetit**

Normaliteti i shpërndarjes së të dhënave konsiderohet një çështje kritike kur përdoret metoda OLS. Nëse të dhënat nuk paraqiten normale atëherë mundet që interpretimet të mos jenë të vlefshme dhe të besueshme. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat përshkruese për të gjithë variablat që përbëjnë regresionin. Normaliteti i shpërndarjes është kontrolluar si për variabëlin e varur (Ln Abs RJN) ashtu dhe për variablat e pavarur, të cilat marrin vlera të vazhduara numerike në regresion (Ln Aktive, Ln Moshë, LnLF, Ln ROA dhe Ln Shitje). Ndërsa, për variablat dikotomik (Drejtuës/Pronar, Kompleksiteti, Kapitali i Huaj dhe Gov), të cilët marrin vlera 1 dhe 0 kjo statistikë nuk është marrë në konsideratë. Për secilin prej tyre është vërejtur

<sup>15</sup> Vlera kritike e distancës Cook 's =  $4/(n-k-1) = 1/(200-11-1) = 0.022$

<sup>16</sup>  $N > 50 + 8m \Rightarrow N > 50 + 8 * 11 \Rightarrow N > 138$ .

koefiçienti Skewness dhe Kurtosis. Për vlera të këtyre statistikave sa më afër zeros është konkluduar mbi normalitetin e shpërndarjes së të dhënave.


**Tabela 4.21: Statistikat përshkruese për të gjithë variablat (të varur dhe të pavarur) e konsideruar në regresion.**

	N	Min.	Max.	Mesatare	Devijimi standard	Asimetria		Koeffiçienti Kurtosis	
						Statistika	Gabimi standard	Statistika	Gabimi standard
Ln Abs RJN	176	-5,15	,37	-2,2588	1,00354	-,069	,183	,800	,364
Auditues i,t	176	0	1	,10	,304	2,648	,183	5,068	,364
Ln Aktive i,t	176	7,6069	17,3092	12,343678	1,9889539	,209	,183	-,284	,364
Ln Mosha i,t	176	,0000	3,8501	2,080186	,8045017	-,809	,183	-,018	,364
Drejtues/Pronar	176	0	1	,56	,498	-,231	,183	-1,969	,364
Kompleksiteti i	176	0	1	,32	,467	,787	,183	-1,396	,364
LnLeva Financiare	176	-3,51	2,02	-,6040	,86812	-,947	,183	1,936	,364
Humbje	176	0	1	,22	,413	1,393	,183	-,061	,364
Ln Shitje	176	7,30	16,24	11,5911	1,83857	,169	,183	-,075	,364
Ln ROA	176	-7,99	-,42	-3,6649	1,50705	-,589	,183	,639	,364
Kapitali i Huaj	176	0	1	,34	,475	,677	,183	-1,559	,364
Gov	176	0	1	,19	,391	1,615	,183	,615	,364
N	176								

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Asimetria e vlerave dhe koeffiçienti Kurtosis për të variablat e vazhduar (Ln Abs RJN Ln Aktive, Ln Mosha, LnLF, LnROA, LnShitje) demonstrohen të jenë në nivele të pranueshme që tregojnë se variablat paraqiten me shpërndarje normale dhe supozimi në lidhje me normalitetin nuk konsiderohet i shkelur. Për sa i përket variabël të varur Ln Abs RJN, i cili përfaqëson fenomenin e menaxhimit të fitimeve, vlerat e

Asimetrisë dhe koeficienti Kurtosis paraqiten afër vlerës zero (përkatësisht  $A = -0,069$  dhe  $Q = 0,800$ ), duke konfirmuar edhe një herë shpërndarjen normale të këtij variabëli. Grafiku 4.2 paraqet histogramën e vlerave të Logaritmit Natyror të Vlerës Absolute të Rrjedhjeve Jonormale. Nga inspektimi pamor i lakores së shpërndarjes së vlerave vihet re se shpërndarja e këtij variabëli paraqitet normale.



**Grafiku 4.2** Histograma e shpërndarjes së vlerave të Logaritmit natyror të vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale

➤ **Vlerësimi i homoskedasticitetit**

Supozimi mbi homoskedasticitetin kushtëzon interpretimet mbi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e modelit të trajtës OLS si dhe interpretimin e koeficientëve të pjesshëm të regresionit. Nëse ky supozim konsiderohet i shkelur, atëherë rezultatet e përftuara nga analiza nuk janë të besueshme. Testi White është realizuar nëpërmjet programit Gratel, pasi SPSS 21 nuk e mundëson llogaritjen e këtij parametri për vlerësimin e homoskedasticitetit. Tabela e mëposhtme demonstroi statistikat e testit White. Të plotat statistikat e testit White paraqiten në aneks B.

**Tabela 4.22: Testi White mbi heteroskedasticitetin**

LM = 63,424181
P( Chi square (69) >63,424181= 0,666725

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor GRETL mbi heteroskedasticitetin*

White test tregon se heteroskedaciteti nuk është i pranishëm përderisa (p Chi square(69) > 63,424181 = 0,666725) ku p është më e madhe se 0.05, për nivelin e besueshmërisë 95%. Pra konkludohet se supozimi mbi homoskedasticitetin nuk është shkelur.

➤ **Vlerësimi i autokorrelacionit**

Autokorrelacioni është vartësia reciproke e termave të së njëjtës seri dinamike që paraqet një dukuri ekonomike në kohë. Në thelb ai përbën një shkelje të supozimeve bazë të modeleve të trajtës OLS, pikërisht supozimit sipas së cilit kovarianca midis termave të mbetjeve të çdo dy vrojtimeve është zero. Si metodë e zbulimit të autokorrelacionit është përdorur testi Durbin–Watson. Sipas përlllogaritjeve (shih tabela 4.25), vlera e testit Durbin–Watson rezultoi e barabartë me 2.21. Kjo vlerë është brenda intervalit të lejueshëm (1.5-2.5) dhe tregon se në model autokorrelacioni nuk është i pranishëm.

➤ **Vlerësimi i multikolinearitetit**

Multikolineariteti ekziston kur variablat e pavarur janë të kolinearuar midis tyre. Për të verifikuar nëse ekziston multikolinearitet midis variablave të pavarur është konsideruar statistika VIF dhe toleranca. Toleranca > 0.1 ose VIF < 10 tregojnë se modeli nuk ka probleme të multikolinearitetit. Tabela 4.23 paraqet këto statistika.

**Tabela 4.23: Statistikat VIF dh Tolerancat për kontrollin e multikolinearitetit të variabëlve të pavarur në model**

Variablat e pavarur	Toleranca	VIF
(Konstante)		
Auditues i,t	,677	1,478
Ln Aktive i,t	,247	4,042
Ln Mosha i,t	,646	1,548
Drejtues/Pronar	,903	1,107
Kompleksiteti i	,489	2,043
LnLF	,794	1,260

Humbje	,863	1,158
LnShitje	,313	3,193
LnROA	,596	1,677
Kapitali i Huaj	,657	1,523
Gov	,507	1,971

Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21

Të dhënat tregojnë se statistika VIF për të gjithë variablat është më e vogël se 10 dhe toleranca është më e madhe se 0.1. Në këtë mënyrë konkludohet se supozimi mbi multikolinearitetin nuk është shkelur. Në po të njëjtin rezultat arrihet edhe nëse vëzhgojmë matricën e korrelacionit. Në tabelën 4.24 paraqitet informacion në lidhje me koeficientët e korrelacionit për variablat e pavarur. Të gjithë koeficientët e korrelacionit janë më pak se 0.7. Koeficientët e ulët të korrelacionit tregojnë se multikolineariteti nuk përbën problem në analizë.

**Tabela 4.24. Matrica e korrelacioni Pearson për variablat e pavarur**

	Ln Abs RJN	Auditues	Ln Aktive	Ln Mosha	Drejtimes/Pronar	Humbje	Kompleksiteti	Kapitali i Huaj	Gov	LnLF	LnROA	LnShitje
Ln Abs RJN	1											
Auditues	,013	1										
Ln Aktive	-,35	,346	1									
Ln Mosha	-,30	,105	,451	1								
Drejtimes/Pronar	-,03	-,08	,033	,136	1							
Humbje	,008	,051	,021	-,12	-,03	1						
Kompleksiteti	-,02	,494	,377	,182	,094	-,06	1					
Kapitali i Huaj	,092	,311	,117	,002	,014	,147	,461	1				
Gov	-,23	-,11	,426	,312	,077	,066	-,27	-,35	1			
LnLF	,092	,038	-,01	-,32	-,08	,114	,020	,057	-,1	1		
LnROA	,361	,099	-,38	-,25	-,08	-,02	,083	,167	-,37	-,18	1	
LnShitje	,133	,429	,672	,300	-,10	-,13	,544	,352	-,00	-,01	,063	1

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

➤ **Analiza e korrelacionit**

Për të matur fuqinë e varësisë së variabëlilit të varur (logaritmi natyror i vlerës absolute të rrjedhjeve jonormale), si përfaqësues i menaxhimit të fitimeve dhe variablave të pavarur të përfshirë në model konsiderohet koeficienti i korrelacionit  $R^2$ , i korrigjuar me shkallët e lirisë. Sipas statistikave të paraqitura në tabelën përmbledhëse të modelit vihet re se 42.4% e variacionit të variabëlilit të varur shpjegohet nga variablat e pavarur. Mbetja prej 57.6% iu përket faktorëve të tjerë (përfshirë dhe ata të rastësishëm) që nuk janë përfshirë në model. Megjithatë, duhet theksuar se koeficienti i korrelacionit nuk përbën të vetmin tregues statistikor për të gjykuar mbi cilësinë e ekuacionit të regresionit, për më tepër që qëllimi i këtij ekuacioni nuk është parashikimi i saktë i variabëlilit të varur nga variablat e pavarur, por identifikimi i lidhjes midis tyre. Në këtë kontekst statistika  $R^2$  (e rregulluar me shkallët e lirisë) prej 42.4%, konsiderohet një tregues i mirë . Për më shumë testimi i rëndësisë së modelit nëpërmjet testit Fisher në nivelin 95% të besueshmërisë si dhe rëndësia e koeficientëve të pjesshëm të regresionit janë paraqitur në vijim.

**Tabela 4.25. Të dhëna përmbledhëse të modelit**

Model	R	$R^2$	$R^2$ e rregulluar	Gabimi standard i parashikimit	Durbin-Watson
OLS	,678 <sup>a</sup>	,460	,424	,76162	2,218

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

a. Parashikuesit në model: (konstante), LnShitje, Gov, LnLF, Drejtues/Pronar, Humbje, LnROA, Auditues i,t, Kapitali i Huaj, Ln Moshë i,t, Kompleksiteti i, Ln Aktive i,t

b. Variabli i varur: Ln Abs RJN

➤ **Testimi rëndësisë së modelit**

Në analizat shumëvariabëlshë ka rëndësi edhe testimi i rëndësisë së modelit pra ndikimi i faktorëve të pavarur mbi ndryshoren e varur. Me fjalë të tjera, ka rëndësi të testohet nëse në modelin e zgjedhur ndikimi i përbashkët i variabëlve të pavarur është

i rëndësishëm. Rëndësia e modelit është vlerësuar nëpërmjet testit Fisher në nivelin e besueshmërisë 95%.

**Tabela 4.26. Anova**

	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.
Regresioni	81,112	11	7,374	12,712	,000 <sup>b</sup>
Mbetjet	95,131	164	,580		
Total	176,243	175			

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

a. Parashikuesit në model: (Konstante), LnShitje, Gov, LnLF, Drejtues/Pronar, Humbje, LnROA, Auditues i,t, Kapitali i Huaj, Ln Moshë i,t, Kompleksiteti i, Ln Aktive i,t

b. Variabli i varur: Ln Abs RJN

Të dhënat e mësipërme tregojnë se modeli në tërësi paraqitet i rëndësishëm pasi statistika  $F(11,175) = 12,712$  (sig F= 0.000). Në këtë mënyrë arrijmë në përfundimin se modeli i ngritur është i rëndësishëm statistikisht bazuar në gabimin e llojit të parë  $\alpha = 0.05$  ose në nivelin e besueshmërisë 95%.

➤ **Testimi i hipotezave bazuar mbi rëndësinë e koeficientëve të pjesshëm të regresionit.**

Hapi tjetër në vlerësimin e regresionit të parashtruar konsiston në përcaktimin se cilët nga variablat e përfshirë në model ndikojnë në parashikimin e variabëlites së varur. Tabela 4.27 paraqet të dhëna në lidhje me koeficientët e pjesshëm të regresionit dhe rëndësinë statistikore të tyre (testi t dhe sig t), procesuar në SPSS 21 sipas metodës “Enter”. Nga krahasimi i koeficientëve b-beta të standardizuar vëmë re se variabli Ln Aktive ka kontributin më të madh në lidhje me shpjegimin e variabëlites së varur, ku  $b = -0.916$ . Kjo do të thotë se madhësia e aktivitetit ndikon negativisht mbi rrjedhjet jonormale. Me fjalë të tjera sa më e madhe të jetë shoqëria aq më pak përfshihet ajo në praktikën e menaxhimit të fitimeve. Ndërkohë që variabli me ndikim më të vogël mbi variabëlites e varur paraqitet të jetë Ln Roa. Nga inspektimi i vlerave të testit “t” dhe rëndësisë përkatëse statistikore arrihet në përfundimin se nga 11 variabëla, vetëm

4 prej tyre paraqiten të rëndësishëm statistikisht në nivelin 95 % të besueshmërisë. Më konkretisht : Ln Aktive ( $t=-7,941$ ,  $\text{sig}(t)=0,000$ ), Ln Mosha ( $t=-2,631$ ,  $\text{sig}(t)=0,009$ ), Gov ( $t=2,326$ ,  $\text{sig}(t)=0,021$ ), Ln Shitje( $t=8,431$ ,  $\text{sig}(t)=0,000$ ). Gjithashtu dhe dy variabëla të tjerë paraqiten të rëndësishëm statistikisht në nivelin 90% të besueshmërisë, dhe konkretisht Drejtues/Pronar ( $t=1,967$ ,  $\text{sig}(t)=0,051$ ) dhe Humbje ( $t=1,676$ ,  $\text{sig}(t)=0,096$ )

**Tabela 4.27. Koefficientët e pjesshëm të regresionit sipas metodës “enter”**

Model	Koefficientët e standardizuar		Koefficientët e standardizuar	t	Sig.	
	B	Gabimi standard	Beta			
(Konstante)	-1,675	,518		-3,231	,001	
M o d e l i	Auditues i,t	,163	,230	,049	,707	,481
	<b>Ln Aktive i,t</b>	<b>-,462</b>	<b>,058</b>	<b>-,916</b>	<b>-7,941</b>	<b>,000</b>
	<b>Ln Mosha i,t</b>	<b>-,234</b>	<b>,089</b>	<b>-,188</b>	<b>-2,631</b>	<b>,009</b>
	<i>Drejtues/Pronar</i>	,239	,122	,119	1,967	,051
	Kompleksiteti i	-,153	,176	-,071	-,870	,386
O L S	LnLF	,066	,074	,057	,885	,377
	<i>Humbje</i>	,252	,150	,103	1,676	,096
	<b>LnShitje)</b>	<b>,472</b>	<b>,056</b>	<b>,864</b>	<b>8,431</b>	<b>,000</b>
	LnROA)	,010	,049	,014	,192	,848
	Kapitali i Huaj	-,094	,149	-,045	-,632	,528
<b>Gov</b>	<b>,480</b>	<b>,207</b>	<b>,187</b>	<b>2,326</b>	<b>,021</b>	
a. variabli i varur : Ln Abs RJN						

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Në të njëjtat rezultate arrihet edhe nëse të dhënat procesohen sipas metodës “stepwise” e cila i konsideron variablat një nga një duke i renditur sipas rëndësisë së tyre statistikore. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet sipas kësaj metodë hap pas

hapi. Vërejmë se dhe kjo metodë (modeli 6 në tabelë) ka vlerësuar si të rëndësishëm statistikiisht me  $\text{sig}(t) < 0.05$ , variablat Ln Aktive, Ln Mosha, Ln Shitje dhe Gov në nivelin 95 % të sigurisë.

**Tabela 4.28. Përmbledhja e modeit sipas metodës Stepwise të realizuar në 6 hapa**

Model	R	R <sup>2</sup>	R <sup>2</sup> i rregulluar	Gabimi standard i parashikimit	Durbin-Watson
1	,361 <sup>a</sup>	,130	,125	,93852	
2	,431 <sup>b</sup>	,186	,177	,91054	
3	,615 <sup>c</sup>	,378	,367	,79830	
4	,615 <sup>d</sup>	,378	,371	,79616	
5	,636 <sup>e</sup>	,405	,394	,78106	
6	,659 <sup>f</sup>	,434	,421	,76381	2,240

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

- a. Variablat e pavarur në model: (Konstante), LnROA
- b. Variablat e pavarur në model: (Konstante), LnROA, Ln Aktive
- c. Variablat e pavarur në model: (Konstante), LnROA, Ln Aktive , LnShitje
- d. Variablat e pavarur në model: (Konstante), Ln Aktive , LnShitje
- e. Variablat e pavarur në model: (Konstante), Ln Aktive , LnShitje, Ln Mosha
- f. Variablat e pavarur në model: (Konstante), Ln Aktive ,LnShitje, Ln Mosha , Gov
- g. Variabli i varur: Ln Abs RJN

**Tabela 4.29. Koefficientët e pjesëm të regresionit sipas metodës “stepwise”**

Model		Koefficientët e standardizuar		Koefficientët e standardizuar	t	Sig.
		Beta	Gabimi standard			
1	(Konstante)	-1,378	,186		-7,388	,000
	LnROA	,240	,047	,361	5,108	,000
2	(Konstante)	-,024	,433		-,055	,956
	LnROA	,176	,049	,265	3,578	,000

	Ln Aktive	-,129	,037	-,255	-3,444	,001
	(Konstante)	-1,474	,428		-3,440	,001
	LnROA	,013	,049	,020	,267	,790
3	Ln Aktive	-,401	,050	-,795	-8,069	,000
	LnShitje	,364	,050	,666	7,285	,000
	(Konstante)	-1,500	,416		-3,603	,000
	Ln Aktive	-,409	,041	-,810	-10,01	,000
4	LnShitje	,370	,044	,678	8,368	,000
	(Konstante)	-1,537	,408		-3,762	,000
	Ln Aktive i,t	-,367	,043	-,727	-8,561	,000
	LnShitje	,369	,043	,677	8,517	,000
5	Ln Mosha i,t	-,229	,082	-,184	-2,784	,006
	<b>(Konstante)</b>	<b>-1,321</b>	<b>,406</b>		<b>-3,255</b>	<b>,001</b>
	<b>Ln Aktive i,t</b>	<b>-,443</b>	<b>,049</b>	<b>-,878</b>	<b>-9,019</b>	<b>,000</b>
	<b>LnShitje</b>	<b>,430</b>	<b>,047</b>	<b>,788</b>	<b>9,136</b>	<b>,000</b>
	<b>Ln Mosha i,t</b>	<b>-,268</b>	<b>,081</b>	<b>-,215</b>	<b>-3,292</b>	<b>,001</b>
6	<b>Gov</b>	<b>,545</b>	<b>,183</b>	<b>,213</b>	<b>2,976</b>	<b>,003</b>
a. Variabli i varur: Ln Abs RJN						

Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21

Ndërsa variablat e përjashtuar sipas metodës stepwise sipas vlerësimit përfundimtar në hapin 6 paraqiten në tabelën 4.31.

**Tabela 4.30. Variabla të përjashtuar si të parëndësishëm në nivelin 95 % të besueshmërisë sipas metodës stepwise, konsideruar në hapin 6.**

		Beta	t	Sig.
6	Auditues i,t	,033		
	Drejtues/Pronar	,096	1,638	,103
	Humbje	,096	1,632	,105
	Kompleksiteti i	-,037	-,493	,622
	Kapitali i Huaj	-,012	-,173	,863
	LnLF	,056	,905	,366

	LnROA	,008	,119	,906
--	-------	------	------	------

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21*

Në tabelën e mëposhtme paraqiten korrelacionet pjesorë për të gjithë variablat në regresion sipas rezultateve të përfutuara nga metoda “enter”. Sipas Tabachnick dhe Fidell (2007, fq.145), nëse ngrihen në katror koeficientët “part korrelacioni” përftohet një tregues i cili shpreh kontributin e variablit mbi koeficientin e korrelacionit total R<sup>2</sup>. E thënë ndryshe ky tregues përcakton se sa prej variancës totale të variabëlites të varur shpjegohet specifikisht nga variabëli përkatës. Duke analizuar vetëm variablat, që janë të rëndësishëm statistikisht vihet re se për variabëlin Ln Aktive vlera prej 0.208 tregon se ky variabël shpjegon 20,8 % të variancës totale, Ln Mosha shpjegon 2.3%, Gov shpjegon 1.8 % dhe Ln Shitje 23.4% të variancës totale. Shuma aritmetike e këtij treguesi nuk mund të jetë e barabartë me koeficientin e korrelacionit total (42.4%) për shkak se variablat kanë korrelacion midis tyre dhe efekti i përbashkët i përfshirjes në model redukton këtë vlerë.

**Tabela 4.31. Koeficientët e korrelacionit pjesor**

	Korrelacioni			(part Korrelacioni) <sup>2</sup>
	Zero-order	Partial	Part	
(Konstant)				
Auditues i,t	,013	,055	0.041	0,002
<b>Ln Aktive i,t</b>	<b>-,355</b>	<b>-,527</b>	<b>-0.456</b>	<b>0,208</b>
<b>Ln Mosha i,t</b>	<b>-,308</b>	<b>-,201</b>	<b>-0.151</b>	<b>0,023</b>
Drejtues/Pronar	-,031	,152	0.113	0,013
Kompleksiteti i	-,019	-,068	-0.05	0,003
LnLF	,092	,069	0.051	0,003
Humbje	,008	,130	0.096	0,009
<b>LnShitje</b>	<b>,133</b>	<b>,550</b>	<b>0.484</b>	<b>0,234</b>
LnROA	,361	,015	0.011	0,000
Kapitali i Huaj	,092	-,049	-0.036	0,001
<b>Gov</b>	<b>-,231</b>	<b>,179</b>	<b>0.133</b>	<b>0,018</b>

Variabli i varur:Ln Abs RJN

*Burimi: Sipas të dhënave të procesuara në programin statistikor SPSS 21. (part Korrelacioni) <sup>2</sup> sipas llogaritjeve të autorit.*

Modeli përfundimtar i derivuar nga analiza e mësipërme shumëvariabëlshe paraqitet si më poshtë vijon:

$$\begin{aligned}
 \text{RJN} = & -1.675 + 0.049 \text{ AUDITUES} - 0.916 \text{ LN AKTIVE} + 0.864 \text{ LN SHITJE} + \\
 & 0.187 \text{ GOV} - 0.188 \text{ LN MOSHA} + 0.119 \text{ DREJTUES PRONAR} - \\
 & 0.071 \text{ KOMPLEKSITETI} + 0.057 \text{ LN LEVA FINANCIARE} + 0.103 \\
 & \text{HUMBJE} + 0.014 \text{ LN ROA} - 0.045 \text{ KAPITALI HUAJ}
 \end{aligned}$$

Modeli i mësipërm është paraqitur sipas rezultateve të regresionit të derivuar nga metoda “enter”, si metodë standarde e procesimit të të dhënave në programin SPSS 21, të përdorur në këtë studim.

Për të konkluduar në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmbledhura rezultatet përfundimtare mbi vërtetimin e hipotezave të parashtruara të studimit, sipas rezultateve në lidhje me koeficientët e pjesshëm të regresionit dhe domethënies së tyre statistikore. Rezultati përfundimtar i vërtetimit të hipotezave është konsideruar në nivelin e besueshmërisë 95%. Gjithashtu, duke qenë se disa tregues paraqiten të rëndësishëm në nivelin 90% të besueshmërisë në tabelë janë paraqitur edhe këto rezultate. Për hipotezat të cilat janë rrëzuar, janë riformuluar pohimet të cilat mbështeten nga analiza e rezultateve.

**Tabela 4.32. Përmbledhje e rezultateve për vërtetimin e hipotezave sipas analizës shumëvariabëlshe.**

Hipoteza	Vërtetohet/ rrëzohet 95% besueshmëri	Vërtetohet/ rrëzohet 90% besueshmëri	Pohimi që mbështetet nga analiza e rezultateve në nivelin e besueshmërisë 95%
H1	Rrëzohet	Rrëzohet	Cilësia e auditimit nuk ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
H2	Vërtetohet	Vërtetohet	Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm negativ mbi menaxhimin e fitimeve (shoqëritë e mëdha angazhohen më pak në praktikatat e menaxhimit të fitimeve)

H3	Vërtetohet	Vërtetohet	Rimi i rritjes së shitjeve ka efekt të rëndësishëm pozitiv mbi menaxhimin e fitimeve (shoqëritë me ritëm të lartë të shitjeve rezultojnë me nivele më të larta të menaxhimit të fitimit)
H4	Vërtetohet	Vërtetohet	Pronësi publike/private ka ndikim rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve (shoqëritë publike angazhohen më shumë në praktikën e menaxhimit të fitimeve)
H5	Vërtetohet	Vërtetohet	Mosha e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm negativ mbi menaxhimin e fitimeve (shoqëritë më të vjetra në moshë angazhohen më pak në praktikën e menaxhimit të fitimeve)
H6	Rrëzohet	Vërtetohet	Pronësia menaxheriale nuk ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
H7	Rrëzohet	Rrëzohet	Kompleksiteti nuk ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve
H8	Rrëzohet	Rrëzohet	Leva financiare nuk ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.
H9	Rrëzohet	Vërtetohet	Shoqëritë me rezultat negativ nuk rezultojnë me nivele më të larta të menaxhimit të fitimeve
H10	Rrëzohet	Rrëzohet	Shoqëritë me ROA më të lartë nuk rezultojnë me nivele më të ulëta të menaxhimit të fitimit
H11	Rrëzohet	Rrëzohet	Kapitali i huaj nuk ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve

### 4.3 Përmbledhje e kapitullit të katërt

Në kapitullin e katërt u investigua fenomeni i menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar si dhe u analizuan faktorët që ndikojnë mbi këtë fenomen, i cili në analizë u përfaqësua nga një matës indirekt (rrjedhjet jonormale). Fillimisht është përzgjedhur modeli më i mirë për të përlogaritur variabëlën e mësipërm që shpreh menaxhimin e fitimeve. Më tej është llogaritur ky variabël, i cili përbën dhe evidencën se fenomeni i menaxhimit të fitimeve është i evidentueshëm në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar. Më së shumti shoqëritë që përbëjnë kampionin e marrë në studim, kanë menaxhuar pozitivisht fitimet. Në vijim analizat njëvariabëlshe dhe shumëvariabëlshe janë përdorur për vërtetimin e hipotezave të parashtruara në studim. Nga analizat

njëvariabëlshe rezultojnë ndryshime të rëndësishme statistikore midis shoqërive të mëdha dhe të vogla si dhe shoqërive në përkatësi të sektorit publik dhe privat në lidhje me iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Shoqëritë e mëdha, dhe shoqëritë private angazhohen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve krahasimisht me shoqëritë e vogla dhe shoqëritë që i përkasin sektorit shtetëror. Ndërsa, ndryshime të parëndësishme statistikore rezultuan në analizën që investigoi lidhjen midis cilësisë së auditimit dhe menaxhimit të fitimeve. Rezultatet e analizës shumëvariabëlshe të ndërmarrë me qëllim identifikimin e faktorëve me ndikim të rëndësishëm mbi fenomenin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar treguan se faktorët kryesorë janë: madhësia e aktivitetit të shoqërisë, mosha e shoqërisë, shitjet dhe përkatësia në sektorin privat/publik. Në kapitullin pasardhës paraqitet diskutimi i mëtejshëm i rezultateve të rrjedhura nga analizat e trajtuara gjerësisht në këtë kapitull.

## KAPITULLI I PESTË

### DISKUTIMI I REZULTATEVE, KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.

Menaxhimi i fitimeve ka qenë një dukuri e cila është studiuar nga autorë të ndryshëm. Përpjekjet e para për të vlerësuar atë nisin në vitin 1985, kur për herë të parë Healy vlerësoi këtë fenomen nëpërmjet devijimit të nivelit normal të rrjedhjeve totale. Si një fenomen jo drejtpërdrejt i matshëm, ai është trajtuar në këndvështrime të ndryshme dhe ka qenë objekt studimi në vendet e zhvilluara, si dhe ato në zhvillim. Metodatat e përdorura për të identifikuar e më pas analizuar këtë fenomen kanë qenë të ndryshme. Ky punim synoi të vlerësojë dhe të analizojë fenomenin e menaxhimit të fitimeve në kontekstin shqiptar duke e lidhur atë me faktorë si cilësia e auditimit, madhësia e aktivitetit të shoqërive, përkatësia në sektorin publik apo privat, si dhe faktorë të tjerë që shprehin karakteristika të shoqërisë, performancës e saj ekonomike, formës e pronësisë e organizimit etj., të cilët ndikojnë në nxitjen apo kufizimin e praktikave të menaxhimit të fitimit. Duke përdorur një kampion të diversifikuar për nga shtrirja gjeografike, forma e organizimit, pronësia, prodhimi i të mirave dhe shërbimeve, mënyrës së financimit (financim me kapital të huaj apo vendas) etj., u synua të përftohen rezultate sa më përfaqësuese për tregun shqiptar. Nëpërmjet analizave empirike fillimisht u përzgjedh modeli më i përshtatshëm për të identifikuar fenomenin e menaxhimit të fitimeve dhe më pas për të vërtetuar hipotezat e parashtruara u ndërtuan dhe testuan modele sasiore.

Në këtë kapitull fillimisht bëhet një diskutim i detajuar i rezultateve kryesore të rrjedhura nga analizat empirike për secilën prej hipotezave të parashtruara. Më pas paraqiten të përmbledhura disa konkluzione si dhe implikimet teorike dhe praktike të studimit. Së fundi, paraqiten rekomandime për studime të ardhshme të mëtejshme në këtë fushë.

#### 5.1 Rezultatet dhe diskutim i tyre

Më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar, diskutimi i rezultateve dhe gjetjeve sipas hipotezave të parashtruara në studim.

### 5.1.1 Identifikimi i fenomenit “menaxhimi i fitimeve”

Modeli Jones, Modeli Jones i Modifikuar, Modeli i Zgjeruar Jones-Cash Flow dhe Modeli i Matjes së Performancës u përzgjedhën në analizë për të vlerësuar rrjedhjet jonormale. Për secilin prej modeleve të trajtës regresion i shumëfishtë linear (OLS) u ndërmorën analiza paraprake për të siguruar në lidhje me supozimet mbi të cilat mbështetet regresioni. Nga analiza rezultoi se modeli Jones i modifikuar dhe modeli i Zgjeruar Jones shfaqën probleme të heteroskedasticitetit. Supozimet e tjera mbi normalitetin, linearitetin dhe multikolinearitetin nuk rezultuan të shkelura për asnjë nga modelet e trajtuara. Në vijim u konkludua në lidhje me rëndësinë statistikore të modeleve. Modelet rezultuan të rëndësishëm nga ana statistikore në nivelin e besueshmërisë 95% me  $\text{Sig}(F) < 0.05$ . Për sa i përket aftësisë shpjeguese të variablave të pavarur u vu re se modeli i Matjes së Performancës kishte  $R^2 = 74.4\%$ . Kjo shifër rezultoi relativisht e lartë krahasuar me modelet e tjera të cilat përkatësisht mund të shpjegojnë 5.8%, 8.6% dhe 15.5% të variacionit të variablit të varur. Në këtë mënyrë, në kampionin e marrë në analizë, Modeli i Matjes së Performancës i zhvilluar nga Kothari, Leone dhe Wasley (2005) rezultoi të ishte statistiki më i favorshëm për t'u përdorur në llogaritjen e rrjedhjeve jonormale, si variabël që shpreh menaxhimin e fitimeve dhe si tregues i matshëm që përbën evidencë në lidhje me fenomenin në kontekstin shqiptar. Rrjedhjet jonormale u llogaritën si devijimi i rrjedhjeve normale (sipas modelit të përzgjedhur) nga rrjedhjet totale (të llogaritura sipas zërave të pasqyrës së flukseve të parasë) për çdo firmë - vit vrojtim.

Rezultatet treguan se në 21% të rasteve shoqëritë kanë menaxhuar negativisht fitimin duke e reduktuar atë dhe në 71% kanë menaxhuar pozitivisht fitimin. Mbështetur në literaturat që studiojnë menaxhimin e fitimeve, rrjedhjet jonormale janë një matës i mirë i tij. Në këtë mënyrë arrijmë në përfundimin se në kampionin e marrë në shqyrtim, menaxhimi i fitimeve është një fenomen i pranishëm.

Duke përgjithësuar, në funksion të përgjigjes së pyetjes: “A përfshihen menaxherët në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar në iniciativat e menaxhimit të fitimeve?”, analiza e mësipërme përftoi evidencë dhe tregoi se “menaxhimi i fitimeve” është një fenomen i pranishëm dhe i identifikueshëm në shoqëritë, që operojnë në tregun shqiptar. Ky rezultat natyrshëm mbështetet dhe nga fakti se fenomeni, në disa raste është i lejueshëm dhe nga vetë rregullat e kontabilitetit, të cilat i japin të drejtën

kontabilistëve të përdorin gjykimet e tyre në përzgjedhjen e metodave të ndryshme të vlerësimit, duke përfutur kështu rezultate të ndryshme.

### 5.1.2 Diskutimi i rezultateve sipas hipotezave të ngritura

- *Hipoteza 1: Madhësia e audituesit ka ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve, në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar (H1 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë)*

Nga rezultatet e analizës shumëvariabëlshe vihet re se  $\beta = 0.049$ . Vlerat pozitive të koeficientit tregojnë se shoqëritë e audituara nga Big4 rezultojnë me vlera më të mëdha të rrjedhjeve jonormale dhe më konkretisht ky ndryshim është 5%<sup>17</sup> më shumë. Shoqëritë, në procesin e auditimit të të cilave janë përfshirë Big4 kanë menaxhuar fitimin 5% më shumë sesa shoqëritë, auditimi i të cilave është realizuar nga JoBig4. Megjithatë, ky ndryshim nuk është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 95 % të besueshmërisë. Pra, e analizuar në kontekstin shqiptar, menaxhimi i fitimeve nuk është ndikuar nga fakti se shoqëritë janë audituar nga shoqëri ndërkombëtare auditimi (Big4), shoqëri të vogla apo ekspertë kontabël të autorizuar (JoBig4). Ky përfundim mund të mbështetet dhe nga fakti se rreziku i kontestimit të procesit të auditimit në Shqipëri është thajse i pa përfillshëm. Këto rezultate janë në përputhje me gjetjet e Piot, Janin, Remi, (2005), Carcello, Hollingsworth, Klein dhe Neal (2006), Yasar (2013).

- *Hipoteza 2 – Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. H2 mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 99% të sigurisë*

Gjetjet treguan se madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm negativ në praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar. Një rritje e madhësisë së aktivitetit me 1% rezulton me rënie të rrjedhjeve jonormale me 0.916 % ( $\beta = -0.916$ ). Shoqëritë e mëdha kanë të ngjarë të jenë përfshirë më pak në menaxhimin e fitimeve duke rezultuar në vlera më të vogla të rrjedhjeve jonormale. Ky rezultat mund të mbështetet nga fakti se shoqëritë e mëdha kanë reputacion më të madh në treg. Përgjithësisht këto shoqëri kanë struktura të konsoliduara menaxheriale,

<sup>17</sup>  $\ln(\text{Abs } R_{jn}) = -1.695 + 0.049 \text{ AUDITUES} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $(e^{0.049} - 1) = 0.05$

struktura të konsoliduara të auditimit të brendshëm, si dhe janë objekt i një kuadri rregullator më të rreptë. Ato shpesh janë objekt i mbikëqyrjes edhe nga organet kompetente, në varësi të qeverisjes qendrore apo lokale krahasuar me shoqëritë e vogla, që shpesh mund t'i shpëtojnë kësaj mbikëqyrjeje. Në këtë këndvështrim menaxherët nuk mund të përfshihen lehtësisht në iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Bazuar në gjetjet e mësipërme u arrit në përfundimin se në kampionin e marrë në studim shoqëritë e mëdha u përfshinë më pak në menaxhimin e fitimeve krahasuar me shoqëritë e vogla. Ndryshe nga Ahmed, Al-khabash, Thuneibat, (2008) dhe Naz,Bhatti, Ghafoor dhe Husein (2011) të cilët nuk kanë gjetur një lidhje midis madhësisë së shoqërisë dhe menaxhimit të fitimeve rezultatet janë të ngjashme me gjetjet e Burgstahler dhe Dichiv (1997), Kim, Liu Rhee (2003), Paiva dhe Lourencço (2013) dhe Dwi Lusi Tyasing Swastika(2013).

- *Hipoteza 3 – Ndryshimi mbi shitjet ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. H3 mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë (t= 8.431, Sig(t)= 0.000>0.05)*

Shoqëritë me rritëm të lartë të rritjes së shitjeve rezultuan në rrjedhje jonormale më të larta në kampionin e vlefshëm në studim pra rezultuan të jenë përfshirë më shumë në praktikat e menaxhimit të fitimeve. Kjo tregohet nga rezultati pozitiv i koeficientit  $=0.864$ , i cili tregon se për një rritje prej 1% të ritmit të rritjes së shitjeve, rrjedhjet jonormale janë rritur me 0.864%. Rritmi i lartë i rritjes së shitjeve në fakt konsiderohet si një nga treguesit kryesorë të rritjes së fitimeve. Gjithashtu ky tregues (së bashku me tregues të tjerë të performancës mund të përdoret për të përcaktuar fazën e ciklit të jetës në të cilën ndodhet shoqëria. Rritmi i lartë i shitjeve mund të tregojë se shoqëria është në fazën e rritjes së saj. Kjo situatë mund të favorizojë sjelljet oportuniste të menaxherëve për të ndërmarrë iniciativa të menaxhimit të fitimeve (shpërblime të larta, pozicionim më i mirë në hierarkinë e menaxhimit, etj., apo akoma më tej iniciativa të vetë pronarëve të shoqërisë, për të përfituar nga klima e favorshme në lidhje me përthithjen e burimeve të financimit. Këto rezultate janë të ngjashme me gjetjet e Kim, Liu, Rhee, (2003).

- *Hipoteza H4- Përkatësia në sektorin publik/privat të shoqërive në tregun shqiptar ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. H4 mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë .*

Vërtetimi i hipotezës H4 tregoi se përkatësia e shoqërisë në sektorin publik apo privat ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve. Shoqëritë, të cilat i përkisnin sektorit publik në kampionin e marrë në studim rezultuan me vlera më të larta të menaxhimit të fitimeve. Kjo evidentohet edhe nga fakti se koeficienti është pozitiv dhe merr vlerën 0.187. E shprehur në përqindje shoqëritë publike rezultojnë me rrjedhje jonormale më të larta sesa shoqëritë private, në nivelin 21.6%<sup>18</sup>, duke konkluduar se shoqëritë publike përfshihen më shumë në praktikat e menaxhimit të fitimeve. Mesa duket, shoqëritë publike edhe pse kanë të instaluar struktura të auditimit të brendshëm të licencuara, të cilët kanë akses në çdo lloj informacioni dhe mundësi kontrolli në çdo hallkë gjatë aktivitetit të shoqërisë, përsëri rezultojnë të jenë përfshirë më shumë në praktikat e menaxhimit të fitimeve. Ndoshta ndarja e pronësisë nga menaxhimi mund të krijojë ambient të përshtatshëm për praktikat e menaxhimit të fitimeve, ndërkohë që në shoqëritë private ky fenomen mund të jetë më i kufizuar sepse pronarët janë në gjendje të monitorojnë menaxherët më nga afër duke rezultuar që këto shoqëri të paraqiten më konservatore në lidhje me fenomenin e parë në kontekstin shqiptar. Pronarët në këto shoqëri mund të bëhen pjesë aktive e menaxhimit (në kampionin e marrë në studim pronarët ishin dhe drejtues ekzekutiv të shoqërive që i përkisnin sektorit privat, në 54% të rasteve). Shoqëritë publike përgjithësisht karakterizohen nga një strukturë e decentralizuar menaxheriale. Ato kanë më pak pronarë, që në më të shumtën e rasteve dhe me shumicën e aksioneve është pushteti qendror apo lokal. Pronarët, në këto struktura kanë një rol pasiv në menaxhim dhe për rrjedhojë asimetria e informacionit është më e lartë. Në këtë mënyrë menaxherët mund të ndërmarrin lirisht praktika të menaxhimit të fitimeve. Rezultatet e mësipërme janë të ngjashme me gjetjet e Beatty (2002) dhe Kempen (2010).

- *Hipoteza 5: Moshë e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm negativ mbi menaxhimin e fitimeve. H5 mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 99% të sigurisë.*

---

<sup>18</sup>  $\text{Ln}(\text{Abs Rjn}) = -1.695 + 0.187\text{GOV} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $=(e^{0.187})-1 = 0.2056$ .

Gjetjet treguan se ka një lidhje negative midis moshës së shoqërisë (koha që nga themelimi i aktivitetit) dhe rrjedhjeve jonormale. Koeficienti  $\beta = -0.188$ , tregon se çdo rritje për 1% të variabëlilit do të rezultojnë në 0.188% reduktim të rrjedhjeve jonormale. Kështu, sa më e madhe të jetë jetëgjatësia operuese në treg e shoqërisë, aq më e konsoliduar është ajo si dhe strukturat e drejtimit, kontrollit dhe vendimmarrjes. Gjithashtu, ka të ngjarë që të këtë më shumë informacion të hapur për publikun dhe grupet e interesave, duke rezultuar në reduktim të asimetrisë së informacionit. Në këtë këndvështrim shoqëritë me moshë më të madhe ka të ngjarë të shmangin menaxhimin e fitimeve. Në kampionin e marrë në studim, shoqëritë që rezultuan me aktivitet më të gjatë në tregun shqiptar u përfshinë më pak në praktikatat e menaxhimit të fitimeve.

- *Hipoteza 6: Pronësia menaxheriale ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.  $H_0$  mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.*

Në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar nuk është gjetur një lidhje e rëndësishme midis faktit që aksionarët janë dhe drejtues dhe kanë rol aktiv në menaxhimin e shoqërisë dhe rrjedhjeve jonormale që përfaqësojnë menaxhimin e fitimeve. Këto gjetje janë të ngjashme me gjetjet e Rajgopal, Venkatachalam dhe Jambalvo (1999). Ndërsa, në nivelin e besueshmërisë 90% hipoteza e mësipërme mbështetet nga rezultatet e analizës përderisa  $\text{Sig}(t) = 0,051 < 0.1$ . Koeficienti  $\beta = 0.119$ , tregon se ka një lidhje pozitive midis variabëlve, që do të thotë se shoqëritë në kampion për të cilat pronarët janë njëkohësisht edhe drejtues, pra pronësia dhe drejtimi nuk janë të ndara, rezultuan të kenë menaxhuar më shumë fitimet. Ndoshta drejtuesit-pronarë mund të kenë ushtruar autoritetin e tyre, duke lejuar që të ndikohet mbi rezultatet nëpërmjet menaxhimit të rrjedhjeve për motive nga më të ndryshmet p.sh., përmirësimin e performancës me qëllim rritjen e besueshmërisë së kreditorëve dhe lehtësimin e praktikave të kreditimit të aktivitetit apo përkeqësim të performancës me qëllim reduktimin e detyrimeve për tatim-taksat etj. Në këtë mënyrë, drejtuesit-pronarë veprojnë në interes të aksionarëve pa marrë parasysh grupet e tjera të interesuara për raporte financiare cilësore. Më konkretisht, shoqëritë me drejtues-pronarë kanë

menaxhuar fitimin 12.6%<sup>19</sup> më shumë se shoqëritë me drejtues-jopronarë. Këto rezultate janë të ngjashme me Cohen, Dey and Lys (2008).

- *Hipoteza 7: Komplexiteti ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.* H7 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.

Lidhja midis menaxhimit të fitimeve dhe kompleksitetit të shoqërisë rezulton të jetë negative (pavarësisht faktit që statistikisht kjo lidhje rezulton e parëndësishme) pasi  $= -0.071$ . Rritja e kompleksitetit të shoqërisë e bën më të vështirë procesin e kontrollit të aktivitetit duke rritur kështu kërkesën për raportim financiar cilësor dhe auditim më cilësor. Në këtë mënyrë menaxherët mund të kufizohen në lidhje me praktikën e menaxhimit të fitimeve. Nga të dhënat që rrjedhin nga regresioni, shoqëritë të cilat kanë shtrirë aktivitetin të ndarë në më shumë se një degë kanë rezultuar me 6.9%<sup>20</sup> rrjedhje jonormale më të vogla se shoqëritë e tjera, që do të thotë se kanë menaxhuar fitimin më pak.

- *Hipoteza 8: Leva financiare ka efekt të rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve.* H8 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.

Sipas rezultateve të përfuara nga analiza ( $\alpha = 0.057$ ), rezulton se për një rritje prej 1% të levës financiare, rrjedhjet jonormale rriten me 5.7%. Kjo do të thotë se shoqëritë që kishin raport më të lartë borxhi rezultuan me rrjedhje më të larta jonormale, pra rezultuan të kenë menaxhuar më shumë fitimin sesa shoqëritë me raport të ulët të borxhit. Lidhja pozitive midis variablave është gjetur dhe në punimet e Matinfard, Ojaghi, (2013), An, Li, dhe Yu. (2013) etj.. Kjo situatë mund të jetë nxitur nga fakti se shoqëritë mund të menaxhojnë rezultatet me qëllim që të lehtësojnë procedurat e kreditimit apo të risin performancën në dukje, me qëllim që t'i shpëtojnë mbikëqyrjes së rreptë të kreditorëve, rritjes së kostove të borxhit si dhe të shmangin mundësinë e anulimit së kontratave. Megjithatë, ky rezultat nuk rezultoi të

<sup>19</sup>  $\ln(\text{Abs Rjn}) = -1.695 + 0.119 \text{ DP} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $(e^{0.119}) - 1 = 0.126$

<sup>20</sup>  $\ln(\text{Abs Rjn}) = -1.695 - 0.071 \text{ KOMPLEKSITETI} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $(e^{-0.071}) - 1 = -0.069$

ishte i rëndësishëm statistiki në nivelin 95% të sigurisë. Pra, në kampionin e marrë në studim nuk u gjet një lidhje e rëndësishme midis levës financiare dhe menaxhimit të fitimit. Këto rezultate janë të ngjashme me Al-Fayoumi (2010), Ardison, Martinez dhe Galdi (2012), Sabien (2013) etj.

- *Hipoteza 9: Shoqëritë me rezultat negativ rezultojnë me nivele më të larta të menaxhimit të fitimit. H9 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.*

Lidhja pozitive që ka rezultuar midis variablave të konsideruar në analizë ( $\rho = 0.103$ ) tregon se në kampionin e marrë në studim shoqëritë që kanë pasqyruar rezultat negativ kanë rrjedhje jonormale 10.8%<sup>21</sup> më të larta sesa shoqëritë, të cilat kanë raportuar rezultat pozitiv. Këto rezultate janë të ndryshme nga gjetjet e Park dhe Shin (2004) dhe Roychowdhury (2006), të cilët tregojnë se shoqëritë tentojnë të shmangin raportimin e humbjeve duke ndërmarrë iniciativa të menaxhimit të fitimeve. Një performancë jo e mirë mund t'i kushtojë shoqërive pamundësi për të siguruar financim shtesë, ose rritje të kostos së tij. Ndërsa në kampionin e marrë në studim rezultoi e kundërta. Një shoqëri mund të raportojë humbje me qëllim që të shmangë pagimin e tatimit mbi fitimin, jo vetëm për vitin ushtrimor, por mund ta reduktojë atë edhe në vitet në vazhdim, për aq kohë sa legjislacioni në fuqi, pra ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në nenin 27, për mbartjen e humbjeve përcakton se: "Në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit 'humbja e parë më përpara se ajo e fundit'".

- *Hipoteza 10: Shoqëritë me ROA më të lartë rezultojnë me nivel më të ulët të menaxhimit të fitimit. H10 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.*

Shoqëritë që kanë rezultuar me performancë më të lartë shprehur nga ROA kanë menaxhuar më shumë fitimet, ku për 1% të ROA më të lartë rrjedhjet jonormale kanë

<sup>21</sup>  $\ln(\text{Abs } R_{jn}) = -1.695 + 0.119 \text{ HUMBJE} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $(e^{0.103}) - 1 = 0.108$

rezultuar 0.014% më të larta ( $=0.014$ ). Megjithatë ky rezultat nuk është i rëndësishëm statistiki në nivelin 95 % të sigurisë. Kështu kthimi mbi aktivet nuk është një variabël që mund të parashikojë fenomenin e menaxhimit të fitimeve,

- *Hipoteza 11: Kapital i huaj, efekt të rëndësishëm negativ mbi menaxhimin e fitimeve.* H 11 nuk mbështetet nga rezultatet e testimit në nivelin 95% të sigurisë.

Shoqëritë, që janë financuar pjesërisht apo plotësisht nga kapital i huaj kanë rezultuar të kenë rrjedhje jonormale 4.4%<sup>22</sup> më të ulëta ( $=-0.045$ ). Kjo do të thotë që shoqëritë e huaja janë përfshirë më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve duke rezultuar në rritje të cilësisë së raportimit financiar. Kapitali i huaj përbën një faktor kyç në rritjen ekonomike të një vendi, sidomos për vendet në zhvillim siç është dhe Shqipëria. Investimet e huaja, përveç kapitalit dhe teknologjive të reja, importojnë në vendin hyrës edhe sisteme më të mira qeverisjeje, menaxhimi e kontrolli. Këto rezultate janë të ngjashme me gjetjet e Chung (2004), Guo, Zhang dhe Zhou (2012), etj.. Pavarësisht lidhjes negative të identifikuar nëpërmjet analizës empirike, në kampionin e analizuar në këtë studim, pronësia e huaj nuk rezultoi të ishte faktor i rëndësishëm statistiki në nivelin 95 % të sigurisë, në lidhje me kufizimin e praktikave të menaxhimit të fitimeve.

## 5.2 Konkluzione

Duke konsideruar rezultatet e analizës empirike të prezantuar në kapitullin e katërt si dhe diskutimet e mësipërme të tyre, u konkludua në disa konkluzione të paraqitura si më poshtë vijon:

- Modeli i Matjes së Performancës i zhvilluar nga Kothari, Leone dhe Wasley (2005) është një instrument i përshtatshëm statistiki për të ndarë rrjedhjet totale në komponent normal dhe jonormal. Ai është efikas për t'u përdorur në llogaritjen e rrjedhjeve jonormale, si variabël i cili indirekt identifikon fenomenin e menaxhimit të fitimeve, në kontekstin shqiptar.

---

<sup>22</sup>  $\ln(\text{Abs } R_{jn}) = -1.695 - 0.045 \text{ KH} \Rightarrow$  ndryshimi në % i rrjedhjeve jonormale midis grupeve është i barabartë me  $=e^{(-0.045)} - 1 = -0.044$

- Vlerësimi i rrjedhjeve jonormale paraqet evidencë empirike në lidhje me evidentimin e fenomenit të menaxhimit të fitimeve, të vlefshme në kontekstin shqiptar, dhe tregun se “menaxhimi i fitimeve” është një fenomen i pranishëm dhe i identifikueshëm në shoqëritë, që operojnë në këtë treg.
- Operatorët e auditimit në tregun shqiptar manifestojnë të njëjtën cilësi auditimi. Pra, shoqëritë Big4 edhe pse përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare të auditimit, nuk rezultojnë të jenë më konservatorë, duke kufizuar iniciativat e menaxhimit të fitimeve. Pra, e analizuar në kontekstin shqiptar nuk u vërehet ndryshim i rëndësishëm mbi menaxhimin e fitimeve kur në procesin e auditimit të pasqyrave financiare përfshihen ose jo, shoqëri Big4.
- Madhësia e shoqërisë ka efekt të rëndësishëm në praktikën e menaxhimit të fitimeve në shoqëritë që operojnë në tregun shqiptar. Shoqëritë më të mëdha përfshihen më pak në iniciativat e menaxhimit të fitimeve duke rezultuar në vlera më të vogla të rrjedhjeve jonormale.
- Në tregun shqiptar, shoqëritë publike përfshihen më shumë në praktikën e menaxhimit të fitimeve ndërsa , shoqëritë private rezultojnë të jenë më konservatore në lidhje me këto praktika. Ndarja e pronësisë nga menaxhimi dhe asimetria e informacionit në shoqëritë publike krijon një terren më të përshtatshëm për të favorizuar iniciativat e menaxhimit të fitimeve
